



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RAPORT VJETOR

2017



DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE

Adresa:

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë industriale

Bulevardi “Zhan D’Ark”, Prona nr. 33, Shtëpia e Ushtarakëve, Tiranë, Shqipëri

www.dppm.gov.al

info@dppm.gov.al

SHKURTIME

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë industriale

DPPI

Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale

OBPI (WIPO)

Pronësia Intelektuale

PI

Zyra Evropiane e Patentave dhe Markave

ZEP (EPO)

Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale

ZBEPI (EUIPO)

Bashkimi Evropian

BE

Republika e Shqipërisë

RSH

Komiteti i Shkencës dhe Teknologjisë

KSHT

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin

UNDP/PNUD

PËRMBAJTJA

- 1. MESAZH PËRSHËNDETËS I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DPPI**
- 2. HYRJE (*PRONËSIA INDUSTRIALE*)**
- 3. PROFILI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE**
- 4. SHËRBIMET QË OFRON DPPI**
- 5. LEGJISLACIONI**
- 6. STRATEGJIA**
- 7. PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ROLI I DPPI**
- 8. HISTORIK MBI DPPI**
- 9. VENDIMET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË DPPI**
- 10. REGJISTRIMI I OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE**
PATENTAT PËR SHPIKJE DHE MODELET E PËRDORIMIT
MARKAT TREGTARE
DISENJOT INDUSTRIALE
TREGUESIT GJEOGRAFIKË
- 11. AKTIVITETI PROMOVUES DHE NDËRGJEGJËSIMI**
KONFERENCA DHE SEMINARE
ANALIZA E PRONËSISË INTELEKTUALE
AKTIVITETE DHE BASHKËPUNIME NË FUSHËN E ARSIMIT
TRAJNIME TË INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA NË SISTEMIN E PI
- 12. BASHKËPUNIME**
BASHKËPUNIMET DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE
KONTRIBUTI I DPPI NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN
BASHKËPUNIMET DHE MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET VENDASE
- 13. TEKNOLOGJIA INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT**
- 14. TRAJTIMI I KONFLIKTEVE MBI OBJEKTET E PRONËSISË INDUSTRIALE**
RREGULLIMET LIGJORE NË LIDHJE ME KONFLIKTET MBI PRONËSINË INDUSTRIALE
VENDIME NGA BORDI APELIMIT NË DPPI
ÇËSHTJE NË GJYKATË
- 15. RAPORTI FINANCIAR**
- 16. BURIMET NJERËZORE**

17. MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

18. MASAT E NDËRMARRA NGA DPPI NË KUADËR TË REFORMËS SË DEREGULIMIT

19. PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PATENTAVE PËR SHPIKJE DHE MARKAVE TREGTARE

20. TË DHËNA STATISTIKORE NGA REGJISTRAT E DPPI

MESAZH PËRSHËNDETËS I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË DPPI



I nderuar Lexues,

Në vite DPPI e ka parë hartimin dhe prezantimin e raportit të saj vjetor më shumë se një detyrim institucional. Ky raport reflekton përpjekjet dhe punën e DPPI në përmbushje të misionit të saj për forcimin dhe promovimin e pronësisë industriale, për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian.

Dëshiroj ta filloj këtë mesazh me falënderime të cilat shkojnë për të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin e pronësisë industriale që bashkëpunuan me ne, për të finalizuar me sukses detyrat dhe objektivat e DPPI për vitin 2017.

Së pari, dëshiroj të falënderoj ministrin e Financave dhe Ekonomisë, z. Arben Ahmetaj për mbështetjen që i dha zhvillimeve legislative dhe institucionale në mbrojtjen e pronësisë industriale në Shqipëri. Shpreh mirënjohjen edhe për përfaqësuesit e delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, për drejtuesit e organizatave ndërkombëtare të fushës së pronësisë intelektuale si OBPI, ZEP, ZBEPI për bashkëpunimin dhe kontributin e dhënë, si dhe për drejtuesit e zyrave homologe me të cilat kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe.

Falënderoj gjithashtu, të gjithë institucionet vendase të përfshira në sistemim e mbrojtjes së pronësisë industriale dhe anëtarët e Grupit Ndërinstitucional të Punës për monitorimin e “Strategjisë Kombëtare të Pronësinë Intelektuale 2016-2020” bizneset shqiptare të cilët aplikuan për regjistrim të objekteve të pronësisë industriale pranë institucionit tonë, përfaqësuesit e autorizuar dhe stafin e DPPI-së për punën e kryer.

Kam kënaqësi të shprehur që, edhe këtë vit arritëm të kemi rezultate mjaft pozitive në punën tonë. Suksesi i DPPI reflektohet në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga “Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2016-2020”.

Dëshiroj të theksoj që në vitin 2018, DPPI do të festojë 25 vjetorin e krijimit të saj. Në vazhdim të këtij raporti vjetor do të gjeni të pasqyruar një përmbledhje të historikut të kësaj drejtorie ku vlen të përmendim kryesisht përpjekjet në fillimin e viteve ‘90-të nga intelektualët e shquar, drejtues dhe anëtarë të Komitetit të Shkencave dhe Teknologjisë së Republikës së Shqipërisë, për të ngritur një zyrë moderne të pronësisë industriale në vendin tonë, në një kohë kur sistemi i pronësisë industriale sidomos për patentat për shpikje, ishte inekzistent. Ngritja e kësaj zyre u shoqërua me krijimin e bazës ligjore dhe me anëtarësimin e Shqipërisë në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale, si një nevojë emergjente pas daljes nga regjimi i kaluar, i cili kishte ndrydhur zhvillimin e të drejtave mbi pronësinë intelektuale, duke harruar që ajo është një nga mjetet më të fuqishme të nxitjes së inovacionit, teknologjisë dhe punës krijuese. Me këtë rast, shpreh mirënjohjen më të thellë për përpjekjet dhe punën intelektuale të themeluesëve të kësaj zyre.

Me kalimin e viteve, zyra filloi të evoluojë, duke përmirësuar gradualisht kapacitetet e saj administrative në lidhje me funksionin e saj të rëndësishëm për regjistrimin dhe njohjen e të drejtave të pronësisë industriale dhe tashmë ky institucion po ecën me hapin e kohës duke ofruar shërbime cilësore dhe profesionale.

Vizioni ynë është t’i japim një tjetër dimension funksioneve të DPPI duke e bërë atë më aktive, me synim të qartë për të krijuar një kulturë të përgjithshme për njohjen, nxitjen, promovimin, respektimin dhe zhvillimin e të drejtave mbi pronësinë industriale në Republikën e Shqipërisë.

Në këto katër vitet e fundit, qëllimi ynë kryesor ka qenë rritja e cilësisë së shërbimit dhe zhvillimi i standardeve bashkëkohore për mbrojtjen e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë. Arritja jonë më e rëndësishme ishin ndryshimet që u bënë në Ligjin Nr. 9947, datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, i cili hyri në fuqi në mars të vitit 2017.

Ndryshimet ligjore ishin përmbushje e detyrave të lëna në raportet e Komisionit Evropian, dhe pasqyrim i angazhimeve dhe synimeve të qeverisë shqiptare, të cilat kanë të bëjnë me shkurtimin e afateve dhe rritjen e cilësisë së shërbimit, rregullime dhe saktësime të problemeve të hasura nga zbatimi i ligjit të mëparshëm në praktikë, si dhe përshtatja me eksperiencat dhe praktikat e zyrave homologe ndërkombëtare.

Ky ligj është i përafëruar me direktivat e BE. Ndryshimet që sjell, kanë të bëjnë me një cilësi të garantuar të ekzaminimit, parandalimin e konflikteve, lehtësimin e procedurave të aplikimit, modernizimin e teknologjisë së informacionit, promovimin e gjerë të njohurive mbi sistemin e pronësisë industriale, forcimin e kapaciteteve administrative dhe përcaktimin e kriterëve ligjore për mbrojtje më të sigurtë për të gjitha objektet e PI. Ligji u hartua në bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Evropian dhe partnerët ndërkombëtarë (OBPI, ZEP, ZBEPI).

Forcimi i sistemit të mbrojtjes përkthehet në nxitje të inovacionit në vend, transferim të teknologjisë, garanci për mbrojtjen e të drejtave mbi PI, thithje të investimeve të huaja, eksport të produkteve vendase, garanci për cilësinë e mallrave dhe shërbimeve dhe krijimin e konkurrencës së ndershme në treg.

Në vëmendjen tonë ka qenë padyshim edhe bashkëpunimi me institucionet vendase dhe të huaja për të krijuar efektshmëri të sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së pronësisë industriale. Në vitin 2017 kemi lidhur memorandume bashkëpunimi me një ndër zyrat më të mëdha dhe të zhvilluara në botë siç është Zyra e Patentave dhe Markave Tregtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky memorandum, ka për synim nxitjen e shkëmbimeve ekonomike ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke vlerësuar nevojën për bashkëpunim më të gjerë bilateral ndërmjet zyrave të pronësisë industriale, për të forcuar dhe zhvilluar sistemet ekzistuese, duke krijuar një mekanizëm për të patur shkëmbim të rregullt të informacionit dhe të praktikave më të mira, për regjistrimin dhe promovimin e objekteve të pronësisë industriale, si dhe organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve të tjera të përbashkëta frytdhënëse.

Me iniciativën tonë, në qytetin e Vlorës u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë. Në zbatim të kësaj marrëveshjeje u krijua Qendra e Informacionit Teknik dhe Shkencor pranë këtij Universiteti, si një ndër objektivat kryesorë të ndërmarrë në "Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelktuale 2016-2020". Ngritja e kësaj qendre, shërben për rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve, stafit akademik shkencor, shpikësve dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore shkencore, si dhe për të drejtat që i përkasin shpikësve dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore shkencore, nëpërmjet patentimit të shpikjeve të tyre.

Gjithashtu, jemi në proces të lidhjes së marrëveshjeve edhe me institucione të tjera dhe zyra homologe të vendeve të rajonit e më gjerë.

Rritja e kapaciteteve administrative ishte domosdoshmëri e imponuar nga parashikimet ligjore dhe nevoja praktike për kryerjen e funksioneve të DPPI. Shndërrimi në një agjenci autonome u realizua për të krijuar kushte të favorshme për forcimin e shërbimeve të DPPI-së dhe infrastrukturës së saj, duke e pajisur DPPI-në me strukturën e përshtatshme dhe mjetet më moderne teknike, të cilat janë kërkesë e ritmeve të sotme bashkëkohore. Kjo strukturë e re do të mundësojë shtimin e stafit dhe paisjen me mjetet e duhura për përmirësimin e funksioneve institucionale. Kjo formë organizimi është praktikë e të gjitha vendeve të zhvilluara.

Misioni i DPPI-së është të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale nëpërmjet njohjes dhe regjistrimit të të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale, për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve Evropiane. Objekt i punës së saj, është regjistrimi dhe promovimi i objekteve të pronësisë industriale. Për këtë arsye është mundësuar ofrimi i një shërbimi të shpejtë dhe korrekt në përputhje me ligjin.

DPPI është organi më i specializuar në fushën e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë dhe ka për detyrë edhe trajnimin e aktorëve të përfshirë në sistem (prokurorinë, doganat, policinë, gjykatat, inspektoratet, bizneset, përfaqësuesit e autorizuar, ekspertët e PI-së, universitetet dhe individët në përgjithësi). Sfidat e DPPI-së për të ardhmen është krijimi i një akademie për PI-në brenda strukturës së saj, e cila do të mundësojë trajnimin e vazhdueshëm të të gjithë aktorëve në sistem, si dhe do të hartojë tekste informuese në këtë fushë.

Promovimi ka qenë në fokusin tonë të vazhdueshëm duke organizuar konferenca, seminare leksione të hapura në shkolla dhe universitete të ndryshme të vendit si dhe konkurse me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e mbrojtjes së PI.

Këtë vit i kemi dhënë rëndësi të veçantë aktiviteteve për ndërgjegjësimin e biznesit shqiptar mbi rëndësinë e pronësisë industriale. Kemi zhvilluar një fushatë takimesh me sipërmarrës të ndryshëm duke u ofruar konsulencë profesionale, me synimin që të bëjmë biznesin ta shohë pronësinë industriale si një kapital që mbrohet së pari nëpërmjet regjistrimit dhe për të cilin ka vlerë të veçantë ngritja e një strategjie të posaçme, për ta kthyer atë në burim fitimi.

Kemi kryer mbi njëqind (100) takime duke vizituar ambientet e biznesit jo vetëm në qytetin e Tiranës, por edhe në rrethe të ndryshme të Republikës së Shqipërisë. Ky aktivitet promovues solli si rezultat rritjen e konsiderueshme të aplikimeve për regjistrim të markave tregtare, duke arritur kështu një rekord të ri prej 1.161 markash kombëtare të depozituara në DPPI.

Mbrojtja e pronësisë industriale i jep vlerë markave tregtare dhe sidomos produkteve unike shqiptare të regjistruara si tregues gjeografik dhe emërtim origjine. Për këtë qëllim, nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe zhvillimit të projekteve në këtë fushë do të mund të arrijmë evidentimin dhe gjallërimin e tregut të objekteve të pronësisë industriale, duke shfrytëzuar benefitet që ajo në vetvete mbart.

Vlen të përmendet që kemi një rritje të aplikimeve për treguesit gjeografikë të produkteve shqiptare, kryesisht nga zonat veriore të Republikës së Shqipërisë si: Gështenja e Tropojës, Gështenja e Malësisë së Madhe, Mjalti i Gështenjës së Tropojës, Mjalti i Gështenjës së Malësisë së Madhe, Boronica e Bjeshkëve të Tropojës, Boronica e Bjeshkëve Kuksiane.

Shtimi i këtyre aplikimeve reflekton kushtet e përshtatshme që sollën ndryshimet në ligjin nr. 9947 datë 07.07.2008, "Për Pronësinë Industriale" i ndryshuar, për pjesën e treguesëve gjeografikë dhe procedurat për regjistrimin e tyre. Ky ligj, për herë të parë, plotëson kuadrin ligjor të përafuar me kriteret e BE për mbrojtjen e treguesve gjeografikë. Regjistrimi i këtyre produkteve si objekte të pronësisë industriale u jep atyre vlerë të shtuar ekonomike duke nxitur prodhuesit t'i hedhin ato në treg, nën indikacionet e mbrojtura të origjinës duke iu përmbajtur cilësisë dhe karakteristikave unike të produkteve. Ky sistem, krijon gjallërimin e aktivitetit prodhues dhe tregtar në zonat rurale, zhvillim të turizmit, hapje të vendeve të reja të punës dhe eksport të produkteve shqiptare edhe në tregjet përtej kufijve.

Hapi i radhës për të konsoliduar mbrojtjen ligjore të treguesve gjeografikë, është anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Lisbonës dhe Aktin e Gjenevës së kësaj marrëveshjeje, duke mundësuar regjistrimin ndërkombëtar të tyre. Kjo marrëveshje lehtëson regjistrimin e produkteve shqiptare në vendet e huaja, si dhe hedhjen e produkteve të huaja në tregun shqiptar, të garantuara për llojin dhe cilësinë e tyre.

Për ta mbyllur, mbetem me besimin dhe vullnetin e plotë që zhvillimi i sistemit të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë, tashmë është në rrugën e duhur.

Me respekt,

Elvin Lako

Drejtor i Përgjithshëm

HYRJE

PRONËSIA INDUSTRIALE

Sistemi i Pronësisë industriale është mjeti juridik që siguron mbrojtjen dhe rregullon të drejtat e pronësisë mbi patentat për shpikje, markat tregtare, disenjot industriale, treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, duke krijuar mundësinë për t'i përdorur dhe shfrytëzuar ato ekonomikisht si dhe disponuar me anë të licencimit apo transferimit të tyre.

Pronësia industriale, në aspektin juridik është një sistem që garanton mbrojtjen e pronës jo fizike, e cila për nga rëndësia, është e njëjtë me të drejtat mbi pronën fizike dhe gëzon mbrojtje të shprehur si pjesë e të drejtave themelore të njeriut. Kjo lloj pronësie gjithashtu i nënshtrohet kufizimeve në ushtrimin e të drejtave mbi to, bazuar në interesa publike dhe përkundrejtë një shpërblimi të drejtë.

Fusha e zbatimit të pronësisë industriale shtrihet në industri, tregti, bujqësi, si dhe në zhvillimin e të gjitha produkteve natyrore ose të përpunuara.

Pronësia industriale është e lidhur ngushtë me inovacionin dhe luan rol kyç në zhvillimin ekonomik dhe shkencor. Nëpërmjet sistemit të mbrojtjes së kësaj pronësie, mundësohet shpërndarja e informacionit mbi arritjet e reja teknologjike, kursehet puna e dyzuar për kërkimin shkencor dhe më e rëndësishmja, nxitet dhe përshejtohet krijimtaria.

Për një aktivitet tregtar të suksesshëm, në aktualitetin e sotëm, nevojiten gjithnjë e më shumë prurje të risive duke investuar në dije dhe teknologji të reja. Sipërmarrja dhe përfshirja në projekte inovative mbart gjithmonë me vete edhe riskun e humbjes dhe të dështimit për biznesin, ndaj mbrojtja e pronësisë industriale përbën një lloj suporti dhe garancie për sipërmarrësit, sepse mundëson ndalimin e kujtqë do të synonte të përfitonte pa merituar nga idetë, investimi, dhe reputacioni i tyre.

Kështu, pronësia industriale duhet kuptuar edhe si mbrojtje ndaj konkurrencës së pandershme me anë të së cilës mund të ushtrohet ndalimi i përdoruesëve të paautorizuar që keqorientojnë konsumatorët dhe dëmtojnë interesat e ligjshme të mbajtësve të së drejtave.

Imitimet apo kopjimet e markave tregtare, disenjove, apo patentave për shpikje me qëllim përfitimin nga reputacioni dhe emri i mirë që ato mund të kenë në treg, bën që të dëmtohen ekonomikisht dhe moralisht pronarët e tyre, por edhe konsumatorët që duke u mashtruar nga shenjat e falsifikuara, blejnë mallra të një cilësie më të dobët, duke menduar që po blejnë mallrat origjinale.

Sa më të forta të jenë politikat e mbrojtjes së sistemit të pronësisë industriale të një vendi, aq më e zhvilluar do të jetë ekonomia e tij, prandaj ajo duhet njohur, vlerësuar dhe mbrojtur maksimalisht nga politikat shtetërore, sipërmarrësit, individët dhe e gjithë shoqëria.

PJESA I

PROFILI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

-DPPI, Institucioni që ju bën pronarë të markave, patentave për shpikje, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë!-

STATUSI

Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (DPPI) është institucion publik jobuxhetor që funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë dhe ka selinë e vet në Tiranë. Veprimtaria e DPPI përcaktohet dhe rregullohet me anë të Ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008, ‘Për Pronësinë Industriale’, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatimin të tij.

DPPI është institucioni i vetëm nëpërmjet të cilit shteti shqiptar jep të drejtat mbi patentat mbi shpikjet dhe modelet e përdorimit, topografinë e produkteve gjysmëpërçues, markat tregtare dhe të shërbimit, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë, duke iu njohur mbajtësve të së drejtave pronësinë mbi këto objekte, nëpërmjet regjistrimit.

MISIONI


DPPI ka si mision të forcojë mbrojtjen e pronësisë industriale brenda territorit shqiptar nëpërmjet njohjes, regjistrimit, dhe promovimit të këtyre të drejtave, për të garantuar një nivel mbrojtjeje të njëjtë me atë të vendeve të Bashkimit Evropian.

DPPI ka logon dhe vulën e saj të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Organet drejtuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale janë:

Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm.

STRUKTURA



Shënim: Struktura e mësipërme do të ndryshojë në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndyshuar. Në strukturën e re, do të forcohen kapacitetet për regjistrimin dhe promovimin e PI. Ndër të tjera do të krijohet një zyrë e posaçme për pritjen dhe procesimin e aplikimeve, si dhe do të krijohet Qendra e Trajnimeve si një hallkë e re dhe shumë e rëndësishme brenda DPPI .

SHËRBIMET QË OFRON DPPI

Nr sherbimeve	Lloji i shërbimit
	PATENTAT PËR SHPIKJET
1	Kërkesë për regjistrimin kombëtar të patentës për shpikje
2	Kërkesë për regjistrimin kombëtar të patentës për shpikje sipas TBP
3	Kërkesë për shtrirjes të patentës evropiane
4	Kërkesë për shtrirjen e aplikimit për patentë evropiane
5	Kërkesë për vlefshmëri të patentës evropiane
6	Kërkesë për vlefshmëri të aplikimit për patentë evropiane
7	Kërkesë për konvertimin e aplikimit për patentë evropiane në aplikim për patentë kombëtare.
8	Kërkesë për kthimin e kërkesës për patentë shpikjeje në kërkesë për model përdorimi
9	Kërkesë për dhënien e Certifikatës së Mbrojtjes Shtesë për Produktet Mjekësore dhe Produktet e Mbrojtjes së Bimeve
10	Kërkesë për apelim në bordin e apelit të refuzimit të certifikatës së mbrojtjes shtesë
11	Kërkesë për pavlefshmëri të certifikatës së mbrojtjes shtesë
12	Aplikim për Patentë Evropiane
13	Kërkesë për aplikim ndërkombëtar për patentë
14	Kërkesë për kundërshtimin e dhënies të patentës për shpikje
15	Kërkesë për ripërteritjen e patentës për shpikje.
16	Kërkesë për publikimin e ndryshimeve në pretendime të patentave evropiane të shtrira ose të Patentave Evropiane të validuara.
17	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të patentës për shpikje
18	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë, të patentës për shpikje
19	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së licenses të patentës për shpikje
20	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të garancisë/pengut për patentën për shpikje
21	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të veprimeve përmbarimore për patentën për shpikje
22	Kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të Patentës për Shpikje
23	Kërkesë për apelimin e refuzimit të patentës për shpikje në Bordin e Apelimit
24	Kërkesë për rivendosjen në afat të patentës
25	Kërkesë për ndarjen e aplikimit fillestar për patentë.
26	Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi për patentë
27	Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi ose certifikata e mbrojtjes shtesë.
28	Kërkesë për publikim të parakohshëm të aplikimit për patentë

29	Kërkesë për shqyrtim të mëtejshëm ose zgjatje afatit të aplikimit për patentë
30	Kërkesë për korrigjimin e pasaktësive në të dhënat e patentës.
	MARKAT TREGTARE
31	Aplikim për regjistrim kombëtar të markës individuale
32	Aplikim për regjistrim kombëtar të markës kolektive ose certifikuese
33	Kërkesë për transferimin e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar të markës.
34	Kërkesë për transferim aplikimi për shtrirje e mëvonshme territoriale të mbrojtjes së Markë Tregtare ndërkombetare.
35	Kërkesë për transformim të regjistrimit ndërkombëtar në aplikim kombëtar.
36	Kërkesë për kufizimin e listës së mallrave
37	Kërkesë për ndarjen e aplikimit fillestar për regjistrim marke
38	Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të një marke në dhomën për shqyrtimin e kundërshtimeve
39	Kërkesë për rivendosjen në afat
40	Kërkesë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni
41	Kërkesë për shfuqizimin/ zhvlerësimin e një marke në dhomën për shfuqizim /zhvlerësim.
42	Kërkesë për apelimin në Bordin e Apelit të vendimeve të marrë nga Dhoma për Shqyrtimin e Kundërshtimeve dhe nga Dhoma për Shfuqizim /Zhvlerësim
43	Kërkesë për apelim të refuzimit në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim.
44	Kërkesë për ripërtëritjen e markës
45	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë mbi markën
46	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit në emër të pronarit të markës
47	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së licensës në regjistrin e markave
48	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së pengut në regjistrin e markave
49	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të veprimeve përmbarimore në regjistrin e markave.
50	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të pasqyrimin të ndryshimeve të tjera në regjistrin e markave
51	Kërkesë për regjistrimin në regjistrimin në regjistër të ndryshimit në adresë.
52	Kërkesë për dorëheqje nga marka e regjistruar.
53	Kërkesë për saktësimin e të dhënave mbi markën
54	Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi për markë.
55	Kërkesë për observim ndaj markës së publikuar
	MODELE PËRDORIMI
56	Kërkesë për regjistrimin kombëtar të modelit të përdorimit
57	Kërkesë për kundërshtimin e dhënies së modelit të përdorimit
58	Kërkesë për ripërteritjen e modelit të përdorimit

59	Kërkesë për regjistrimin e transferimit të pronësisë mbi modelin e përdorimit
60	Kërkesë për regjistrimin e ndryshimit të adresës së aplikantit/pronarit të modelit të përdorimit
61	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të modelit të përdorimit
62	Kërkesë për regjistrimin e kontratës së licensës të modelit të përdorimit
63	Kërkesë për regjistrimin të garancisë/pengut të modelit të përdorimit
64	Kërkesë për regjistrimin të veprimit përmbartimor të modelit të përdorimit
65	Kërkesë për apelimin e refuzimit të modelit të përdorimit në Bordin e Apelimit
66	Kërkesë për rivendosjen në afat të modelit të përdorimit
67	Kërkesë për dorëheqje nga aplikimi për modelin e përdorimit
68	Kërkesë për publikim të parakohshëm të modelit të përdorimit
69	Kërkesë për shqyrtim të mëtëjshëm ose zgjatje afatit të modelit të përdorimit
70	Kërkesë për ndarje të aplikimit për model përdorimi
71	Kërkesë për korrigjimin e të dhënave të modelit të përdorimit
DISENJO INDUSTRIALE	
72	Kërkesë për regjistrim kombëtar të disenjos industriale
73	Kërkesë për depozitimin e çdo kërkesë të ndarë
74	Kërkesë për transferimin e aplikimit për regjistrim ndërkombëtar të disenjos industriale
75	Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të një diseno industriale në dhomën për shqyrtimin e kundërshtimeve
76	Kërkesë për rivendosjen në afat
77	Kërkesë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni
78	Kërkesë për shfuqizimin e disenjos industriale në dhomën për shfuqizim /zhvlerësim.
79	Kërkesë për apelimin në Bordin e Apelit
80	Kërkesë për apelim të refuzimit në dhomën për shfuqizim /zhvlerësim.
81	Kërkesë për ripërtëritjen e disenjos industriale
82	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë mbi disenjon industriale
83	Kërkesë për regjistrimin në regjistrin e disenjove industriale të kontratës së licensës.
84	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së pengut mbi disenjot industriale
85	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të veprimeve përmbartimore mbi disenjot industriale
86	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimeve të tjera mbi disenjot industriale
87	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit të adresës të aplikantit/pronarit të disenjos industriale.
88	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të disenjos industriale.

89	Kërkesë për dorëheqje nga disenjo industriale
90	Kërkesë për saktësimin e të dhënave mbi disenjon industriale
91	Kërkesë për shtyrje të afatit të publikimit të disenjos industriale
	TREGUES GJEOGRAFIKË
92	Kërkesë për regjistrim të treguesit gjeografikë
93	Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të treguesit gjeografik
94	Kërkesë për apelimin e vendimit të refuzimit të treguesit gjeografikë në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim
95	Kërkesë për shfuqizimin e treguesit gjeografik në dhomën për shfuqizim /zhvlerësim.
96	Kërkesë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni
97	Kërkesë për ndryshime në specifikimet e produktit
98	Kërkesë për apelim në Bordin e Apelit
	EMËRTIME ORIGJINE
99	Kërkesë për regjistrim të emërimit të origjinës
100	Kërkesë për kundërshtimin e regjistrimit të emërimit të origjinës
101	Kërkesë për apelimin e vendimit të refuzimit të emërimit të origjinës në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim
102	Kërkesë për shfuqizimin e emërimit të origjinës në dhomën për shfuqizim /zhvlerësim.
103	Kërkesë për zgjatjen e afatit për plotësim dokumentacioni të aplikimit për emërtim origjine.
104	Kërkesë për ndryshime në specifikimet e produktit të emërimit të origjinës.
105	Kërkesë për apelim në Bordin e Apelit
	TOPOGRAFI TË PRODUKTEVE GJYSËMPËRCUES
106	Kërkesë për regjistrim të topografisë së produktit gjysëmpërcues.
107	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit në adresës të topografisë së produktit gjysëmpërcues.
108	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të ndryshimit të emrit të aplikantit/pronarit të topografisë së produktit gjysëmpërcues.
109	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të transferimit të pronësisë së topografisë së produktit gjysëmpërcues.
110	Kërkesë për regjistrimin në regjistër të kontratës së licensës së topografisë së produktit gjysëmpërcues.
111	Kërkesë për apelim pranë Bordit të Apelit.
112	Kërkesë për kundërshtim të aplikimit të topografisë së produkteve gjysëmpërcues.
113	Kërkesë për dorëheqje nga topografia e produkteve gjysëmpërcues.
	II. SHËRBIME TË TJERA
114	Kërkesë për licensim si ekspert për Patentat e Shpikjeve dhe Modeleve të Përdorimit.

115	Kërkesë për licensim si ekspert për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë.
116	Kërkesë për rinovim License të eksperteve për Patentat e Shpikjeve dhe Modeleve të Përdorimit.
117	Kërkesë për rinovim License të ekspertëve për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë.
118	Kërkesë për licensim si Përfaqësues i autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit.
119	Kërkesë për licensim si Perfaqesues i Autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë.
120	Kërkesë për rinovim License për përfaqësuesit e autorizuar për patentat e shpikjeve dhe modeleve të përdorimit.
121	Kërkesë për rinovim license për perfaqesuesit e autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë.
122	Kërkesë për trajnim në qendrën e trajnimeve të Pronësisë Industriale në DPPI.
123	Kërkesë për lëshim të dokumentit të prioritetit të patentës për shpikje
124	Kërkesë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për markën
125	Kërkesë për lëshim të dokumentit të prioritetit për modelin e përdorimit
126	Kërkesë për lëshimin e dokumentit të prioritetit për diseno industriale
127	Kërkesë për dokument prioriteti të topografisë së produkteve gjysëmpërcues.
128	Kërkesë për dokument prioriteti për treguesit gjeografikë
129	Kërkesë për dokument prioriteti për emërtimet e origjinës
130	Kërkesë për për inspektim dosje për objektet e PI(marka, patenta, certifikatë të mbrojtjes shtesë, model përdorimi, tregues gjeografik, diseno industriale, emërtime të origjinës dhe topografive të produkteve gjysëmpërcuese.
131	Kërkesë për dublikatë për patentë për shpikje
132	Kërkesë për dublikat për certificate të mbrojtjes shtese
133	Kërkesë për lëshim dublikati të akteve administrative mbi markat
134	Kërkesë për dublikatë për model përdorimit
135	Kërkesë për lëshim dublikate të akteve administrative mbi disenjot industriale
136	Kërkesë për lëshim dublikate të akteve administrative mbi emërtimet e origjinës
137	Kërkesë për dublikatë të topografisë së produkteve gjysëmpërcues.
138	Kërkesë për lëshim dublikate të akteve administrative mbi treguesit gjeografikë
139	Kërkesë për hetim për patenta për shpikje
140	Kërkesë për hetim për certifikatë të mbrojtjes shtesë për
141	Kërkesë për hetim mbi markën
142	Kërkesë për hetim mbi diseno industriale
143	Kërkesë për hetim për model përdorimi
144	Kërkesë për hetim mbi treguesit gjeografikë
145	Kërkesë për hetim mbi emërtimet e origjinës.
146	Kërkesë për hetim mbi topografinë e produkteve gjysëmpërcues.
147	Kërkesë për lëshim ekstrakti nga rregjistri i patentave për shpikje
148	Kërkesë për lëshim ekstrakti nga rregjistri i modeleve të përdorimit

149	Kërkesë për lëshim ekstrakti nga regjistri i disenjove industriale .
150	Kërkesë për lëshim ekstrakti nga regjistri i markave.
151	Kërkesë për lëshim ekstrakti nga regjistri i treguesve gjeografikë
152	Kërkesë për lëshim ekstrakti nga regjistri i emërtimeve të origjinës
153	Kërkesë për ekstrakt nga regjistri i topografive të produkteve gjysëmpërcues.
154	Kërkesë për revokim të akteve administrative.

LEGJISLACIONI

Aktiviteti i DPPI përcaktohet dhe rregullohet nga Ligji Nr. 9947 datë 07.07.2008 "Për Pronësinë Industriale", i ndryshuar, dhe rregulloret në zbatim të tij.

Gjithashtu, DPPI bazohet në konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare më të rëndësishme mbi Pronësinë Intelektuale që Shqipëria ka nënshkruar si:

- Konventa e Parisit “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale”, e miratuar në Paris më 20 Mars 1883-hyrë në fuqi në Shqipëri më 4 Tetor 1995;
- Ligj Nr. 8993, datë 30.1.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për themelimin e Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale” - hyrë në fuqi në Shqipëri më 30 Qershor 1992.

Për mbrojtjen e Patentave për Shpikjet

- Ligji Nr. 9031, datë 20.3.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin e Budapestit për njohjen ndërkombëtare të depozitimit të mikroorganizmave, për qëllime të procedurës së patentave” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 19 Shtator 2003;
- Ligji Nr. 9532, datë 15.5.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Marrëveshjen e Strasburgut për klasifikimin ndërkombëtar të patentave, 1979” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 24 Korrik 2007;
- Ligji Nr. 10180, datë 29.10.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen për të drejtën e patentave të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale” (WIPO) – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 17 Maj 2010;
- Ligji Nr. 10179, datë 29.10.2009 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Evropiane të Patentave” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 1 Maj 2010
- Ligji Nr. 118/2013, datë. 18.04.2013 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Londrës për zbatimin e Nenit 65 të Konventës për Patentat Evropiane".

Për mbrojtjen e Varieteteve Bimore

Ligji Nr. 9395, datë 12.5.2005 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare “Për mbrojtjen e varieteteve të reja të bimëve” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 15 Tetor të vitit 2005.

Për mbrojtjen e Disenjove Industriale

- Ligji Nr. 9648, datë 27.11.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale, 1960” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 19 Mars 2007;
- Ligji Nr. 9647, datë 27.11.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në aktin e Gjenevës të marrëveshjes së Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale dhe rregulloret mbështetur në aktin e Gjenevës, 1999”.

Për mbrojtjen e Markave Tregtare

- Marrëveshja e Madridit e datës 14 prill 1891 “Për regjistrimin ndërkombëtar të markave” - hyrë në fuqi në Shqipëri më 4 Tetor 1995;
- Ligji Nr. 8992, datë 30.1.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Protokollin e marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 30 Korrik 2003;
- Ligji Nr. 9033, datë 20.3.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Nicës për klasifikimin ndërkombëtar të mallrave dhe shërbimeve, për qëllimet e regjistrimit të markave” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 19 Shtator 2003
- Marrëveshje me Organizatën Botërore të Tregtisë (WTO);
- Marrëveshja e TRIPS-it (Aspekte të Tregtisë që lidhen me Pronësinë Intelektuale) – 08.09.2000.

Akte të tjera ligjore dhe nënligjore, që lidhen me fushën e zbatimit të mbrojtjes së pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë.

- 1- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.
- 2- Kodi penal i RSH.
- 3- Kodi civil i RSH.
- 4- Ligji për ushqimin.
- 5- Ligji për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
- 6- Ligji Nr. 9918, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Për Komunikimet Elektronike në Republikën E Shqipërisë”.
- 7- Ligji Nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”.

- 8- VKM Nr. 463, datë 5.7.2006 “Për miratimin e planit kombëtar për zbatimin e marrëveshjes së stabilizim-asociimit”.
- 9- Vendim Nr. 1058, datë 23.12.2015 Për Miratimin e Rregullit Teknik "Mbi emrat e fibrave tekstile dhe etiketimi e markimi përkatës i përbërjes së fibrave të produkteve tekstile".
- 10- VKM Nr. 1344, datë 10.10.2008 Për miratimin e rregullave për etiketimin e mallrave ushqimore
- 11- Ligj Nr. 9591, datë 27.7.2006 Për ratifikimin e "Marrëveshjes së Përkohshme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar".
- 12- VKM Nr. 299, datë 8.4.2015 Për Miratimin e Rregullores për dhënien e autorizimit të tregtimit të barnave e të klasifikimit të tyre në Republikën e Shqipërisë.
- 13- Ligji Nr. 9199, datë 26.2.2004 “Për prodhimin, perpunimin, certifikimin dhe tregtimin e produkteve "bio".
- 14- Ligji Nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.
- 15- Ligj Nr. 9474, datë 09.2.2006 “Për ratifikimin e konventës kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë "Për kontrollin e duhanit".
- 16- Ligji Nr. 9077, datë 09.6.2003 “Për ratifikimin e "Marrëveshjes për tregtinë e lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Bullgarisë".
- 17- Ligji Nr. 9050, datë 17.4.2003 “Për ratifikimin e "Marrëveshjes për tregtinë e lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë".
- 18- Ligji Nr. 9050, datë 17.4.2003 “Për ratifikimin e "Marrëveshjes për tregtinë e lirë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Rumanisë".
- 19- Ligji Nr. 8892, datë 14.5.2002 për ratifikimin e “Marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet qeverisë Shqiptare dhe qeverisë Maqedonase”;
- 20- Ligji Nr. 8973, datë 21.11.2002 “Për ratifikimin e "Marrëveshjes së tregtisë së lirë ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kroacisë".

STRATEGJIA

Qëllimet strategjike të DPPI për periudhën 2016-2020 bazohen në objektivat e ndërmarra në “Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020” dhe konkretisht synohet të arrihet:

Një sistem më i fortë i pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë, i cili siguron një mbrojtje efektive të objekteve të PI, inkurajon krijimtarinë dhe inovacionin në funksion të stimulimit të rritjes ekonomike dhe zhvillimit kulturor dhe shkencor në Republikën e Shqipërisë.

Fokusi i DPPI-së do të jetë përmirësimi i funksionimit të sistemit të pronësisë industriale me qëllim, nxitjen dhe mbështetjen e inovacionit nëpërmjet nxitjes së punës kërkimore, në veçanti nga kompanitë shqiptare, universitetet vendase dhe individët, për të asistuar ekonominë shqiptare dhe qytetarët në rrugën drejt zhvillimit ekonomik dhe drejt standardeve më të larta.

Synohet gjithashtu rritja e ndërgjegjësimit, si dhe forcimin e sistemit të regjistrimit, administrimit dhe mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga pronësia intelektuale, si të drejta që ushtrojnë një ndikim të fuqishëm në zhvillimin dhe mirëfunksionimin e ekonomisë.

Në përputhje me kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritetit të Republikës së Shqipërisë, sistemi i pronësisë industriale në vend, duhet të garantojë efektivisht një nivel të lartë mbrojtje të të drejtave të Pronësisë Intelektuale, të njëjtë me atë që ekziston në Bashkimin Evropian.

Objektivat e politikës dhe produktet madhore të Strategjisë janë:

- 1. Përmirësimi i kuadrit ligjor**
- 2. Zhvillimi dhe forcimi i institucioneve të përfshira në zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale**
- 3. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve, si në nivel kombëtar, ashtu edhe në nivel rajonal apo me gjerë, në funksion të përmirësimit të punës për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale**
- 4. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut në Republikën e Shqipërisë lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale.**

Tekstin e plotë të “Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020” e gjeni në linkun bashkëlidhur: http://www.dppm.gov.al/previewdoc.php?file_id=856

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ROLI I DPPI

Në ditët e sotme kur tregu është dinamik dhe konkurrenca është shumë e lartë, funksionet e një institucioni të pronësisë industriale marrin rëndësi të veçantë. Ky institucion duhet të jetë i aftë për të promovuar dhe shpërndarë informacionin në lidhje me rëndësinë që mbart në vetëvete sistemi i pronësisë industriale, gjithnjë në mbështetje të zhvillimit ekonomik, inovacionit dhe shoqërisë.

Në këtë situatë DPPI po punon të jetë më shumë se thjesht një zyrë për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale. Fokusi i saj është të promovojë këtë lloj pronësie, që nxit inovacionin nëpërmjet njohjes së titujve të pronësisë mbi asetet jo fizike, siç janë markat, patentat për shpikje, disenjot industriale, treguesit gjeografikë etj., të cilat kanë vlerë konkrete ekonomike dhe monetare. Përfitimet ekonomike prej këtyre objekteve sigurohen vetëm nëpërmjet njohjes, regjistrimit dhe mbrojtjes së tyre nga shkelësit e të drejtave. Nisur nga funksioni që ka, DPPI është organi administrativ më i rëndësishëm në sistemin e pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë. Duke mbrojtur shpikjet dhe inovacionin, krijohet baza e duhur për ekzistencën e marrëdhënies së ndërsjelltë qeveri, biznes dhe qendrat e informacionit teknik e shkencor në

universitete, si aktorët kryesorë që kontribuojnë në promovimin e përfitimeve që rrjedhin nga inovacioni.

Në bashkëpunim me ZEP, DPPI ka mundësuar aksesimin në gjuhën shqipe në Espacenet, i cili është një sistem kërkimi që ofron pa pagesë informacionin rreth shpikjeve dhe zhvillimeve teknologjike që nga shekulli i 19-të e deri më sot. Nëpërmjet përdorimit të këtij sistemi kërkimi shpikësit shqiptarë, bizneset apo qendrat e kërkimit, por edhe fillestarët, mund të marrin informacion nëse një patentë për shpikje është lëshuar dhe nëse është ende në fuqi. Gjithashtu, Espacenet shërben për të kërkuar dhe gjetur publikimet e patentave, përkthyer dokumentet nga makina e përkthimit, për të ndjekur përparimin e teknologjive të reja, për të gjetur zgjidhje të problemeve teknike, apo për t'u informuar se çfarë janë duke zhvilluar konkurrentët.

Po kështu, në bashkëpunim me ZBEPI u mundësua integrimi në modulet TMclass, TMview dhe Design View, të cilët janë janë sisteme kërkimi të menaxhuara nga Zyra e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale për mallrat dhe shërbimet sipas klasifikimit të Nicës, markat tregtare dhe disenjot industrial. Duke zgjeruar territorin ku shpërndahet informacioni mbi markat tregtare dhe disenjot industriale arrihet edhe forcimi i mbrojtjes dhe shtimi i reputacionit të tyre. Gjithashtu, përdorimi i këtyre të dhënave lehtëson kompanitë e huaja që kërkojnë të shtrijnë mbrojtjen në territorin e Republikës së Shqipërisë, të marrin informacion në kohë reale mbi statusin e aplikimeve të tyre. Kjo, rrjedhimisht ndikon në shtimin e aplikimeve nga subjektet e huaja në Republikën e Shqipërisë.

DPPI në vitin 2014 u caktua si institucioni lider për Kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale”, për të gjithë fushën e pronësisë intelektuale dhe kryen rolin e koordinatorit për të gjitha institucionet që veprojnë në këtë fushë. Rëndësia e këtij institucioni bëhet edhe më e evidente në kuadër të detyrimeve dhe angazhimeve për anëtarësim të Shqipërisë në BE. Qeveria shqiptare ka miratuar me VKM nr. 330, datë 28 maj 2014 “Për miratimin e udhëzimit për pesë përparësitë e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013”. Në këtë udhëzim, të drejtat mbi këtë lloj pronësie, përfshihen në prioritetin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Duke pasur statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE në vitin 2014, ndër objektivet kryesorë për momentin është fillimi i bisedimeve të pranimit me BE-në për të arritur anëtarësimin. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) e nënshkruar me BE-në në vitin 2006, përcakton drejtimin strategjik për vendin dhe objektivat e politikës së saj afatshkurtër dhe afatmesme.

DPPI luan rolin kryesor të Sekretariatit Teknik për Monitorimin e aktivitetit të të gjitha këtyre institucioneve për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020”. Ky është një nga dokumentet më të rëndësishme në fushën e garantimit të mbrojtjes së të drejtave të PI në Republikën e Shqipërisë, që parashikon një bashkëpunim të të gjitha institucioneve të përfshira në sistemin e PI, si; DPPI, gjykatat, policia, prokuroria, Inspektorati Shtetëror i Mbikqyrjes së Tregut, doganat, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, si dhe institucione të tjera, grupet e interesit, dhomat e tregtisë, universitetet, shoqëritë e menaxhimit kolektiv, mediat, bizenset, përfaqësuesit e autorizuar, etj.

DPPI ofron plot 154 shërbime për publikun, të grupuara sipas metodologjisë së kodifikimit dhe klasifikimit të shërbimeve publike, të krijuar nga Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA). Këto shërbime janë cilësore me standarde të njëjta me ato të vendeve të BE. Me ndryshimet që u bënë me miratimin e Ligjit Nr. 17/2017, datë 16.02.2017 dhe Ligjit nr. 9947, datë 07.07.2008, “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, baza ligjore ku mbështeten funksionet e DPPI, tashmë është e përshtatshme për të realizuar reformat në fushën e pronësisë industriale. Ky ligj parashikon transformimin e DPPI duke i shtuar asaj kompetenca që i japin mundësi të sigurojë jo vetëm lehtësimin e procedurave të aplikimit për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, por edhe të parandalojë krijimin e konflikteve mbi to, sidomos mbi markat tregtare. Kjo modernizon tërësisht shërbimin e ofruar, duke përdorur disa mekanizma që do t’i ofrojnë mbajtësve të të drejtave, informacion në kohë reale për aplikimet që çenojnë të drejtat mbi objektet e regjistruara. Gjithashtu, janë ngritur struktura të reja brenda DPPI, për të shqyrtuar rastet e konflikteve mbi objektet e pronësisë industriale nëpërmjet dy shkallëve të shqyrtimit që janë: Dhoma e Shqyrtimit të Kundërshtimeve dhe Bordi i Apelimit në DPPI, duke mundësuar parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve mbi objektet e pronësisë industriale. Kjo problematikë ka qenë në vëmendjen tonë, pasi dihet që shkeljet e të drejtave mbi objektet e pronësinë industriale sjellin kosto në kohë dhe në vlera monetare për palët në konflikt.

Sipas parashikimeve të ligjit, do të krijohet zyra e pritjes dhe informacionit, si pjesë e strukturës së DPPI, që do të procedojë menjëherë me shqyrtimin e formaliteteve për aplikimet që paraqiten, duke shkurtuar ndjeshëm procedurat e regjistrimit, ndërsa aktualisht në vitin 2017, në kuadër të reformës së deregulimit e cila është një nismë e qeverisë shqiptare, e cila konsiston në reduktimin e lejeve, licencave, autorizimeve dhe procedurave, me qëllim uljen e burokracisë dhe rritjen e efikasitetit të institucioneve shtetërore.

Është rritur cilësia e ekzaminimit të objekteve të pronësisë industriale, duke u ardhur në ndihmë aplikantëve dhe mbajtësve të të drejtave.

Parashikohet edhe përdorimi si kolateral i objekteve të regjistruara të pronësisë industriale. Asetet jo-fizike do të marrin vlerë monetare konkrete nëpërmjet shitblerjes së tyre, duke e bërë tregun shqiptar edhe më dinamik.

Në kuadër të reformimit, DPPI synon përmirësimin e shërbimeve nëpërmjet krijimit të mundësisë për aplikimin on-line dhe lëshimit të certifikatave elektronike, duke sjellë lehtësi për aplikuesit. Gjithashtu, synohet të krijohet biblioteka me materiale informuese mbi çështjet e PI, për lehtësimin e marrjes së informacionit mbi njohuritë dhe të rejtat teknologjike që përmban inovacioni mbi shpikjet e patentuara, po kështu pjesë e strategjisë është edhe hartimi i kurrikulave për studimin e PI edhe në shkollat e mesme të përgjithshme dhe ato 9-vjeçare.

DPPI zhvillon një numër të madh aktivitetesh, si konferenca, seminare, trajnime dhe takime me të gjitha grupet e interesit për promovimin dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e pronësisë industriale. Përfitimi që vjen nga këto aktivitete është maksimal për ekonominë e vendit dhe për

vetë individët, bizneset dhe universitetet. Krijuesit dhe inovatorët, studentët dhe brezi i ri, duhet të ndjehen të përfshirë në kontekstin e këtij sistemi duke besuar dhe investuar në zhvillimin e pronësisë industriale si mjet fitimi ekonomik, por edhe duke qenë të kujdesshëm në respektimin e punës së të tjerëve, duke mos shkelur të drejtat e askujt. Për këtë qëllim, DPPI ka ngritur dy Qendra të Informacionit Teknik dhe Shkencor, pranë Universitetit “Politeknik” në Tiranë dhe një në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë. Parashikohen të ngrihen edhe dy qendra të tjera të këtij lloji, një në Universitetin e Shkodrës dhe një në Universitetin e Korçës. Funksioni i këtyre qendrave do të jetë lehtësimi në qasjen ndaj informacionit mbi fushën e pronësisë industriale, sidomos mbi patentat për shpikje, për studentët dhe të gjithë të intersuarit.

DPPI është institucioni që zbaton marrëveshjet ndërkombëtare mbi të drejtat e pronësisë industriale. Mbrojtja e këtyre të drejtave, në ditët e sotme të globalizimit, merr një rëndësi prioritare për aktivitetin tregtar. DPPI kryen rolin e institucionit që koordinon punën me organizatat ndërkombëtare më të rëndësishme mbi mbrojtjen e të drejtave të PI, si: OBPI, ZEP dhe ZBEPI, si dhe me zyrat homologe të vendeve të tjera për të harmonizuar bazën ligjore dhe praktikat për mbrojtjen e të drejtave të PI.

DPPI ka të nënshkruara edhe Memorandume Mirëkuptimi dhe marrëveshje bashkëpunimi teknik me këto organizata dhe zyra homologe.

HISTORIK MBI DPPI

Po paraqesim një historik të shkurtër të institucionit tonë, duke qenë se në datë 22 Mars të vitit 2018 mbushen plot 25 vjet nga krijimi i tij.

Pronësia industriale në Shqipëri i ka fillimet e saj qysh në vitin 1920. Nga burimet arkivore të kohës mësojmë se tregtarët shqiptarë kanë qenë tepër të ndjeshëm ndaj ruajtjes së produkteve të tyre nga falsifikatorët. Për të realizuar këtë, ata kërkonin mbrojtjen e prodhimeve të tyre me anë të regjistrimit të markës. Marka e parë tregtare daton në 16 prill të vitit 1920, lëshuar për “HOBDAIR”. Kjo markë u përdor për produktet e kompanisë “Hobdari” që nga fillimi i vitit 1914 e cila krijoi fabrikën e sapunit. Gjithashtu, janë mbrojtur një numër i madh markash të huaja në Shqipëri si: SIMANCO, SINGER, KAFFE HAG, RETTUNGSRING, etj.

Historikisht Republika e Shqipërisë ka pasur ligje për markat tregtare që nga fillimi i shekullit XX. Bazuar në dokumentet arkivore, kërkesat e ligjit për procedurën e regjistrimit të markave në Republikën e Shqipërisë, kanë qenë tepër të detajuara.

Sistemi i regjistrimit të markës tregtare ishte në fuqi deri në vitin 1944. Në vitin 1957, qeveria e asaj kohe, me vendimin e vet, njohu regjistrimin e markave të huaja në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë kësaj periudhe, janë regjistruar marka tepër prestigjioze. Në këtë kohë ishte Byroja e Regjistrimit të Markave pranë Dhomës së Tregtisë, nën varësinë e Ministrisë së Tregtisë së Jashtme, institucioni përgjegjës për regjistrimin e markave. Kjo Byro plotësonte dokumentacionin përkatës në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi “Dekreti nr. 2490 datë 22.07.1957, ndryshuar me dekretet nr. 3530 datë 02.07.1962 e Nr. 4253 datë 11.04.1967 ”Për Markat e Prodhimit dhe Tregtisë”. Këto janë edhe fillesat e Byrosë së regjistrimit të markave ku tregohen detaje të mënyrës së funksionimit të saj.

Me ndryshimet që ndodhën gjatë vitit 1990, filluan lëvizjet e para për të ngritur një zyrë të mirëfilltë të pronësisë industriale. Këto përpjekje filluan nga anëtarët të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë deri në Qershor të vitit 1992, duke ndjerë mungesën në Republikën e Shqipërisë të sistemit të mbrojtjes së patentave për shpikjet. Patentat që jepeshin me Dekretin Nr. 4548, datë 03.10.1960, shpikësit i njihej vetëm dëshmia e shpikjes, por jo e drejta ekskluzive e përdorimit të saj, e cila tashmë i kalonte shtetit. Kjo bëri që në Republikën e Shqipërisë të ndërpritej regjistrimi i patentave të huaja.

Në Republikën e Shqipërisë nuk ishte dhënë asnjë patentë shqiptare për shpikje, si dokument fizik i lëshuar konform standardeve (ligjeve) mbi të cilat veprohej në vendet e tjera apo nga organizmat e specializuara ndërkombëtare në këtë fushë. Arsyeja ishte se në Republikën e Shqipërisë nuk kishte ligj mbi patentat për shpikje. Në legjislacionin tonë ishte trajtuar në mënyrë të pjesëshme, vetëm çështja e regjistrimit të patentave të huaja për shpikje.

Me Dekretin Nr. 7316, datë 20.7.1989, të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë u shtua Neni 333A, i cili parashikonte mundësinë e regjistrimit e të mbrojtjes së patentave për shpikje të nënshtetasve të huaj në vend dhe deri në vitin 1994, rregullimi i veprimtarisë në këtë fushë (vetëm sa i takon regjistrimit të patentave të huaja për shpikje) bëhej në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 393, datë 17.11.1990 "Për mënyrën e regjistrimit të patentave për shpikjet e realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë", që përfaqësonte në vetvete thjesht, një akt nënligjor.

Nga sa më sipër, në Republikën e Shqipërisë mungonte në kuptimin e vërtetë të fjalës një legjislacion mbi patentat për shpikje apo më gjerë mbi pronësinë industriale, gjë që përbënte një çështje themelore të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të pronësisë industriale në vend. Gjithashtu, në Republikën e Shqipërisë mungonin botimet dhe tekstet mbi pronësinë industriale dhe nevojitej një staf i kualifikuar për të ngritur zyrën e pronësisë industriale në vend, për këtë arsye u pa i domosdoshëm anëtarësimi në Organizatën Botërore të Pronësisë Intelektuale dhe suporti dhe asistencë teknike e saj.

Në këto kushte, nisur dhe nga zhvillimet e kohës, kur vendi ynë do të hynte në rrugën e ekonomisë së tregut, me pjesëmarrjen në takimin “Task Force Meeting in the framework of UNDP Regional Program for the Fifth Cycle (1992 - 1996)”, 30 Sept. - 4 Oct. 1991, Celakovice, CZECHOSLOVAKIA, përfaqësuesit e Komitetit të Shkencave dhe Teknologjisë, parashtruan

nevojën për një ndihmë emergjente për Republikën e Shqipërisë përmes një projekti të UNDP për ngritjen e institucioneve në fushën e pronësisë industriale. Në këtë mbledhje u vendosen kontaktet e para me përfaqësuesit e OBPI dhe këta të fundit ndërmorrën angazhimin për të filluar menjëherë projektin e propozuar me vendin tonë.

Pas këtij takimi Dr. Inxh. Fatos Dega, Drejtori i Departamentit të Kërkimeve në Shkencat Natyrore dhe Inxhinierike në KSHT, kreu studimin “MBI GJËNDJEN E SISTEMIT TË PRONËSISË INDUSTRIALE NË SHQIPËRI DHE DISA PROBLEME TË ZHVILLIMIT TË TIJ NË TË ARDHMEN”, datë 13/02/1992. Materiali u përgatit në prag të vizitës së Kryetarit të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë në selinë e OBPI në Gjenevë.

Ky studim u paraqit nga Kryetari Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë, Prof. Dr. Petrit Skënde, fizikan, gjatë vizitës në selinë e OBPI në Gjenevë dhe takimit të tij me z. Arpad Bogsch, Drejtor i Përgjithshëm i OBPI në Shkurt të vitit 1992.

Propozimi dhe studimi i delegacionit shqiptar u prit me mjaft entuziazëm nga OBPI dhe menjëherë filloi puna për përgatitjen e bazës ligjore për ngritjen e zyrës së patentave shqiptare dhe për anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në OBPI, me qëllim e vetëm që të mundësohej suporti nga kjo organizatë për ngritjen e sistemit të pronësisë industriale.

Kështu, më datë më 22 Mars të vitit 1993 me vendimin e Këshillit të Ministrave për themelimin e Zyrës së Patentave për Shpikje, me propozim të Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë u themelua “Zyra e Patentave Për Shpikje”.

Depozitimi nga Qeveria Shqiptare i instrumentit të aderimit të Shqipërisë në “Konventën e Themelimit të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale OBPI”, u krye në Mars të vitit 1992, që hyri në fuqi më datë 30.06.1992. Që nga kjo datë Republika e Shqipërisë u bë vend anëtar me të drejta të plota i OBPI.

Me zhvillimet e mëtejshme u krye edhe aderimi në Konventën e Parisit “Për mbrojtjen e Pronësisë Industriale”, e miratuar në Paris më 20 Mars të vitit 1883, hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 4 Tetor të vitit 1995.


Në vitin 2000, kjo zyrë mori emërtimin “Drejtoria e Patentave dhe Markave” dhe veprimtaria e saj si institucion qendror publik, ishte në varësi të Këshillit të Ministrave, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 313 datë 13.06.2000, “Për Funksionimin e Drejtorisë së Patentave dhe Markave”.

Me ligjin nr. 9525 datë 25.04.2006, Drejtoria e Patentave dhe Markave bëhet institucion publik në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Aktiviteti i saj përcaktohej dhe rregullohej nga Ligji “Për Pronësinë Industriale” dhe rregulloreve për objektet e pronësisë industriale.

Me anë të Ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, u emërtua si “Drejtoria e Përgjithshme e Patentave dhe Markave” cili ishte një institucion publik, në varësi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

Më datë 1 Maj 2010, Republika e Shqipërisë aderoi në “Konventën për Patentat Evropiane” dhe tashmë është shtet anëtar në Organizatën Evropiane të Patentave.

Me ndryshimet në Ligjin Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, në 25 Mars të vitit 2017 ky institucion, hyn në një fazë të avancuar të reformimit të tij duke modernizuar sistemin e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë, me standarde të njëjta me ato të Bashkimit Evropian. Aktualisht, institucioni mban emërtimin “Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale”, emërtim ky, i vënë me qëllim gjithë përfshirjen e aktivitetit të saj për regjistrimin e të gjitha objekteve të pronës industriale dhe funksionon si agjenci autonome nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë.




MINISTRIA E TREGETISE									
Nr. Rendi	EMËRI I NDËRMARJES	QENDRA e Ndërmarrjes	Emëri e Mbledhësit i përfaqësuarit Nd/ies	Nr. i prokurës	Data e prokurës	Data e depozitimit të markës	Koha për të cilën lëshohet certifik.	Nr. certifik. Data e regjistrimit	Lloji i mallrave për të cilat është regjistruar shënja
2	Kooperativa e Punëve Artistike	Tirane	Gjoni Tuzi	-	-	17.6.958 Nr 132/22	17.6.958 deri 27.6.963	Nr. 1 14.7.958	Punime përdorues Tregatuar me regjistrim Gjoni Tuzi

MINISTRIA E TREGETISE									
Nr. Rendi	EMËRI I NDËRMARJES	QENDRA e Ndërmarrjes	Emëri e Mbledhësit i përfaqësuarit Nd/ies	Nr. i prokurës	Data e prokurës	Data e depozitimit të markës	Koha për të cilën lëshohet certifik.	Nr. certifik. Data e regjistrimit	Lloji i mallrave për të cilat është regjistruar shënja
3	Kooperativa e Punëve Artistike	Tirane	Gjoni Tuzi	-	-	17.6.958 Nr 132/22	17.6.958 deri 27.6.963	Nr. 3 14.7.958	Artikujt përdorues e shaligje. — Tregatuar me regjistrim Gjoni Tuzi

MINISTRIA E TREGETISE

4


Nr. Rend.	EMËRI I NDËRMARJES	QENDRA e Ndërmarrjes	Emëri e Mbiemëri i përfaqësuesit Nd/jes	Nr. i prokuroris	Data e prokuroris	Data e depozitimit të markës	Koha për të cilën lëshohet certifik.	Nr. certifik. Data e regjistrimit	Lloji i mallrave për të cilat është regjistruar shënja
4	Kooperative e Përcime Shtrëmbike	Çiraceë	Guëci, Lizi			Nr 132/52 17.6.958	27.6.958 deri 27.6.963	Nr 4 14.7.958	Veçlë muzhore
					Shenja dalluese në numërimin 4 faqe 2 shatërgjat				Çiraceë, me 27.6.958 Lugarkuari me regj. shirmit F. H. H. H.



MINISTRIA E TREGETISE

5

Nr. Rend.	EMËRI I NDËRMARJES	QENDRA e Ndërmarrjes	Emëri e Mbiemëri i përfaqësuesit Nd/jes	Nr. i prokuroris	Data e prokuroris	Data e depozitimit të markës	Koha për të cilën lëshohet certifik.	Nr. certifik. Data e regjistrimit	Lloji i mallrave për të cilat është regjistruar shënja
5	Kooperative e Përcime Shtrëmbike	Çiraceë	Guëci, Lizi			Nr 132/52 17.6.958	27.6.958 deri 27.6.963	Nr 5 14.7.958	Lëvizja famijesh
					Shenja dalluese në numërimin 5 faqe 2 shatërgjat				Çiraceë, me 27.6.958 Lugarkuari me regj. shirmit F. H. H. H.



L e n d a : Kalim aktiviteti

DHOMES SE TREGTISE DHE INDUSTRISE
T I R A N E

Per njoftim
MINISTRISE INDUSTRISE DHE TREGTISE
T I R A N E

Ne zbatim te Ligjit Nr 7819 dt.27.04.1994 " Per Pronesine Industriale " , aktiviteti i Dhomes se Tregtise dhe Industrise , lidhur me depozitimin dhe regjistrimin e markave tregtare , duke filluar nga data e hyrjes ne fuqi te ketij ligji , i kalon Zyres se Patentave prane Komitetit te Shkences dhe Teknologjise.

Sipas Nenit 104(3) te ketij Ligji " Diten qe hyn ne fuqi ky Ligj , i gjithe dokumentacioni i Dhomes se Tregtise ne lidhje me aktivitetin e kryer per depozitimin dhe regjistrimin e markave tregtare i kalon ne administrim Zyres se Patentave ".

Nga ana jone propozojme qe kalimi i ketij aktiviteti te behet nepermjet krijimit te nje komisioni te perbashket te Dhomes se Tregtise dhe Komitetit te Shkences dhe Teknologjise.

Paraprakisht do t'ju luteshim juve qe bashke me propozimet tuaja per kete ceshtje , ne pergjigje te propozimit tone , te na dergonit per tu njohur , bazen ligjore e nenligjore (vendimet , rregulloren dhe udhezimet) me anen e te cilave ju keni proceduar per depozitimin dhe regjistrimin e markave tregtare.

Mendojme gjithashtu se do te ishte me teper interes per te dyja palet mundesimi i nje ballafaqimi e diskutimi per kete problem. Per kete aresye do t'ju luteshim te na krijoni mundesine e nje takimi brenda dates 31.07.1994.

Mirepresim pergjigjen tuaj per bashkepunim.

K R Y E T A R I

Maksim Konomi

2582

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE
KOMITETI I SHKENCES DHE TEKNOLOGJISE

Nr. 728 Prot.

dt 27.10.1994

PROCES - VERBAL

I mbajtur sot me date 18.10.1994 ne Dhomen e Tregtise se Shqiperise ne takimin e perbashket ndermjet perfaqsesve te Komitetit te Shkences dhe Teknologjise te Republikes se Shqiperise mbi zbatimin e Ligjit Nr. 7819, date 27.04.1994, "Per pronesine Industriale", takim i kerkuar nga te dyja palet.

Midis diskutimeve te pergjithshme te te dyja paleve u ra dakort per sa me poshte vjon:

1. Te zbatojme me rigorozitet detyrimet e caktuara nga ligji ne fuqi.
2. Te merren masat e nevojeshme qe te krijohen kushtet e pershtatshme per zbatimin e tyre.
3. Te filloje dorezimi i dokumentacionit qe ndodhet ne arkivat e Dhomes se Tregtise ne arkiven perkatese te Komitetit te Shkencave dhe Teknologjise, duke filluar nga dokumentat fillestare deri ne vitin 1981, me Proces Verbal te rregullt konform kushteve teknike dhe ligjeve perkatese.
4. Te vazhdojme takimet e perbashketa ne nivel specialistesh, duke proceduar me rezultate konkrete, konkluzione me afate te rregullta dy-tre javore.
5. Gjithe procedimet e mesiperme deri ne dorezimet perfundimtare do te kryhen mbi bazen e akteve ligjore e nenligjore qe jane ne qarkullim, ose te perbashketa te cilat do te nxirren nga Dhoma e Tregtise dhe Komiteti i Shkencave dhe Teknologjise te firmosura nga te dy titullaret e Institucioneve te mesiperme, akte qe do te jene ne perputhje te plote me ligjin nr. 7819, date 27.04.1994 "Per pronesine Industriale".

Ky Proces Verbal mbahet ne dy kopje, nga nje kopje per secilen pale, u lexua, u miratua dhe u nenshkra rregullisht.

Per Dhomen e Tregtise
se Shqiperise

Sekretar i Pergjithshem
Koli SINJARI

K/Zyres Juridike, Markave dhe
Patentave
Blendi VATHI

Specialistete te Zyres
se Markave dhe Patentave

Vjollca SHOMO

Vjollca ZEZO

Per Komitetin e Shkencave
dhe Teknologjise se Shqiperise

N / Kryetari
Z. Vlash MARA

Specialistet
Diana LUGA

Andi MULLARAJ

Albert KUSHTI

Sokol HARITO

c) të mbajnë në rregull dokumentacionin teknik të kontrollit të mjeteve matëse dhe të caktojnë afatet e kontrollit periodik të mjeteve matëse të përdorimit, në përputhje me kushtet e punës së tyre, duke mos kaluar afatet maksimale që caktohen nga Drejtoria e Kontrollit të Mjeteve Matëse, pranë Këshillit të Ministrave;

d) të marrin masa për riparimin vetë ose me të tretë të mjeteve matëse të parregullta;

e) të caktojnë punonjës të aftë me detyrën e të ngarkuarit të kontrollit të mjeteve matëse, i cili kryen veprimtari vetëm në ndërmarrjen, institucionin, njësinë e repartit ushtarak dhe kooperativën bujqësore ku bën pjesë, si dhe t'i caktojë detyrat e të drejtat e tij funksionale;

f) të organizojnë kontrolle të vazhdueshme për saktësinë e matjes së mjeteve matëse në prodhim, në shpërndarje e në shërbime.

MARKË NË PRODHIM

Për markat e prodhimit dhe të tregëtisë, Dekret Nr. 2490, datë 22.7.1957, ndryshuar me dekretet Nr. 3530, datë 2.7.1962 e Nr. 4253, datë 11.4.1967.

Neni 1

Ndërmarrjet ekonomike shtetërore, kooperativiste dhe shoqërore detyrohen t'u vënë markën e prodhimit artikujve që prodhojnë.

Marka duhet të përmbajë:

- a) emrin e ndërmarrjes, të plotë ose të shkurtuar;
- b) qendrën e ndërmarrjes;
- c) emrin e plotë ose të shkurtuar të ministrisë ose të institucionit nga varet ndërmarrja;
- d) llojin e prodhimit dhe numrin e standardit, kur ka një të tillë.

Ministria e Tregëtisë së Jashtme në bashkëpunim me ministrinë ose institucionin përkatës, caktojnë listën e ndërmarrjeve si dhe listën e artikujve për të cilët është i detyrueshëm markëtimi i artikujve.

Neni 2

Marka e prodhimit mund të vihet, sipas natyrës së mallit, mbi veç mallin, në paketimin ose në etiketën e mallit.

Neni 3

Drejtuesit e ndërmarrjeve që lejojnë të dalin në shitje artikuj pa markën e prodhimit kanë përgjegjësi disiplinore dhe, kur parashikohet në ligjë, kanë edhe përgjegjësi penale.

Neni 14

Kundër vendimit të Byrosë së regjistrimit të markave tregëtare mund të bëhet ankim brenda tre muajve nga data e komunikimit të vendimit përkatës. Ankesa shqyrtohet nga ministri i Tregëtisë së Jashtme, vendimi i të cilit është i prerë.

Neni 15

Byroja e regjistrimit të markave tregëtare mban regjistrin e markave si dhe katalogët e figurave të tyre, sipas klasifikimit të mallrave, për të cilat janë lëshuar dëshmi përkatëse.

Regjistri dhe katalogët e sipërm vihen në shërbim të të gjithë personave të interesuar.

Neni 16

E drejta e përdorimit të markës tregëtare njihet nga data e depozitimit të kërkesës dhe vazhdon për dhjetë vjet. Ky afat mund të zgjatet për çdo dhjetë vjet të tjera me kërkesën e të interesuarit, duke paguar taksën përkatëse.

Kërkesa për zgjatjen e afatit duhet të bëhet para mbarimit të afatit të përdorimit. Në rast të kundërt merret një taksë shtesë.

Neni 17

Ndërmarrja që ka të drejtën e markës tregëtare mund t'i drejtohet në çdo kohë me padi, sipas rastit, gjykatës civile ose penale dhe të kërkojë ndalimin e të cilit do që të përdorë markë të njëjtë ose të ngjashme si dhe pagimin e shpërbërimit për humbjet e pësuar.

Në bazë të vendimit të arbitrazhit ose të gjykatës, regjistrimi i markës tregëtare mund të fshihet dhe dëshmia e lëshuar të lihet pa fuqi.

E drejta e padisë, sipas këtij neni, parashkruhet me kalimin e kohës, që është caktuar për përdorimin e markës dhe që tregohet në dëshminë përkatëse.

Neni 18

Kur marka tregëtare kalon në përdorim të një tjetri, ose ndërrohet emri, ose qendra e ndërmarrjes në emrin e së cilës është regjistruar marka, i interesuari duhet të njoftojë Byrosë e regjistrimit të markave brenda tre muajve nga data e kalimit të markës ose të ndërrimit të

Neni 4

Për t'u dalluar prodhimet e së njëjtës natyre ose të ngjashme që prodhohen nga ndërmarrjet, prodhuesi ka të drejtë t'u vejë artikujve edhe shenjë dalluese të mallit (marka tregëtare) të përhershme dhe të formuluar në mënyrë origjinale si figurë grafike, stemë, emër origjinal, etj. të kësaj natyre.

Me autorizimin e ministrisë ose të institucionit qendror nga varet ndërmarrja ose mbi të cilën ushtrohet kontrolli, mund të përjashtohet ndërmarrja nga detyrimi i markëtimi, sipas neni 1 dhe të verë në artikujt e saj vetëm markën tregëtare, e cila duhet të përmbajë në mënyrë origjinale emrin e plotë të ndërmarrjes, ose gërmatë iniciale të emrit të saj si dhe llojin e mallit dhe numrin e standardit shtetëror.

Ministria e Tregëtisë së Jashtme, në bashkëpunim me ministrinë ose institucionin qendror përkatës, caktojnë llojet e mallrave të konsumit të brendshëm, për të cilat është e detyrueshme marka tregëtare.

Neni 5

Të gjitha mbishkrimet e bëra rreth markës ose brenda saj janë pjesë të pandara të markës.

Neni 6

Nuk njihen si marka tregëtare shenjat që kanë hyrë në përdorim të përgjithshëm dhe tregojnë mallra të një lloji të caktuar.

Neni 7

Ndërmarrjet mund të përdorin vetëm një markë tregëtare për të gjitha prodhimet e tyre ose marka të ndryshme për lloje dhe cilësi të ndryshme prodhimesh të tyre.

Neni 8

Ndërmarrjet tregëtare që shesin artikuj të përgatitur sipas porositë të veçanta kanë të drejtë të vënë mbi këto mallra, krahas me markën e prodhimit, edhe markën e tyre tregëtare.

Neni 9

Ndërmarrjet dhe organizatat tregëtare për të njëjtin mall mund të kenë vetëm një markë, për të gjitha degët e ndërmarrjes.

Vënja e markës tregëtare në mallrat nuk e përjashton ndërmarrjen prodhuese nga detyrimi që të vejë markën e saj të prodhimit.

Neni 10

Markat tregëtare regjistrohen në Byrosë e regjistrimit të markave tregëtare pranë Ministrisë së Tregëtisë së Jashtme.

Regjistrimi bëhet në bazë të kërkesës me shkresë të anës së interesuar të cilës i bashkëngjitet lista e prodhimeve për të cilat kërkohej marka dhe në tri kopje përshkrimi i plotë i markës dhe figura e saj.

Kërkesa e sipërme mund të drejtohet edhe me anën e postës dhe, në këtë rast, si datë dorëzimi quhet data që mban vula e postës.

Neni 11

Nuk mund të regjistrohen si markë tregëtare ato që:

- a) nuk dallohen, në mënyrë të shquar, nga markat tregëtare të ndërmarrjeve që janë regjistruar më parë;
- b) përmbajnë tregime të rreme ose mashtruese dhe mund të sjellin ngatërime;
- c) përmbajnë stemën e shtetit ose të kryqit të kuq, me përjashtim të rastit kur këto i janë lejuar kërkuarit;
- d) janë në kundërshtim me rendin shoqëror ose me rregullat e bashkëjetesës socialiste.

Neni 12

Byroja e regjistrimit të markave tregëtare shqyrton kërkesën e paraqitur dhe vendos regjistrimin e markës kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ky dekret dhe i lëshon kërkuarit dëshmi për përdorimin ekskluziv të markës. Kur nuk plotësohen kushtet e sipërme refuzon regjistrimin, duke treguar edhe shkaqet.

Neni 13

Kur për regjistrimin e së njëjtës markë ose të një marke të ngjashme janë dhënë dy ose më shumë kërkesa, vendoset pranimi i kërkesës së atij që ka përdorur i pari dhe vazhdimisht markën. Kur asnjë nga kërkuarit nuk e ka përdorur markën gjer në paraqitjen e kërkesës, dëshmia i lëshohet atij që ka dhënë i pari kërkesën.

Studim

Tiranë, 13 Shkurt 1992

MBI GJENDJEN E SISTEMIT TË PRONËSISË INDUSTRIALE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE DISA PROBLEME TË ZHVILLIMIT TË TIJ NË TË ARDHMEN

Nga Dr. Fatos Dega (Drejtor i Departamentit të Kërkimeve në Shkencat Natyrore dhe Inxhinierike në Komitetin e Shkencave dhe Teknologjisë).

1. Hyrje

Synojmë të ngremë sistemin tonë të pronësisë industriale për një zhvillim të shpejtë teknologjik dhe ekonomik në rrugën drejt ekonomisë së tregut. Në këtë kuadër, do të na duhet të kapërcejmë një varg vështirësish që kanë të bëjnë me:

1. Krijimin e një legjislacioni të ri;
2. Ngritjen e institucioneve të përshtatshme;
3. Përgatitjen e burimeve njerëzore që do të vënë në levizje sistemin tonë të pronësisë industriale.

Ngritja e këtij sistemi ka për qëllim ngritjen e përgjithshme të kulturës teknike e shkencore në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet shfrytëzimit të informacionit teknologjik, që përmbahet në dokumentet e patentave, disajneve industriale, etj., në mënyrë që të nxitet:

- marrja (importimi) e teknologjive të reja e të patentuara;
- inkurajimi i shpikjeve në vend dhe shfrytëzimi i tyre.

2. Problemet e antarësimit në organizmat ndërkombëtare

Për të realizuar synimin e mësipërm, në kushtet e mungesës së plotë të eksperiencës dhe të burimeve financiare, vendosja e lidhjeve me organizmat ndërkombëtare të specializuara dhe asistencë e tyre është e një rëndësie të jashtëzakonshme. Ne kemi nevojë për një ndihmë sistematike nga WIPO, gjë që presupozon së pari zgjidhjen e çështjes së pjesëmarrjes së Republikës së Shqipërisë në të, si dhe në traktatet (unionet) e administruara prej saj. Në këtë kuadër, ka vend të sqarohen çështje të tilla si:

- Radha e antarësimit në WIPO, dhe në traktatet (unionet) e administruara prej saj, nën dritën e përfitimeve që vijnë nga pjesëmarrja dhe disavantazhet nga mospjesëmarrja;
- Kontributet që duhet të paguhet për pjesëmarrje në secilin union;
- Procedurat e aderimit.

Si dhe kur mund të realizohet sa më shpejt futja e Shqipërisë në WIPO, dhe në unionet e tjera shfaqet aktualisht si një problem mjaft i rëndësishëm. Duket se, pas aderimit në WIPO, më me interes do të ishin aderimi në Unionin e Parisit dhe ai në PCT.

Në mënyrë që lidhjet me organizmat ndërkombëtare të specializuara të jenë efektive, duhet që ato të njihen mirë. Në këtë kuadër, paraqet interes njohja e problemeve të tilla si:

- *Struktura e WIPO, dhe e Byrosë Ndërkombëtare;*
- *Mënyra e përfaqësimit të çdo vendi në organet kryesore, si Asambleja e Përgjithshme, Komiteti Permanent i WIPO, për Zhvillimin e Kooperimit lidhur me pronësinë industriale, etj. dhe mënyra e funksionimit të këtyre organizmave;*
- *Çfarë përfaqësojnë përfaqësuesit e vendeve në këto organe? (zyrtarë qeveritarë apo specialistë institucionesh të pronësisë industriale) Kush i emëron ? Me çfarë afati? etj.*

3. Legjislacioni

Duhet theksuar se deri më sot në Republikën e Shqipërisë nuk është dhënë asnjë patentë shqiptare, si dokument fizik i lëshuar konform standardeve (ligjeve) mbi të cilat veprohet në vendet e tjera apo nga organizmat e specializuara ndërkombëtare në këtë fushë. Arsyeja është e thjeshtë: në Shqipëri nuk ka pasur dhe nuk ka Ligj mbi patentat për shpikje. Shumë shumë, në legjislacionin tonë është trajtuar në mënyrë të pjesëshme, të sipërfaqeshme dhe me luhatje vetëm çështja e regjistrimit të patentave të huaja.

Ligji Nr. 3029, datë 12.01.1960, i jepte të drejtë autorit të shfrytëzonte shpikjen e tij në mënyrë ekskluzive. Me Dekretin Nr. 4548, datë. 3.10.1960, Ligji i mësipërm u shfuqizua. Sipas këtij Dekreti, autorit i njihej vetëm dëshmia e shpikjes por jo e drejta ekskluzive e përdorimit të saj, e cila tashmë i kalonte shtetit. Kjo bëri që në Republikën e Shqipërisë të ndërpritej regjistrimi i patentave të huaja.

Me Dekretin Nr. 7316, datë 20.7.1989, (pas njëzet vjetësh!) Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë ju shtua Neni 333A, i cili parashikon mundësinë e regjistrimit e të mbrojtjes së patentave të nënshtetasve të huaj në Shqipëri. Sot rregullimi i veprimtarisë në këtë fushë (vetëm përsa i takon regjistrimit të patentave të huaja) bëhet në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 393, datë 17.11.1990 "Për mënyrën e regjistrimit të patentave për shpikjet e realizuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë", që përfaqëson në vetvete një akt nënligjor.

Sa më sipër, mund të thuhet, se në Shqipëri mungon, në kuptimin e vërtetë të fjalës, një legjislacion mbi patentat apo më gjerë mbi pronësinë industriale, gjë që përbën një çështje themelore të zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të pronësisë industriale në këtë vend.

Në lidhje me këtë, është mirë të sqarohet se çfarë ndihme (mundësisht e programuar) mund t'i jepej Republikës së Shqipërisë në këtë fushë tani dhe në të ardhmen e afërt. Aktualisht, duhet t'i japim rëndësi çështjes së:

- *Një model-ligji (draft) të parapërgatitur nga WIPO, (një model-ligj i tillë i është dhënë p.sh. Libisë në vitin 1990);*
- *Ekzaminimit nga ekspertë të saj të pajtueshmërisë së model-ligjit të mësipërm me ligjet në fuqi ose ato që parashikohen të krijohen s'afërmi në vendin tonë;*
- *Përgatitjes së juristëve shqiptare në këtë fushë.*

4. Institucionet

Në vendin tonë nuk ka institucione të specializuara në fushën e pronësisë industriale. Ngritja e tyre në të ardhmen kërkon në rradhë të parë krijimin e ideve të qarta në lidhje me strukturën, mënyrën e administrimit të tyre, etj.

Në këtë kuadër, paraqesin interes çështje të tilla si:

- *Struktura tipike e sistemit të institucioneve të pronësisë industriale në një vend të zhvilluar dhe në një vend në zhvillim (ç'institucione veprojnë në këtë fushë?);*
 - *Lidhja e institucioneve të këtij sistemi me qeverinë (për çfarë dhe si) si dhe me komunitetin industrial e shkencor;*
 - *Struktura tipike e shërbimeve, ajo e organizimit dhe e drejtimit të institucioneve kryesore të sistemit të pronësisë industriale (p.sh. e Zyrës së Patentave) në një vend të zhvilluar dhe në një vend në zhvillim;*
 - *Shtrirja territoriale;*
 - *Përbërja e kuadrove (nga ç'komunitete vijnë, profesioni, etj.);*
 - *Sistemet dhe metodat që përdoren në ruajtjen dhe dhënien e informacionit; kërkimin, klasifikimin dhe ekzaminimin e patentave për shpikje, markave tregtare, disajnovë industriale, prirjet e zhvillimit të këtyre sistemeve teknike, etj.;*
 - *Burimet e financimit të sistemit të pronësisë industriale në një vend të zhvilluar e në një vend në zhvillim; gjendja dhe prirjet;*
 - *Lidhja e sistemit të informacionit të pronësisë industriale me sistemet e tjera të informacionit;*
- *Cila do të ishte struktura më e përshtatshme (në një vlerësim të parë!) e sistemit të institucioneve që rekomandohet të ketë Republika e Shqipërisë në fushën e pronësisë industriale aktualisht dhe sa mund të kushtonte realizimi i një projekti në këtë fushë, nisur nga eksperiencia e vendeve të tjera në zhvillim?*
- *Veç burimeve të PNUD-it e të vendit, në cilat burime të tjera (përfshi WIPO-n) mund të drejtoheshim për mbështetje për realizimin e një projekti të tillë?*

- A mund të shpresonim për të marrë falas nga WIPO pajisje të ndryshme, përfshirë një stacion CD-ROM (që përbëhet nga një mikrokompjuter, një lexues CD-ROM, një ekran grafik me rezolucion të lartë dhe një lazer-printer) në kuadrin e një projekti, vendi për ngritjen e Zyrës Shqiptare të Patentave? (Mesa jemi në dijeni, WIPO ka filluar ta bëjë këtë për vendet në zhvillim, por nuk dimë se në ç'kushte), etj.

5. Burimet njerëzore

Në vendin tonë nuk ka asnjë njeri të pregatitur për të punuar në sistemin e pronësisë industriale. Zgjidhja e këtij problemi merr tani një karakter urgjent. Duhet të formojmë një ekip të plotë njerëzish që do të punojnë në sferën e pronësisë industriale:

- Në organizmat qeveritare (në cilët?);
- Në institucionet e pronësisë industriale,
- Duke u ndihmuar nga komuniteti ndërkombëtar, e në rradhë të parë WIPO, nëpërmjet:
 - Dhënies së bursave;
 - Mbikqyrjes dhe ndihmës në punë e sipër të punonjësve vendas nga ekspertë ndërkombëtarë;
 - Leksioneve, seminareve ose aktiviteteve të tjera që mund të organizohen në Shqipëri, etj.

I rëndësishëm është problemi i kriterëve që duhet të aplikohen për zgjedhjen e njerëzve që do të punojnë në sferën e pronësisë industriale dhe i procedurës së pranimi të tyre.

Aktualisht paraqet interes njohja e tablosë së aktiviteteve që organizon WIPO, gjatë viteve 1992-1993 si:

- Kurse;
- Vizita studimore;
- Kurse speciale (Workshops);
- Seminare,

ku mund të ishte me interes pjesëmarrja e Republikës së Shqipërisë ose që mendohet se mund të organizoheshin posaçërisht për ne (në kuadrin e një programi, për të cilin hidhet ideja më poshtë).

Në cilat aktivitete të niveleve:

- Nacionale;
- Sub-rajonale;
- Rajonale;

- Globale,
rekomandohet nga WIPO, të marrë pjesë Shqipëria gjatë vitit 1992 e më tej?

6. Publikimet

Duke qenë se tek ne nuk ekziston një sistem i pronësisë industriale as që mund të bëhet fjalë për publikime të tij. Për të ndihmuar në ngritjen e shpejtë dhe në funksionimin sipas standardeve botërore të sistemit tonë të pronësisë industriale, i rëndësishëm është informacioni nga jashtë. Duhet të konsiderohen si tepër të rëndësishme në rradhë të parë publikimet e WIPO-s, si tekstet e konventave, traktateve dhe marrëveshjeve në fushën e pronësisë industriale. Tani për tani me interes të veçantë janë për ne:

- Konventa e Themelimit të WIPO;
- Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale;
- Klasifikatorët ndërkombëtare të patentave, markave dhe disajnovave industriale;
- Model ligjet dhe model-dispozitat. Në këtë kuadër me interes të veçantë paraqitet aktualisht "WIPO Model Law for Developing Countries on Inventions";
- Studime, fjalorë etj.

7. Mbi nevojën e një programi të posaçëm ndihme për Republikën e Shqipërisë

Kalimi drejt ekonomisë së tregut e gjen Shqipërinë të papërgatitur në fushën e Pronësisë industriale nga pikëpamja legale, institucionale e njerëzore. Zgjidhja e këtij rasti (ndoshta unikal) në një kohë relativisht të shkurtër shtrën nevojën e një ndihmë speciale që duhet t'i jepet Shqipërisë në këtë fushë nga Komuniteti Ndërkombëtar, veçanërisht nga WIPO, krahas masave që duhet të ndërmerret qeveria Shqiptare, siç mund të jetë ndërmarrja e një projekti vendi me fondet e PNUD-it, që, siç dihet, janë të pakta dhe nuk mjaftojnë për zgjidhjen e problemeve të shumta që përballon ky vend sot.

Në këtë kuadër do të ishte me shumë interes hartimi i një programi të posaçëm ndihme për Shqipërinë (ose në pamundësi, përfshirja në programe të tilla globale ose rajonale në qoftë se ka) për zgjidhjen e problemeve të lidhura me:

- Krijimin e legjislacionit;
- Ngritjen e institucioneve;
- Zhvillimin e burimeve njerëzore në fushën e pronësisë industriale.

Si hap i parë mund të ishte dërgimi sa më shpejt i një misioni ekspertësh ndërkombëtarë në Shqipëri, që do të përgatiste një raport mbi gjendjen dhe mundësitë e ngritjes së sistemit të pronësisë industriale në Republikën e Shqipërisë, bashkë me paketën e masave që propozohen për një zgjidhje të shpejtë të problemeve themelore në të ardhmen e afërt.

PJESA II

PUNA E KRYER GJATË VITIT 2017 NGA DPPI

VENDIMET E KËSHILLIT MBIKËQYRËS TË DPPI PËR VITIN 2017

Këshilli Mbikëqyrës është organ drejtues i DPPI. Ky është një organ kolegjal, i përbërë nga pesë anëtarë, kryetari dhe katër anëtarë, nga të cilët:

- a) një jurist;
 - b) një financier;
 - c) një anëtar i kabinetit të Kryeministrit;
 - ç) një anëtar i kabinetit të ministrit përgjegjës për ekonominë;
 - d) një anëtar nga struktura që mbulon investimet e huaja.
- Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës emërohen nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës janë:

- Mbikëqyrja e veprimtarisë së DPPI-së dhe ushtrimi i çdo kompetencë tjetër sipas ligjit
- Miratimi i programeve të zhvillimit të DPPI-së
- Miratimi i rregullores së brendshme të organizimit dhe të funksionimit të DPPI-së
- Miratimi i strukturës dhe organikës së DPPI-së me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm pas marrjes së dakordësisë nga ministri përgjegjës për administratën publike dhe ministrit përgjegjës për financat
- Miratimi i programit financiar të DPPI-së si dhe projektbuxhetin, i cili më pas miratohet nga Këshilli i Ministrave
- Miratimi i projektit për nivelin e pagave të punonjësve të DPPI-së, i cili më pas miratohet nga Këshilli i Ministrave
- Miratimi çdo vit i kriterëve dhe masave për shpërblimet stimuluese të personelit për efektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm
- Miratimi i kushteve, afateve dhe procedurave për ofrimin e shërbimeve me mjete elektronike nga DPPI-ja, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm.

Në mbështetje të Nenit 189/b, të Ligjit Nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, me urdhërin Nr. 2272/4, datë 24.04.2017, të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, “Për ngritjen e Këshillit Mbikëqyrës të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, është ngritur Këshilli Mbikëqyrës i DPPI-së, me një mandat tre vjeçar.

Këshilli Mbikëqyrës i DPPI-së përbëhet nga:

1. Z.Gentian Kërri, Jurist - Kryetar;

2. Znj.Irena Beqiraj, Këshilltar i Kryeministrit për Ekonominë - Anëtar;
3. Znj.Majlinda Dhuka, Drejtor i Departamentit të Zhvillimit dhe Ndihmës së Huaj në Kryeministri - Anëtar;
4. Znj.Ekflodia Leskaj, Këshilltar i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes - Anëtar;
5. Znj.Vilma Çausholli, Financier - Anëtar.

Këshilli Mbikëqyrës i DPPI-së, për vitin 2017 ka marrë vendimet si më poshtë:

- Vendimi nr. 1, datë 16.05.2017 u zgjodh kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të DPPI-së, Z.Gentian Kërri;
- Vendimi nr. 2, datë 16.05.2017, “Projekt Rregullorja e Brendshme për Funksionimin dhe Organizimin e Këshillit Mbikqyrës;
- Vendimi nr. 3, datë 16.05.2017, “Plani i zhvillimit i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale 2017-2020, programi financiar i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe projektbuxheti për vitin 2017”;
- Vendimin nr. 4, datë 16.05.2017, “Projekt vendimi i nivelit të pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”.
- Vendimi nr. 6, datë 07.12.2017, “Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale;
- Vendimi nr. 7, datë 07.12.2017 vendosi emërimin e anëtarëve të Bordit të Apelimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale;
- Vendimi nr. 8, datë 07.12.2017, “Disa ndryshimeve në programin financiar të vitit 2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale”;
- Vendimi nr. 5, datë 07.12.2017, “Programi financiar i Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Projektbuxheti 01 Janar - 31 Dhjetor 2018”;
- Vendimi nr. 9, datë 07.12.2017 “Projekt vendimi për kriteret dhe masat për shpërblimet stimuluese të personelit për efektivitetin e shërbimit të kryer në DPPI”.

REGJISTRIMI I OBJEKTEVE TË PRONËSISË INDUSTRIALE

Gjatë vitit 2017, në DPPI është bërë një punë cilësore sa i përket ekzaminimit të aplikimeve për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale, kjo punë ka qenë shumë voluminoze, si pasojë e rritjes së numrit të aplikimeve për patentat për shpikje dhe mbajtjen e tyre në fuqi, po ashtu numri aplikimeve për marka ka qënë më i larti ndër vite. Për të gjitha këto, është kryer në kohë dhe brenda afateve ligjore, shqyrtimi i dokumenteve, njoftimeve, publikimeve, skanimeve, skadimeve, dërgesat me postë dhe në formë elektronike të tyre, duke bërë të mundur që i gjithë procesi të kryhet me eficence dhe në kohë të shpejtë.

Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri “Për Pronësinë Industriale” është bërë shumë punë për implementimin dhe vazhdon puna me ndryshimet në rregulloret në zbatim të tij për përshtatjen me ligjin e ri. Ndryshimet që solli ky ligj na vënë përballë sfidave të ardhshme për konkretizimin e reformës së nisur nga DPPI në vitin 2015 dhe ka për qëllim zbatimin e rekomandimeve të Komisionit Evropian në lidhje me përmirësimin e sistemit të PI në Shqipëri si edhe rregullimi problematikave të hasura në praktikë. Konkretisht do të zbatohen kompetencat ex-officio të Zyrës për çregjistrim të objekteve të regjistruara në DPPI. Do të bëhet përcaktimi ligjor i rregullave për mbrojtjen e markave të mirënjohura. Do të krijohet mundësia për aplikimin on-line gjë që do të lehtësojë këtë proces për aplikantët duke qenë më praktikë dhe me tarifa aplikimi të reduktuara. Do të bëhet ndryshimi i udhërrefyesit të markave në përputhje me ligjin e ri.

Në DPPI është përmirësuar cilësia e ekzaminimit dhe është shkurtuar afati i dhënies së dëshmisë së depozitimit. Tani aplikanti menjëherë me dorëzimin e dokumentacionit, pajiset me një datë depozitimi të shoqëruar me një dokument zyrtar që është “Dëshmia e Depozitimit”. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit do të vazhdojë me strukturimin e ri të DPPI dhe formimin e Zyrës së Pritjes dhe Informimit, e cila do të thjeshtojë procedurat për aplikantët dhe do të shpejtojë dhënien e informacionit dhe procesim më të shpejtë dhe të saktë të dokumenteve hyrëse dhe dalëse në DPPI.

TË DHËNA STATISTIKORE 2016 - 2017

	2016	2017
PATENTA PËR SHPIKJE DHE MODELE PËRDORIMI		
Kërkesa për regjistrimin e patentave kombëtare	23	24
Kërkesa për regjistrimin e modeleve të përdorimit (kombëtare)	4	1
Kërkesa për shtrirje /vlefshmëri të patentave nga EPO	720	789
Kërkesa për regjistrimin e patentave nga PCT	2	0
Kërkesa për regjistrim ndërkombëtar të patentave Shqiptare	0	1
Totali kërkesave për regjistrimin e patentave	745	813
Kërkesa për regjistrimin e certifikatës së mbrojtjes shitesë (SPC)	9	5
Kërkesa për ripërtëritjen e patentës	2772	3110
Kërkesa për ndryshime në regjistrin e patentave	104	113
Kërkesa për rivendosje në afat të patentës	4	7
Numri i patentave të regjistruara	679	770
MARKA TREGTARE		
Kërkesa për regjistrimin e markës në fazë kombëtare	1055	1161
Kërkesa për regjistrimin e markave nga sistemi i Madridit	2758	2622
Totali kërkesave për regjistrimin e markave tregtare	3813	3783
Aplikim për regjistrimin ndërkombëtar të markave Shqiptare	6	11
Kërkesa për ripërtëritjen markave	625	515
Kërkesa për ndryshime në regjistrin e markave	465	314
Numri i markave në fazë kombëtare të regjistruara	1053	803
Numri i markave të regjistruara nga sistemi i Madridit	2403	2731
DISENJO INDUSTRIALE		
Kërkesa për regjistrimin e disenjove industriale	9	12
Totali kërkesave për regjistrimin e disenjove industriale	10	13
Kërkesa për ripërtëritjen disenjove industriale	6	8
TREGUES GJEOGRAFIKË		
Kërkesa për regjistrimin e treguesit gjeografik dhe emërtimeve të origjinës	2	6

PATENTAT PËR SHPIKJE DHE MODELET E PËRDORIMIT

Patentimi i shpikjeve është një nga shumë aspektet e inovacionit, por është dhe treguesi kryesor i matjes së përparimit të tij.

Mbrojtja efektive e patentave për shpikje gjithashtu inkurajon investimet e mëtejshme në kërkim dhe zhvillim, si dhe ndikon në rritjen e kapitalit. Ajo i jep shtysë inovacionit teknik i cili është thelbësor për konkurrencën dhe rritjen në vazhdimësi të cilësisë së jetës së njeriut.

Të gjithë pronarët e patentave për shpikje duhet të bëjnë publike informacionin mbi shpikjet e tyre, në mënyrë që të pasurojnë literaturën e njohurive teknike në botë. Ky informacion, që është gjithnjë në rritje, shpërndan njohuritë njerëzore dhe nxit krijmtarinë e mëtejshme dhe idetë inovatore tek të tjerët. Në këtë mënyrë sistemi i mbrojtjes me patentë garanton edhe vijimësi të zhvillimit teknologjik dhe kthehet në frymëzim për brezat e ardhshëm të studiuesve dhe shpikësve.

DPPI i ka dhënë prioritet kryesor nxitjes së shpikësve shqiptarë për të patentuar shpikjet e tyre. Të gjithë shpikësve që janë paraqitur në DPPI, u është dhënë asistencë teknike për përmirësimin e cilësisë së të dhënave në dokumentet e depozituara për patentë kombëtare. Gjithashtu konsulencë u është dhënë dhe studentëve të cilët kanë patur dëshirë dhe kurajo të zhvillojnë inovacionin dhe teknika të reja që lidhen me fushën e shpikjeve.

Specialistët e patentave për shpikje kanë marrë pjesë dhe kanë referuar në aktivitetet me tematikë mbi mbrojtjen e patentave të organizuara nga DPPI.

Ofrimi i asistencës për të gjithë shpikësit në plotësimin e dokumentacionit të patentave: përshkrim, abstrakt, vizatime dhe pretendime sipas rregullores në fuqi, si dhe nismës së marrë për uljen e tarifave për pensionistët, studentët dhe personat me aftësi të kufizuara. **Gjatë këtij viti ka pasur 4 aplikime nga studentë për patentë kombëtare dhe 3 aplikime nga pensionistë.**


Të dhëna statistikore mbi patentat për shpikje për vitin 2017


Sektori i patentave gjatë vitit 2017 ka pranuar **813** aplikime për patenta krahasuar me **745** aplikime të depozituara në vitin 2016, pra kemi një rritje prej **9.13 %** të numrit të aplikimeve për patenta. Nga këto aplikime, **24** aplikime janë aplikime kombëtare me aplikantë nënshtetas Shqiptarë, dhe **789** aplikime për patenta, janë patenta të lëshuara nga Zyra Evropiane e Patentave të cilat kërkojnë mbrojtje në Shqipëri.

APLIKIME	Viti 2016	Viti 2017	% e rritjes
Aplikime për patentë kombëtare	23	24	4.35%
Patenta nga Zyra Evropiane e Patentave	720	789	9.58 %
Aplikime nga Traktati i Bashkëpunimit për Patentat (TBP)	2	0	-%
TOTALI	745	813	9.13 %


Gjithashtu gjatë këtij viti ka pasur një (1) aplikim për Model Përdorimi nga një subjekt shqiptar.

APLIKIME	Viti 2016	Viti 2017
Aplikime për Model Përdorimi	4	1






Grafiku më poshtë tregon rritjen e numrit të aplikimeve për **Patenta Kombëtare** në vite. Nga vitit 2013 deri në vitin 2017 *numri i aplikimeve për patentë kombëtare është gjashtëfishuar*.



Grafiku më poshtë tregon rritjen e numrit të **Patentave Evropiane** të cilat kërkojnë mbrojtje në vendin tonë. *Numri i patentave Evropiane të cilat kërkojnë mbrojtje në vendin tonë është dyfishuar në krahasim me vitin 2013.*



Akte administrative të lëshuara për patentat për shpikje

Gjatë vitit 2017, DPPI ka lëshuar **4244** akte administrative për patentat brenda afateve të parashikuara në ligj dhe në rregulloren e patentave. Gjatë vitit 2017 janë depozituar **813** aplikime për patenta, nga të cilat **789** janë Patenta Evropiane, **24** Patenta Kombëtare, dhe **1** Model Përdorimi. Janë ripërtëritur **2697** patenta dhe janë bërë ndryshime në regjistër për **130** patenta.

Tabela më poshtë tregon kërkesat si dhe aktet e lëshuara nga DPPI në vitin 2017

PATENTA PËR SHPIKJE DHE MODELE PËRDORIMI	2016	2017
Patenta kombëtare	23	24
Modele përdorimi	4	1
Patenta Evropiane nga ZEP	716	789
Patenta ndërkombëtare sipas Traktatit Bashkëpunimit për Patentat	2	0
Regjistrim ndërkombëtar të patentave Shqiptare	0	1
Totali kërkesave për regjistrimin e patentave	745	814
Kërkesa për regjistrimin e certifikatës së mbrojtjes shtesë	9	5
Kërkesa për ripërtëritjen patentës	2772	3110
Kërkesa për ndryshime në regjistrin e patentave	104	113
Kërkesa për rivendosje në afat të patentës	4	7
Numri i patentave të regjistruara	679	770
Dokumenta në total të depozituara për çështje në lidhje me patentat	3606	4064
Dokumenta në total të lëshuara nga Sektori i Patentave	4269	4246

Veprime për patenta për shpikje	Viti 2016	Viti 2017
Veprime në sistem	1701	1902
Ripërtëritje të patentave	2579	2697
Refuzime ripërtëritje patente	49	74
Njoftime në aplikime	332	353
Ndryshime në patentë	132	130
Shtrirje patente ZEP	180	129
Vlefshmëri patente ZEP	484	629
Skadime patentash	453	166
Refuzime patente	10	23
Hetime patente	17	30
Korrigjime në veprime	4	33
OD Printing	3466	3696
SOD printing	798	548

Tabela më poshtë tregon akte të tjera të lëshuara për patentat gjatë vitit 2017

1	Patenta të skaduara	166
2	Patenta të refuzuara	23
3	Njoftime gjatë procesit të ekzaminimit	353
4	Korrigjime të gabimeve	33
5	Hetime për patentat	30

Detyra të tjera të realizuara për patentat gjatë vitit 2017

- Janë skanuar patentat në proces. Ka vazhduar skanimi i patentave si dhe gjithë aplikimeve që kanë të bëjnë me ndryshimet në regjistrin e patentave.
- Janë hartuar materiale të ndryshme, memo dhe shkresa të tjera lidhur me patentat.
- Janë nxjerrë njoftime për patenta të cilat kanë disa vjet që nuk ripërtërihen.

MARKAT TREGTARE

Në botën e biznesit që ndryshon dhe konkurrencën gjithnjë në rritje, duhen të ndërmerren hapa për të mbrojtur logot e produkteve dhe të shërbimeve që përfaqësojnë një biznes, në mënyrë që të shmangen situata abuzuese, ku personat e pa autorizuar përdorin reputacionin, apo emrin e mirë të një subjekti tregtar. Mbrojtja e markave është një investim i domosdoshëm.

Marka e mbrojtur kthehet në aset për kompaninë dhe burime të ardhurash vetëm pas regjistrimit pranë DPPI. Regjistrimi i një marke bën që konsumatorët të zgjedhin midis produkteve në treg. Vetëm pronari i një marke të regjistruar mund të kërkojë pranë organeve kompetente mbrojtjen e të drejtave mbi markën në rast cënimi nga palë të treta. Marka që ka marrë datë depozitimi në DPPI mund të kërkojë shtrirje të mbrojtjes edhe në tregjet ndërkombëtare. Markat e regjistruara mund të licencohen ose të jenë bazë për një marrëveshje franchising. Prezantimi në treg me një markë të regjistruar është bazë për të krijuar një emër dhe reputacion të mirë për kompaninë.

Viti 2017 u mbyll me një rritje të dukshme të aplikimeve për regjistrim të markave duke arritur një rekord të ri prej **1161** markash kombëtare në DPPI. Vetë këto shifra janë tregues i punës sonë dhe rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të biznesit vendas për përfitimet nga mbrojtja e markave tregtare, si dhe të interesit të kompanive të huaja për tregun shqiptar. Pritet që trendi i aplikimeve për marka, të jetë gjithnjë në rritje.

Në vitin 2017, ndryshimet e fundit të ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar, sollën përmirësime si në drejtim të procesit të ekzaminimit të markave ashtu dhe me krijimin e disa kompetencave të DPPI, që u rregulluan në përputhje me praktikën më të mirë të zyrtare homologe në rajon dhe BE. DPPI përveç funksionit të ekzaminimit dhe regjistrimit do të parandalojë mbivendosjen e markave në regjistër. Kjo do të realizohet duke përdorur disa mekanizma që do të ofrojnë mbajtësve të të drejtave informacion në kohë reale për aplikimet për marka të njëjta ose të ngjashme, duke bllokuar kështu kopjimet apo imitimet e mundshme.

Ne po punojmë të sigurojmë një punë me cilësi të lartë, optimizojmë shërbimet tona dhe shkurtojmë procedurat duke kryer ekzaminimin brenda muajit të parë të aplikimit.

Numri total i aplikimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për marka gjatë vitit 2017 ka arritur në **3893** aplikime. Sipas këtij informacioni kuptohet rëndësia që i jepet mbrojtjes së markave, duke theksuar që këtë vit, përveç aplikimeve kombëtare ka patur rritje dhe numri i aplikimeve ndërkombëtare për marka në Shqipëri, në krahasim me vitet e fundit.

Më poshtë tregojmë situatën për mbrojtjen e markave në Shqipëri nëpërmjet aplikimeve në DPPI.


Aplikime kombëtare për marka

Në këtë kategori përfshihen aplikime që kryhen direkt në DPPI nga subjekte shqiptare dhe subjekte të huaja.

Gjatë vitit 2017, janë paraqitur **1161** aplikime kombëtare në total, në krahasim me **1055** aplikime kombëtare të paraqitura në vitin 2016, duke u rritur numri i tyre me **10%**.

Vlen të theksohet fakti që numri i aplikimeve për regjistrimin e markave në DPPI nga subjektet shqiptare dhe të huaja në vitet e fundit po rritet në mënyrë të ndjeshme. Ky fenomen është tregues i rritjes së ndëgjësimit për mbrojtjen e markave, aktivitetit tregtar që synon të rregullohet bazuar në konkurrencën e ndershme dhe garancia ligjore e territorit të Republikës së Shqipërisë, duke e bërë atë atraktiv për subjektet dhe investimet e huaja.

Grafiku më poshtë tregon numrin e aplikimeve kombëtare për regjistrim marke për vitet 2010-2017.




Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Aplikime kombëtare për marka	610	720	686	775	905	937	1055	1161

Aplikime kombëtare nga subjekte shqiptare për regjistrim marke

Gjatë vitit 2017 rritje ka patur numri i aplikimeve kombëtare (shqiptare), të cilat arritën në **684** duke u rritur me **3.3%**, krahasuar me vitin paraardhës. Rritja e numrit të aplikimeve shqiptare ka ardhur si rezultat i fushatës ndërgjegjësuere të ndërmarrë nga DPPI. Në vitin 2017 numri i aplikimeve shqiptare është rritur me trefishin e tyre në krahasim me vitin 2010.

Grafiku më poshtë tregon numrin e aplikimeve kombëtare nga subjekte shqiptare për regjistrim marke për vitet 2010-2017.




Aplikime ndërkombëtare për marka nga sistemi i Madridit


Në këtë kategori përfshihen aplikimet që vijnë nga subjektet e huaja që kërkojnë të regjistrojnë markat e tyre në DPPI për të siguruar mbrojtje edhe në territorin e Republikës së Shqipërisë. Këto aplikime kryhen nëpërmjet Marrëveshjes së Madridit e datës 14 prill 1891 “Për regjistrimin ndërkombëtar të markave” - hyrë në fuqi në Shqipëri më 4 Tetor 1995 dhe “Protokollin e marrëveshjes së Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave” – marrëveshja ka hyrë në fuqi në Shqipëri më 30 Korrik 2003. Në mbështetje të këtyre marrëveshjeve edhe subjektet shqiptare mundën të mbrojnë markat e tyre me një aplikim të vetëm në disa vende të huaja.

Gjatë vitit 2017 nga sistemi i Madridit janë depozituar **2732** aplikime në vitin 2017 duke u rritur me **13.8%** krahasuar me vitin 2016.


Grafiku më poshtë tregon numrin e aplikimeve për regjistrim markash nga sistemi i Madridit për vitet 2010-2017.



Grafiku i mëposhtëm tregon numrin e aplikimeve në total në % për vitin 2017, ku aplikimet ndërkombëtare zënë 70%, aplikimet kombëtare nga aplikantë të huaj 12% dhe aplikimet vendase zënë 18%. Vërejmë se numri i aplikimeve nga subjekte shqiptare është rritur në vitin 2017 dhe në totalin e numrit të aplikimeve ato zënë 18% në krahasim me 11% që ishin në vitin 2016.



Gjatë vitit 2017 është rritur numri i kërkesave shqiptare që kanë kërkuar shtrirje ndërkombëtare nëpërmjet Marrëveshjes së Madridit me **8.3%**. Kjo tregon që po shtohet numri i subjekteve shqiptare që eksportojnë produktet e tyre në tregjet e huaja.



Ripërtëritjet e Markave

Mbrojtja për një markë jepet për një periudhë 10-vjeçare nga data e depozitimit të saj. Pas përfundimit të kësaj periudhe marka që të jetë e mbrojtur duhet të ripërtërihet çdo 10-vjet.

Tabela më poshtë tregon numrin e aplikimeve për ripërtëritjen e regjistrimit të markave të ndara sipas llojit, për vitet 2016 – 2017.


APLIKIME PËR RIPËRTËRITJE	Viti 2016	Viti 2017
Aplikime për ripërtëritje markash kombëtare	626	515
Aplikime për ripërtëritje markash ndërkombëtare	2217	2366
TOTALI	2843	2881

Aplikimet për marka sipas klasave të mallrave dhe shërbimeve

Markat mbrohen për të gjitha llojet e mallrave dhe shërbimeve që hidhen në treg dhe janë të lira në qarkullimin civil. Këto mallra dhe shërbime janë klasifikuar në 45 klasa në bazë të Konventës së Nicës për Klasifikimin Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve.

Për vitin 2017, numrin më të madh të aplikimeve kombëtare të ndara sipas klasave të klasifikimit të Nicës e zënë shërbimet e shitjes, reklamës, administrim biznesit të përfshira në klasën 35, e ndjekur nga produktet ushqimore klasa 30, shërbimet për trajtim materiale, diferencim mbetjesh të përfshira në klasën 40, preparatet e pastrimit të përfshira në klasën 3 dhe produktet farmaceutike të përfshira në klasën 5, etj.

Grafiku më poshtë tregon përqindjen sipas klasave, nga aplikimet për regjistrim të markave të depozituara në vitin 2017.




Në vitin 2017 numrin më të madh e patën aplikimet për marka, të cilat do të përdoreshin për shërbimet e klasës 35, që kanë të bëjnë me reklamimin; menaxhimin e biznesit; administrimin e biznesit; funksionet e zyrës, ndërsa në vitin 2016 numri më i aplikimeve të markave ishte për produktet farmaceutike të përfshira në klasën 5.

Aplikimet për marka në vitin 2017, të cilat përdoren për produktet ushqimore që përfshihen në klasën 30 mbeten në vendin e dytë si në vitin 2016.

Aplikimet kombëtare për marka sipas vendit të origjinës së aplikantëve


Në vitin 2017, nëse vështrojmë numrin e aplikimeve kombëtare për marka nga subjekte të huaja, vëmë re se SHBA e ndjekur nga Kosova, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Zvicra, Gjermania dhe Korea, etj, kanë numrin më të madh të aplikimeve kombëtare në Shqipëri.



Fazat e aplikimeve regjistrim markash për vitin 2017

Ndër aplikimet e depozituara në vitin 2017 nuk ka asnjë dosje të pa ekzaminuar. Nga 1161 aplikime kombëtare në total vetëm 142 prej tyre janë në fazën e aplikimit formal (i është lëshuar dëshmia e depozitimit) gjë që tregon se të gjitha aplikimet janë ekzaminuar brenda muajit të parë. Numrin më të madh e zënë aplikimet për të cilat është lëshuar certifikata e regjistrimit 264 dhe 235 dosjet e aplikimit janë në fazë publikimi, pra u ka mbaruar procesi i ekzaminimit. Ndërsa 59 dosje aplikimesh janë refuzuar.

Grafiku më poshtë tregon se në c'fazë janë dosjet e aplikimeve të vitit 2017



Administrimi i markave.


Spektori që merret me ekzaminimin e markave ka një staf prej 4 specialistësh dhe një përgjegjës sektori. Me ndryshimet e reja ligjore ky sektor do të mbulojë dhe aktivitetin e Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve dhe Dhomës për Shfuqizim dhe Zhvlerësim si dhe numrin në rritje të aplikimeve që duhen ekzaminuar. Si rrjedhojë në projekt strukturën e re të DPPI është parashikuar që stafi i tij të rritet.

DISENJOT INDUSTRIALE

Pamja e jashtme e produktit influencon shumë në shitjen e produkteve. Nëse doni të mbronni pamjen e jashtme, vizuale të një produkti, regjistrimi pranë DPPI i kësaj të drejte të Pronësisë industriale është gjëja e duhur për ju.

Në përgjithësi shifrat për depozitimin e aplikimeve për disenjo janë më të ulta se ato për aplikime markash dhe patentash. Aplikimet për disenjo ekzaminohen gjithashtu nga sektori i ekzaminimit të markave tregtare, disenjove industriale dhe treguesve gjeografikë.

Gjatë vitit 2017 janë depozituar **12** aplikime për regjistrim disenjoje, ndërsa në vitin 2016 janë depozituar **9** aplikime, pra kemi një rritje të numrit të aplikimeve me **3.3%**.




Vlen të theksohet se nga **12** kërkesat e depozituara në 2017, **8** janë kërkesa nga aplikantë shqiptarë dhe **3** nga subjekte të huaja. Nga këto **8** diseno, **3** aplikime janë në fazën e pritjes së njoftimit për formalitete, **1** për pagesë regjistrimi, **1** në publikim, **2** për tu refuzuar për formalitete dhe **1** aplikim i refuzuar. Ndërsa nga **3** aplikimet e huaja: **2** janë regjistruar dhe **1** është për plotësim formalitetesh.

Përsa i përket disnjove industriale nga subjekte të huaja, bazuar në Marrëveshjen e Hagës për regjistrimin ndërkombëtar të disenjove industriale:

Në vitin 2017, nga kjo marrëveshje janë regjistruar **209** diseno industriale me **766** diseno të shumëfishta.

Në vitin 2016, nga kjo marrëveshje janë regjistruar **239** diseno industriale me **942** diseno të shumëfishta si dhe janë ripërtërirë **98** diseno me **408** diseno të shumëfishta.

Ndërsa në lidhje me aplikimet në vitin 2017 kemi patur 209 aplikime disenjosh dhe 814 diseno të shumëfishta të përfshira në to, në krahasim me 276 aplikime disenjosh dhe 1022 diseno të shumëfishta në vitin 2016.



TREGUESIT GJEOGRAFIKË

Viti 2017 ka qenë një nga vitet më të suksesshme për sa i përket regjistrimit të treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës në DPPI.

Treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, janë shenja që përdoren në tregti për të treguar origjinën gjeografike të produkteve. Këto produkte gëzojnë cilësitë ose karakteristikat e të cilit vijnë, ekskluzivisht ose esencialisht, si rezultat i një mjedisi gjeografik të veçantë, që përfshin faktorët natyrorë dhe njerëzorë, të trashëguar nga ky mjedis. Mbrojtja e produkteve unike shqiptare paraqet rëndësi të veçantë për Shqipërinë pasi regjistrimi kombëtar e më tej ai ndërkombëtar, ndikon në rritjen e vlerës së tyrë, në gjallërimin e zonave rurale, në ruajtjen e biodiversitetit, të trashëgimisë kulturore dhe gastronomike dhe ofron mundësinë e njohjes në tregjet e huaja të produkteve karakteristike shqiptare.

Produktet e mbrojtura si TGJ ose EO, i ofrohen në treg konsumatorit si produkte origjinale dhe cilësore. Verifikimi i përputhshmërisë me specifikimet e produktit përpara hedhjes së tij në treg bëhet nga autoriteti kompetent që është ministria përgjegjëse për bujqësinë për produktet bujqësore/ushqimore ose autorite të tjera kompetente për produkte

jobujqësore/joushqimore. Pas regjistrimit në DPPI çdo produkt me prejardhje nga Shqipëria që tregtohet si TGJM ose EOM, duhet të etiketohet me shprehjen “tregues gjeografik i mbrojtur” ose “emërtim origjine i mbrojtur” apo me logon e TGJM ose EOM.

Kapitulli i treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës që përfshihet në Ligjin nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë industriale”, ka ndryshuar tërësisht duke filluar që nga koncepti, kush e depoziton një aplikim e deri tek mënyra e ekzaminimit dhe përfshirja e logove që do të vendosen në produktet bujqësore, ushqimore apo ato jo bujqësore dhe jo ushqimore të regjistruara. Pjesa e ligjit për TGJM dhe EOM është përafëruar me rregulloren 1151/2012/EC datë, 21.11.2012 "Për skemat e cilësisë për prodhimet bujqësore dhe ushqimore" dhe rregulloren 1308/2013/EC dt.17.12.2013 "Për krijimin e një organizimi të përbashkët të tregjeve të produkteve bujqësore".


Këtë vit janë regjistruar disa produkte të cilat vijnë kryesisht nga zonat veriore të Shqipërisë si: Gështenja e Tropojës, Gështenja e Malësisë së Madhe, Mjalti i Gështenjës së Tropojës, Mjalti i Gështenjës- Malësi e Madhe, Boronica e Bjeshkëve të Tropojës, Boronica e Bjeshkëve Kuksiane.







Gjatë vitit 2017 janë depozituar 6 kërkesa për regjistrim treguesish gjeografikë nga subjekte shqiptare me një rritje prej 2% në krahasim me vitin 2016. Vlen të theksohet se aplikimet për të 6 treguesit gjeografikë janë bërë nga shoqata dhe jo nga individë, me dokumenta sipas standardeve të BE. Ndërsa në vitin 2016 janë depozituar 2 tregues gjeografikë.



Produktet e mbrojtura si TGJ / EO të regjistruara në DPPI:

No	Numri Aplikimit	Data Aplikimit	PRODUKTI	EMRI I PRONARIT
1	AL//E/2001/001	05/03/1998	Ujë GLINA	ALFA-SA GLINA SHPK
2	AL/E/2006/000006	19/12/2006	BORSH Y.HAJDINI	S.E.D. Borsh Sh.p.k. [AL]
3	AL/E/2010/000001	10/12/2010	PARMIGIANO REGGIANO	Consorzio del Formaggio "Parmigiano-Reggiano" [IT]
4	AL/E/2013/000001	4/4/2013	SARANDA	PREVIZI SHPK [AL]
5	AL/E/2014/000001	3/3/2014	Uji Vlora	MUSTAFARAJ [AL]
6	AL/E/2014/000002	16/06/2014	Jufka Dibrane	Shoqata "Gruaja dibrane shpresa e së ardhmes" [AL]
7	AL/E/2016/000001	12/12/2016	Keci i Hasit	Shoqata e Blegtorëve të Dhisë Hasi [AL]
8	AL/E/2017/000001	16/02/2017	Boronica e Bjeshkëve Kukësi	Shoqata e Grumbulluesve dhe Tregëtarëve të Boronicës Kukës [AL]
9	AL/E/2017/000002	16/02/2017	Boronica e Bjeshkëve të Tropojës	Shoqata e Grumbulluesve dhe Tregëtarëve të Boronicës Tropojë [AL]
10	AL/E/2017/000005	2/3/2017	Mjalti i Gështenjës- Malësi e Madhe	Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) "Reçi Prodhimtar-Malësi e Madhe" [AL]
11	AL/E/2017/000006	2/3/2017	Gështenja e Malësisë së Madhe	Shoqëria e Bashkëpunimit Bujqësor (SHBB) "Reçi Prodhimtar-Malësi e Madhe" [AL]
12	AL/E/2017/000003	2/3/2017	Gështenja e Tropojës	Shoqata e prodhuesve të gështenjës dhe mjaltit të gështenjës në Tropojë (SHPGMG) [AL]
13	AL/E/2017/000004	2/3/2017	Mjalti i Gështenjës së Tropojës	Shoqata e prodhuesve të gështenjës dhe mjaltit të gështenjës në Tropojë (SHPGMG) [AL]
14	AL/E/2016/000002	30/12/2016	Uji "Korabi"	A-KORABI [AL]

Në përfundim të zbatimit të Projektit “BiodivBalkan”, nga Agjencia e Zhvillimit të Zonave në bashkëpunim të ngushtë me DPPI, duke dhënë kontribut në Komitetin Drejtues të Projektit “BiodivBalkan”, katër produkte territoriale (Kecat e Hasit, Boronica e Tropojës dhe Kukësit, Gështenja e Reçit në Malësi të Madhe, Gështenja e Tropojës dhe Mjalti i Gështenjës së Reçit në

Malësinë e Madhe dhe Mjalti i Gështenjës së Tropojës) u regjistruan si produkte reale me indikacion gjeografik. Në këtë projekt ndihmesa dhe roli i DPPI ka qenë i vazhdueshëm.

Një nga komponentët e rëndësishëm të projektit “BiodivBalkan” ka qenë dhe komponenti i "Përmirësimit të Kuadrit Ligjor" në lidhje me Treguesit Gjeografikë në Shqipëri. Mbështetja nga DPPI në zbatimin praktik të këtij komponenti, pa përjashtuar edhe kontributin në çështje të tjera, të ofruara në mbledhjet e Komitetit Drejtues të projektit, ka konkretizuar me sukses projektin. DPPI ka paraqitur referencat dhe prezantimet e nevojshme në këto mbledhje dhe aktivitete, të cilat kanë shërbyer, jo vetëm në evidentimin e problematikave në aspektet ligjore që lidhen me Treguesit Gjeografikë në Shqipëri, por edhe në rekomandimet e ofruara për përmirësimin e këtij ligji.

AKTIVITETI PROMOVUES DHE NDËRGJEGJËSIMI

Pronësia industriale dhe të mirat që burojnë prej e saj shpesh nuk vlerësohen në mënyrë adekuate. Produktet e reja, markat dhe disajnet kreative shfaqen pothuajse çdo ditë në treg dhe janë rezultat i inovacionit dhe krijimtarisë së vazhdueshme njerëzore. Prandaj, duke shqyrtuar rëndësinë e Pronësisë industriale jo vetëm për biznesin, por edhe për të gjithë aktorët që ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror, promovimi i rolit të pronësisë industriale është një nga sfidat e rëndësishme me të cilat përballlet DPPI.

Sistemi i mbrojtjes së pronësisë industriale jep të drejta ekskluzive për pronarët. Ata mund të kontrollojnë dhe shfrytëzojnë idetë dhe krijimet e tyre duke përfshirë të drejtat për të bërë, përdorur, shpërndarë, shitur dhe eksportuar produktet e tyre. Ata gjithashtu mund të fillojnë veprime ligjore kundër palëve që shkelin të drejtat e tyre. Megjithatë, shumë prej tyre nuk janë në dijeni të rëndësisë së pronësisë industriale. Nevojitet kështu ndërgjegjësimi publik për rëndësinë e objekteve të pronësisë industriale, për të mos neglizhuar benefitet dhe për t'i respektuar të drejtat mbi to.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NMV) janë shpesh forca lëvizëse e përfshirë në inovacion, megjithatë, shumë NVM nuk janë në dijeni të sistemit të pronësisë intelektuale ose të mbrojtjes që mund të sigurojnë për shpikjet, markat dhe disajnet e tyre. Nëse mbeten të pambrojtura, një shpikje apo krijim i mirë mund të humbasë nga konkurrentët më të mëdhenj që janë në një pozitë më të mirë për të tregtuar produktin ose shërbimin me një çmim më të volitshëm, duke e lënë shpikësin ose krijuesin origjinal pa asnjë përfitim financiar ose shpërblim.

Sistemi i PI, mundëson që kompanitë të përfitojnë nga kapaciteti i tyre novator dhe kreativiteti dhe i inkurajon ato për inovacione të mëtejshme. Potenciali për krijimtari dhe inovacion dhe për përfitime të ardhshme nuk duhet të nënvlerësohet. PI mund të bëhet një aset i vlefshëm për biznesin nëse është i mbrojtur ligjërisht duke kërkuar regjistrimin në DPPI. Objektet e pronësisë industriale të regjistruara mund të gjenerojë të ardhura përmes licencimit, shitjes ose komercializimit të aseteve të PI, mjete këto që mund të rrisin

marzhin e fitimit, dhe për më tepër, ato mund të rrisin vlerën e kompanive në sytë e investitorëve dhe institucioneve financiare. Prandaj, në rast të shitjes ose shkrirjes ose blerjes, asetet PI mund të rrisin ndjeshëm vlerën e ndërmarrjes.

Bizneset të mbrojnë pronësinë e tyre industriale.

Ministrja Milva Ekonomi në takim me biznesin.

Në vitin 2017 duke vlerësuar rëndësisht e pronësisë industriale dhe bazuar në të dhënat e regjistrave të DPPI-së, Ministrja e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, znj. Milva Ekonomi, zhvilloi një vizitë në një prej kompanive shqiptare që prodhojnë produkte Made in Albania, jo vetëm për tregun vendas, por dhe për eksport. Ministrja u ndal tek kompania “Beba Cosmetics”, e cila nga 56 produkte që prodhon, 53 prej tyre i ka të regjistruara dhe të mbrojtura me markë pranë DPPI-së.

Ministrja Ekonomi teksa përgëzoi përfaqësuesit e kësaj kompanie për seriozitetin dhe për regjistrimin e pronësisë së tyre industriale, theksoi se bizneset duhet të ndërgjegjësohen për të ndjekur të njëjtin model, që të mbrojnë pronën e vet industriale, pasi kështu janë dhe më konkurrues në treg. Ministrja u shpreh se produktet ‘Made in Albania’ janë një faktor shumë i rëndësishëm për ekonominë e Shqipërisë. Ajo shtoi se për shumë kompani vlera e aseteve jo materiale, siç janë patentat mbi shpikjet, markat tregtare apo disenjot industriale e tejkalon dukshëm vlerën e aseteve fizike, ndaj është i domosdoshëm regjistrimi dhe mbrojtja e tyre.

Gjatë këtij takimi përfaqësuesit e kompanisë u shprehën shumë të kënaqur nga bashkëpunimi me DPPI-në, për regjistrimin e produkteve.

Kjo kompani eksporton në disa vende të rajonit, ku nevojitet që gjithashtu këto marka të regjistrohen dhe ndërkombëtarisht.

Ministrja Ekonomi u shpreh se është për të ardhur keq që ka një numër të vogël markash të regjistruara jashtë territorit të Shqipërisë, ndaj kërkohet një punë më e madhe për të ndërgjegjësuar kompanitë shqiptare të regjistrojnë markat e tyre edhe në vendet ku eksportojnë.

Ajo shtoi se qeveria shqiptare, i ka përshtatur më së miri kushtet, duke aderuar në marrëveshjet ndërkombetare të kësaj fushe, duke i dhënë mundësinë, që shtetasit dhe sipërmarrësit shqiptarë, të kërkojnë të drejtat e mbrojtjes edhe në vendet partnere, ku kanë të shtrirë aktivitetin e tyre.

Kompania në fjalë është një kompani shqiptare e cila që prej vitit 1993 ka arritur të prodhojë një gamë të gjerë produktesh ku përfshihen: grupi i kremrave, locioneve, pudrave, artikujt për mbrojtjen e flokëve, detergjentë të ndryshëm pastrimi si edhe artikuj të sezonit veror për mbrojtjen e lëkurës. Sot veprimtaria e saj është e shtrirë në një territor të gjerë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KONFERENCA DHE SEMINARE

- **“Konferencë Kombëtare” 26 Prill 2017, Dita Botërore e Pronësisë Intelektuale**

“Inovacioni Përmirëson Cilësinë e Jetës”

Siç është bërë traditë edhe në këtë vit DPPI me mbështetjen e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, më datë 26 Prill 2017 me rastin e Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, organizoi një Konferencë Kombëtare me sloganin: “Inovacioni Përmirëson Cilësinë e Jetës”

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësues të nivelit të lartë nga institucionet publike, universitetet, partnerët ndërkombëtarë, artistë të shquar, shpikës shqiptarë, dhomat e tregtisë, përfaqësues të biznesit, dhe përfaqësues të autorizuar.

Në panelin kryesor të kësaj konference ishte Znj. Milva Ekonomi, Ministre e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, e cila në fjalën e saj vuri theksin në rëndësinë e inovacionit si tregues i arritjeve të mendjes njerëzore për përmirësimin e cilësisë së jetës. Ministria Ekonomi përmendi politikën, strategjitë dhe përmirësimet e bazës ligjore që janë miratuar në mbështetje të punës inovative në Shqipëri. Gjithashtu ajo u shpreh mbi rëndësinë e orientimit të produkteve që burojnë nga puna kërkimore drejt mbrojtjes së tyre nëpërmjet regjistrimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale, por edhe me marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e tyre në treg nga strukturat përkatëse shtetërore, siç është Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut. Në këtë panel ishte edhe Znj. Mirela Kumbaro, Ministre e Kulturës. Fjala e Ministres së Kulturës u fokusua në arritjet e kësaj ministrie në lidhje me plotësimin e bazës ligjore mbi mbrojtjen e të drejtave të autorit, gjë që ishte një nevojë imediate që prej shumë kohësh në territorin shqiptar, më së fundmi e bërë realitet. Këto dispozita ligjore do të forcojnë respektimin e të drejtave të artistëve në Shqipëri. Nuk mund të mungonte në këtë panel edhe znj. Milena Harito, Ministre e Inovacionit dhe Administratës Publike, e cila u shpreh për rëndësinë që i jep qeveria shqiptare njohjes dhe menaxhimit të inovacionit në Shqipëri.

Në panelin e dytë, z. Elvin Lako, Drejtor i Përgjithshëm i DPPI, në fjalën e tij, prezantoi masat reformuese dhe ligjore të sistemit të pronësisë industriale. Të rejat që kjo reformë sjell mbi kompetencat e DPPI dhe mënyrën e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale, duke lehtësuar procedurat e aplikimit, si dhe duke u dhënë atyre vlerën e merituar në treg. Drejtori i Përgjithshëm i DPPI, z. Lako bëri dhe një prezantim të shërbimeve të reja që DPPI ofron si dhe të arritjeve të dukshme të këtij institucioni gjatë viteve të fundit. Mesazhi që ai përcolli në fjalën e tij ishte që, është krijuar baza ligjore e duhur, e përafëruar me standardet e Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të drejtave mbi pronësinë e aseteve jo-fizike siç janë: patentat mbi shpikjet, markat tregtare, disenjot industriale, treguesit gjeografikë. Kjo përkthehet në motivim për

krijuesit dhe sipërmarrësit tregtarë, mbrojtja e tyre sigurohet nëpërmjet përcaktimit të qartë të kompetencave ligjore dhe bashkëpunimit të frytshëm ndërinstitucional.

Gjithashtu, mbajtën fjalën e tyre në këtë konferencë z. Edmond Ahmeti, Drejtor i Drejtorisë të së Drejtës së Autorit, znj. Ines Muçostepa, Kryetare e Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, Prof. Dr. Shuajp Kraja, Shpikësi i Patentuar nga Zyra Evropiane e Patentave dhe z. Altin Maliqi, Profesor në Kolegjin Universitar Jo-Publik “Luarasi”.

Ky event që DPPI vazhdimisht organizon, është një rast i mirë për të vënë theksin edhe një herë në rolin që duhet të luajnë të gjitha institucionet publike të cilat janë të përfshira në sistemin e Pronësisë Intelektuale në vendin tonë dhe krijimit të një publiku të informuar mbi rëndësinë e mbrojtjes së PI në territorin e Republikës së Shqipërisë.

(Foto të Konferencë Kombëtare, 26 Prill 2017)







- **DPPI në Konferencën Kombëtare “Ruajtja e biodiversitetit dhe zhvillimi i treguesve gjeografikë për produktet lokale në zonën veriore të Shqipërisë”**

Kjo konferencë u zhvillua më datë 12.12.2017 në “Tirana International Hotel” nga Agjencia e Zhvillimit të zonave Malore në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ambasadën Franceze në Tiranë.

Në këtë event DPPI prezantoi rregullimet ligjore që sollën ndryshimet në ligjin nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar për pjesën e treguesve gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, procedurat për regjistrimin e tyre. Ky ligj për herë të parë plotëson kuadrin ligjor të përshtatshëm dhe të përafëruar me kriteret e BE për mbrojtjen e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës. Mbrojtja e tyre si objekte të Pronësisë industriale u jep produkteve vlerë të shtuar ekonomike duke nxitur prodhuesit të hedhin ato në treg nën indikacionet e mbrojtura të origjinës dhe duke iu përmbajtur cilësisë dhe karakteristikave unike të produkteve. Ky sistem krijon gjallërimin e aktivitetit prodhues dhe tregtar në zonat rurale, zhvillim të turizmit, hapje të vendeve të reja të punës dhe eksport të produkteve shqiptare edhe në tregjet përtej kufijve.

DPPI është pjesë e institucioneve që kanë mbështetur dhe janë përfshirë në zbatimin e Projektit “BiodivBalkans”, i cili është një projekt i financuar nga Fondi Francez për Mjedisin Botëror (FFEM) dhe Qeveria Shqiptare, i zbatuar gjatë një periudhe 5-vjeçare në zonën veriore të vendit dhe që synon të kontribuojë në promovimin e ruajtjes së biodiversitetit dhe zhvillimin e produkteve unike lokale, cilësia e të cilave është e lidhur ngushtë me origjinën e tyre gjeografike.

Katër produkte janë mbështetur nga projekti në zhvillimin e zinxhirit të vlerës dhe regjistrimin e tyre si:

- (i) Gështenja e Tropojës dhe e Reçit në Malësinë e Madhe;
- (ii) Mjalti i Gështenjës në Reç të Malësisë së Madhe dhe në Tropojë;
- (iii) Mishi i kecave të Hasit;
- (iiii) Boronica në rajonet e Tropojës dhe të Kukësit.

Kjo Konferencë bashkoi aktorë të ndryshëm edhe nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, përfaqësues nga Ambasada Franceze, nga Delegacioni i Bashkimit Evropian, nga institucione të ndryshme publike dhe private, partnerë të ndryshëm (UNDP, USAID, GIZ, FAO, SARED), ekspertë, përfaqësues nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, OJF të ndryshme, etj.

(Foto të konferencës “Ruajtja e Biodiversitetit dhe zhvillimi i treguesve gjeografikë për produktet lokale në zonën veriore të Shqipërisë”)



- **Seminari I, “Mbi Programet Financiare të Bashkimit Evropian dhe Mbrojtjen e Pronësisë Industriale”.**

Më datë 6 Korrik 2017, në ambientet e Godinës së Inovacionit Tiranë, DPPI në bashkëpunim me Agjencinë e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe Unionin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, organizuan një seminar me të ftuar përfaqësues të biznesit, gjithashtu të pranishëm ishin profesorë të Universitetit të Durrësit “Aleksandër Moisiu” dhe të Universitetit “Politeknik” Tiranë, si dhe specialistë të sektorit për pronësinë industriale të Inspektoratit Shtetëror të Monitorimit të Tregut. Në këtë seminar u prezantua mbi rolin e DPPI, të drejtat që fitohen nga regjistrimi i objekteve të pronësisë industriale, mënyrat e mbrojtjes nëpërmjet rregjistrimit kombëtar dhe ndërkombëtar, si dhe rrugët ligjore për të kërkuar ndalimin e cënimit të të drejtave mbi objektet e PI. Gjithashtu, u prezantuan procedurat administrative pranë DPPI, për patentimin e shpikjeve. Bizenset e pranishme në këtë seminar u ftuan që të krijojnë kontakte me DPPI për të përfituar nga shërbimi i ri që ne ofrojmë, “Analizën e Pronësisë Intelektuale”.

(Foto të seminarit me biznesin, 06 Korrik 2017)





- **Seminari II, "Projektet, Programet financiare të Bashkimit Evropian dhe Pronësia Intelektuale"**

Ky seminar u zhvillua më datë 12.10.2017, në Qendrën Evropiane të Informacionit në Pallatin e Kongreseve, Tiranë. Në këtë seminar DPPI prezantoi rëndësinë e mbrojtjes së patentave mbi shpikjet dhe markat tregtare. Gjithashtu, në këtë seminar ishin të pranishëm institucione të tjera të lidhura me inovacionin dhe interesat e biznesit si: AKKSHI, UCCIAL, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit, DDA dhe Ministria e Kulturës. Pjesëmarrës në këtë seminar ishin përfaqësues të bizneseve nga Tirana dhe nga rrethet e ndryshme të vendit. Përveç prezantimeve, nga paneli në këtë seminar u zhvilluan dhe pyetje - përgjigje duke sqaruar çështje dhe procedura ligjore për mbrojtjen e PI në Shqipëri. Ky seminar ishte një rast i mirë për të krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet institucioneve që organizuan këtë event me qëllim përmbushjen sa më të mirë të funksioneve përkatëse si dhe orientimin e biznesit drejt mbrojtjes dhe zhvillimit të inovacionit.

(Foto të seminarit me bizneset datë 12.10.2017)



- **Seminari “Tirana SME week 2017: Speed Up to Europe”**

Ky seminar u zhvillua më datë 16.11.2017, në Tiranë në kuadër të Javës së SME-ve, e cila është një fushatë pan-evropiane që synon të promovojë sipërmarrjen në Evropë. Evente të tilla ndihmojnë sipërmarrësit ekzistues të gjejnë informacion mbi mbështetjen në dispozicion të tyre dhe përpiqen të inkurajojnë më shumë njerëz për të filluar një sipërmarrje.

Në këtë event DPPI u përfaqësua me prezantimin me temë “Rëndësia e mbrojtjes së Pronësisë industriale për biznesin shqiptar, markat tregtare dhe procedurat e regjistrimit”. Të pranishëm në këtë seminar ishin përfaqësues nga komuniteti i biznesit, shoqëria civile dhe agjencitë qeveritare. Ata ndanë përvojat dhe njohuritë e tyre se si të përmirësojnë mjedisin e biznesit në Shqipëri, duke mbuluar temat kryesore: “Produktet Made in Albania”, “EU, një partner strategjik”, “Roli i medias për konsumatorin dhe përmirësimi i standardit të produkteve shqiptare, qasjen më të mirë financiare për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”. Për më tepër, pjesëmarrësit kishin një gamë të gjerë diskutimi mbi “konkurrencën e SME-ve përmes inovacionit”.

(Foto të seminarit “Tirana SME week 2017: Speed Up to Europe”, 16.11.2017)



- **DPPI në Panairin Ndërkombëtar të Shpikjes (ISIF 2017)**

Gjatë muajit Mars 2017 në Stamboll të Turqisë u organizua Panairi Ndërkombëtar i Shpikjes (ISIF 2017). ISIF u organizua nga Shoqata e Shpikjeve dhe Shpikësve të Anadollit, organizuar nga Zyra e Patentave dhe Markave Tregtare të Turqisë, gjithashtu me mbështetjen e Republikës së Turqisë, Ministrisë së Shkencës, Industrisë dhe Teknologjisë, Federatës Ndërkombëtare të Shpikësve dhe Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale. Në këtë aktivitet, për të promovuar sistemin e mbrojtjes së pronësisë industriale të Shqipërisë, ishin të pranishëm pëfaqësues nga Drejtoria e Koordinimit, Promovimit të PI dhe Trajnimeve, të DPPI.

Ceremoninë e hapjes e drejtuan presidentit i Zyrës Turke të Patentave dhe Markave, Prof. Dr. Habip Asan si dhe, z. Quan-ling Sim (Shef i Seksionit, OBPI), z. Carlo Pandolfi (Drejtor i Bashkëpunimit Evropian, ZEP), duke theksuar rëndësinë e organizimit të ekspozitës ndërkombëtare të shpikjeve, si një mundësi mjaft e mirë për shpikësit, duke shfaqur idetë dhe teknologjitë e tyre.

Gjatë eventit, u ekspozuan mbi 330 teknologji të reja nga 34 vende, duke përfshirë Poloninë, Iranin, Moldavianë, Rumaninë, Gjermaninë, Kanadanë, Tajlandën, Libanin, Libinë, Malajzinë, Britaninë e Madhe, Japoninë, Irakun, Portugalinë, Indonezinë, Indinë, Kinën, Egjiptin, Arabinë Saudite, Bosnje- Hercegovinën dhe Tunizinë.

(Foto në Panairin Ndërkombëtar të Shpikjes)



1.2. ANALIZA E PRONËSISË INTELLEKTUALE

Edhe gjatë vitit 2017 DPPI ka vazhduar të kryejë takimet me biznesin për të kryer Analizën e Pronësisë Intellektuale. Metodologjia e kësaj analize është projektuar dhe monitorohet zbatimi i saj, nga Zyra Evropiane e Patentave (ZEP) dhe gjithashtu mundësoi trajnimin e stafit të DPPI për mënyrën e se si kryhet “Analiza e Pronësisë Intellektuale” duke filluar me evidentimin e bizneseve, kontaktimin, zhvillimin e intervistave dhe hartimin e raporteve të "Analizës së Pronësisë Intellektuale".

Stafi i DPPI ka zhvilluar mbi 100 takime të tilla me biznesin vendas. Analiza e Pronësisë Intellektuale është një shërbim që DPPI ofron falas për biznesin vendas. Kështu, ekspertët e DPPI japin sugjerime dhe këshilla direkte pasi analizojnë nevojat dhe situatën konkrete të tyre. Ky aktivitet gjithashtu është një mundësi shumë e mirë për promovimin e sistemit të PI. Këto vizita janë zhvilluar në biznese të ndryshme në Tiranë, si dhe në biznese në rrethet e tjera të Shqipërisë si në qytetet e Vlorës, Sarandës, Përmetit dhe Beratit.

Duke qenë se qyteti i Përmetit ka një trashëgimi të hershme dhe të mirënjohur në lidhje me prodhimet bio, kryesisht të glikosë së arrës e patëllxhanit, por dhe të verës, rakisë dhe prodhimet e bulmetit, DPPI evidentoi këta sipërmarrës me potencial të lartë, për të mbrojtur objektet e pronësisë industriale. Bizneset e takuara u përzgjodhën nga rëndësia që ata mbartin në lidhje me një ndër objekteve kryesore të pronësisë industriale, siç është treguesi gjeografik, në bashkëpunim me Konsorciumin “Pro-Përmet” dhe Projektin “CESVI”, të cilët mbështesin dhe nxisin zhvillimin e prodhimeve bio vendase, si dhe trashëgiminë për produktet tipike të zonës. Këto kompani kanë fituar çmime të ndryshme në rang kombëtar dhe ndërkombëtar, duke u pajisur me certifikata vlerësimi dhe çmime të rëndësishme, si kompania "Almeg" për glikonë e arrës nga "Prestigium-Italia" dhe Kantina "Bejko", për verën nga vreshtat tipike të zonës, siç është vera e bardhë "Debine", dhënë nga Ministria e Bujqësisë së Shqipërisë, në "Festivalin e Verës Shqiptare" për vitin 2016.

Ndërsa, në qytetin e Beratit u evidentuan kryesisht kompani të mëdha prodhimi, përpunimi dhe eksporti, të produkteve vendase. Këto kompani, kanë histori suksesi në rang kombëtar dhe disa prej tyre në rajon e më gjerë. Ndër to vlen të përmendet "Sidnej" Shpk që përgjatë 15 viteve në treg, ka prodhuar një gamë të gjerë të frutave dhe perimeve të konservuara, duke vazhduar traditën e qytetit të Beratit, përfshirë në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s. Kjo kompani numëron 180 produkte, të cilët gjithashtu eksportohen në Evropë e më gjerë. Në vitin 2004 kompania "Sidnej" është nderuar me çmimin "Crown Award" në Londër si dhe në Gjenevë në vitin 2005, me çmimin "Star" për cilësi ndërkombëtare. Këto takime ishin mjaft frytëdhënëse dhe subjektet shfaqën një interes të veçantë, duke qenë bashkëpunues dhe mikëpritës. Ky aktivitet i ofrohet biznesit shqiptar, sipërmarrjeve të mëdha tregtare, por sigurisht edhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, për të rritur të ndërgjegjësimin për mbrojtjen e PI.





AKTIVITETE DHE BASHKËPUNIME NË FUSHËN E ARSIMIT

- **Nënshkruhet Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet DPPI dhe Universitetit ‘Ismail Qemali’ Vlorë**

DPPI një rëndësi të veçantë i ka kushtuar bashkëpunimeve dhe zhvillimit të aktiviteteve me universitetet dhe Shkollat e mesme. Kjo është një mënyrë mënyrë e mirë për edukimin e brezit të ri mbi respektimin e të drejtave të PI. Gjatë vitit 2016 DPPI ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me kolegjin universitar jo-publik “Luarasi” dhe universitetin jo-publik “Metropolitan”, ndërsa, në vitin 2017 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit edhe me Universitetin ‘Ismail Qemali’ Vlorë.



Kjo marrëveshje u nënshkrua më datë 15.12.2017 në qytetin e Vlorës nga Drejtori i Përgjithshëm I DPPI z. Elvin Lako, dhe nga Rektori i këtij universiteti, Prof.Roland Zisi. Marrëveshja ka për qëllim rritjen e ndërgjegjësimit të studentëve, stafit akademik dhe profesionistëve të përfshirë në punë kërkimore dhe shkencore, për të drejtat që ata gëzojnë mbi punët e tyre, krijimin e një sistemi efektiv të informacionit për shpikjet në fushat e ndryshme të shkencës dhe zhvillimin e aktiviteteve që kanë për qëllim ndërgjegjësimin për rolin që ka mbrojtja e të drejtave mbi shpikjet në zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë në vend.

- **U krijua Qendra e Informacionit Teknik dhe Shkencor pranë Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë.**

Krijimi i kësaj qendre në vitin 2017 ishte gjithashtu një hap mjaft i rëndësishëm në drejtim të promovimit dhe ndërgjegjësimit mbi PI. Funkcioni i kësaj qendre do të jetë lehtësimi në qasjen ndaj informacionit mbi fushën e pronësisë industriale, sidomos për patentat mbi shpikjet, për studentët dhe të gjithë të intersuarit në qytetin e Vlorës. DPPI kontribuoi me pajisjen e kësaj

qendre me mjetet e duhura për funksionimin e saj, si kompjutera dhe materiale të tjera me informacione mbi PI. Stafi i kësaj qendre dhe studentët do të trajnohen nga DPPI me qëllim funksionimin sa më të mirë të saj. Kjo qendër informacioni është e dyta e krijuar, pas asaj në universitetin “Politeknik” në Tiranë. Parashikohen të ngrihen edhe dy qendra të tjera të këtij lloji, një në universitetin e Shkodrës dhe një në universitetin e Korçës. Ngritja e këtyre qendrave të informimit, është parashikim i “Strategjisë Kombëtare mbi Pronësinë Intellektuale 2016-2020”.

- **Leksion i hapur në Universitetin European të Tiranës**



Më datë 08 shkurt 2017, u zhvillua leksion i hapur në universitetin European të Tiranës (UET), me temë "Roli i DPPI për mbrojtjen e Pronësisë Industriale në Shqipëri". Ky leksion u ofrua nga DPPI në bashkëpunim me UET. Pjesëmarrës ishin studentë të masterit shkencor të fakultetit të drejtësisë dhe pedagogë të departmentit të drejtësisë të këtij universiteti. Prezantimet ishin mbi sistemin e Pronësisë industriale dhe zgjidhjen e konflikteve mbi markat pranë Bordit të Apelimit në DPPI. Pjesëmarrja aktive e studentëve dhe përgatitja e tyre në lidhje me çështje të ndryshme mbi të drejtat e Pronësisë industriale ishte e dukshme. Kjo e bëri zhvillimin e këtij aktiviteti mjaft të vlefshëm. Gjithashtu studentëve iu prezantuan lehtësirat ligjore të parashikuara, në lidhje me tarifat e reduktuara në vetëm 100 lekë, për aplikimet për patentimin e shpikjeve nga studentët.

- **DPPI në Konferencën, " Innovate Your Way Out" në Fakultetin e Ekonomisë, UT**



Kjo konferencë u zhvillua në muajin Qershor të vitit 2017. Studentët prezantuan projektet e tyre inovative. DPPI ishte e pranishme dhe kontaktoi të gjithë studentët që konkurruan duke i ftuar ata të paraqiten pranë DPPI për të marrë informacion për mbrojtjen e PI, patentimin e shpikjeve të tyre dhe mbrojtjen e markave tregtare apo disenjove industriale.

- **Leksione në shkollat e mesme të përgjithshme të Tiranës**

Në vitin 2017 DPPI ka organizuar dhe zhvilluar disa leksione në shkollat e mesme të përgjithshme të kryeqytetit, të kryera në bashkëpunim me Drejtorinë e së Drejtës së Autorit për të paraqitur sa më mirë gjithë sistemin e pronësisë intelektuale me të dy degët e saj pronësisë industriale dhe e drejta e autorit. Kemi shkuar në rreth 14 shkolla të mesme të përgjithshme të Tiranës si:

Gjimnazi “Qemal Stafa”; Gjimnazi “Sami Frashëri”; Gjimnazi “A. Z. Çajupi”; Gjimnazi “Eqerem Çabej”; Gjimnazi “Partizani”; Gjimnazi “Myslym Keta”; Gjimnazi “Sinan Tafaj”, Gjimnazi “Sandër Prosi”; Gjimnazi “Petro Nini Luarasi”, shkolla e mesme e gjuhëve të huaja “Asim Vokshi”, Gjimnazi “Ismail Qemali”; Gjimnazi “Aleks Buda” Gjimnazi “Besnik Sykja” dhe Gjimnazi “Arben Broci”.

Qëllimi i këtyre leksioneve ishte përhapja e njohurive bazë, tek brezi i ri mbi të drejtat e pronësisë industriale dhe të drejtat e autorit. Pjesëmarrës në këto leksione sëbashku me nxënësit ishin edhe mësuesit e lëndëve të ndryshme në këto shkolla. Këto leksione u kryen edhe me qëllim parapërgatitjen e nxënësve për konkursin që do të zhvillohej në fund të vitit për njohuritë e marra mbi pronësinë intelektuale. Sigurisht që ky aktivitet i shërben promovimit, krijimit të kulturës së respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të PI, duke filluar tek të rinjtë, te brezi i së ardhmes, si një target grup i përzgjedhur posaçërisht për këtë qëllim.

DPPI në bashkëpunim me Drejtorinë e së Drejtës së Autorit prezantuan para nxënësve rëndësinë dhe mënyrën e mbrojtjes së markave, patentave, disenjove industriale, treguesve gjeografikë, si dhe të të drejtave të autorit. U zhvilluan biseda dhe diskutime në mënyrë interaktive dhe u

përcoll mesazhi që institucionet që ne përfaqësojmë janë në shërbim dhe dispozicion të të gjithë personave të interesuar për regjistrimin e objekteve të PI. Regjistrimi siguron pronësinë dhe mbrojtjen ligjore për krijimtarinë e mendjes së njeriut. Të rinjtë duhet të besojnë te krijimtaria e tyre, por edhe të respektojnë krijimet e të tjerëve, sepse mbrojtja e veprave artistike dhe e objekteve të pronësisë industriale në vendin tonë është e garantuar me ligj. Gjithashtu, veprimet dhe procedurat për të fituar këtë mbrojtje janë të lehta dhe plotësisht të mundshme, ndaj edhe ata duhet të guxojnë të jenë krijues dhe të zhvillojnë idetë e tyre inovative. Këto eksperiencë janë të atilla që gjithmonë lënë mbresa shumë pozitive në punën e stafit të DPPI. Ne iu urojmë nxënësve, suksese në mësimet dhe falënderojmë stafin pedagogjik të këtyre shkollave për mundësinë e dhënë dhe mirëpritjen.

(Foto nga leksionet në shkollat e mesme)





- **Konkursi "Të Mbrojmë të Drejtat e Pronësisë Intelektuale" me shkollat e mesme të përgjithshme të Tiranës.**



Në muajin Dhjetor 2017, pasi u kryen leksionet e hapura në shkollat e mesme të Tiranës, DPPI së bashku me DDA organizuan konkursin "Të Mbrojmë të Drejtat e Pronësisë Intelektuale" me pyetje mbi njohuritë e përfituara nga nxënësit për sistemin e PI. Në shkollën e mesme "Arben Broci" u ulën në bankat e shkollës mbi 50 nxënës, nga gjimnazet e Tiranës, si Petro Nini Luarasi, Arben Broci, Besnik Sykja, Asim Vokshi, Sami Frasheri, Ismail Qemali, të cilët iu nënshtruan një provimi me pyetje të përgjithshme nga pronësia industriale dhe e drejta e autorit. Pjesëmarrësit treguan nivel shumë të mirë të përgatitjes në përgjigjet e tyre, gjë që tregon se këta nxënës i kishin përthithur mirë njohuritë e përcjella, por edhe dëshirën e këtyre të rinjve për të

mësuar dhe kuptuar me mirë të drejtat që fitohen nga Sistemi i PI. Ky konkurs përmbushi më së miri qëllimin e tij për rritjen e ndërgjegjësisimit dhe sensibilizimit të gjeneratave të reja që edukohen. Konkursi gjithashtu ishte objektiv i përmbushur nga “Strategjia Kombëtare mbi Pronësinë Intelektuale 2016-2020”.

(Momente nga ndarja e çmimeve të konkursit "Të mbrojmë të drejtat e Pronësisë Intelektuale")





Ceremonia për ndarjen e çmimeve për fituesit e konkursit "Të mbrojmë të drejtat e Pronësisë Intelektuale" u zhvillua më datë 27. 12. 2017. Kjo ceremoni u zhvillua pranë ambienteve të Galerisë Kombëtare të Arteve tek instalacioni "REJA", në bashkëpunim me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia Tiranë.

Fituesit e konkursit u shpallën si më poshtë:

Vendin e parë e fitoi Shkolla "Sami Frashëri" me nxënës **Ersi Limanaqi**.

Vendin e dytë e fitoi shkolla "Aleks Buda" me nxënëse **Klea Hysenukaj**.

Vendin e tretë e fitoi shkolla "Arben Broci" me nxënëse **Fjoralba Zerka**.

Për fituesit u ndanë çmime me vlera simbolike dhe motivuese si dhe të gjithë nxënësit e tjerë u pajisën me certifikata pjesëmarrjeje, libra dhe materiale promovuese. Pavarësisht çmimeve, vlerësojmë që të gjithë këta nxënës dolën fitues nga ky konkurs, të pajisur me njohuri të reja mbi këtë fushë të rëndësishme të së drejtës. Gjithashtu shpresojmë që këto aktivitete të jenë një stimul nxitës për krijimtarinë e të rinjve. Zhvillimi i këtij eventi përbën një sukses më shumë për punën tonë, por urimet më të mira shkojnë për këta të rinj pjesëmarrës në konkurs.

TRAJNIME TË INSTITUCIONEVE TË PËRFSHIRA NË SISTEMIN E PI


Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar trajnime mbi njohuritë e pronësisë industriale. DPPI është organi më i specializuar në fushën e PI-së në Shqipëri dhe ka për detyrë, edhe trajnimin e aktorëve të përfshirë në sistem, si: (prokurorinë, doganat, policinë, gjykatat, inspektorët, bizneset, përfaqësuesit e autorizuar, ekspertët e PI-së, universitetet, dhe individët në përgjithësi). Ngelet objektiv i rëndësishëm për tu realizuar nga DPPI, krijimi i një Qendre Trajnimesh për pronësinë industriale brenda strukturës së saj, e cila do të bëjë trajnimin e vazhdueshëm dhe profesional të të gjithë aktorëve në sistem, si dhe do të hartojë tekste informuese në këtë fushë.

- **Trajnim për stafin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut**



Më datë 12 Maj 2017, në orën 10:00, pranë ambienteve të DPPI, u zhvillua një takim me stafin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut (ISHMT). Në këtë takim përveç prezantimit që iu bë bazës ligjore për pronësinë industriale, u sollën në vëmendje të inspektorëve të ISHMT raste konkrete të shkeljeve të së drejtave dhe të abuzimit me markat tregtare dhe të shërbimit, si dhe çështje të tjera të lidhura me to. U diskutua gjithashtu me stafin e ISHMT dhe u shpjegua çdo paqartësi dhe pyetje të ndryshme që lindën gjatë këtij takimi.

- **Trajnim për punonjësit e strukturave të krimit ekonomik dhe financiar në Akademinë e Policisë**



Në kuadër të realizimit të objektivit bashkëpunimi me institucionet e përfshira në fushën e pronësisë intelektuale DPPI mori pjesë në trajnimin 3-ditor të organizuar nga Drejtoria e Policisë së Shtetit me temë: “Hetimi i veprave penale të shkeljes së të drejtave të Pronësisë Intelektuale, mashtrimit ushqimor, etj”. Trajnimi u zhvillua në Akademinë e Policisë me strukturat e krimit ekonomik dhe financiar, ku ishin të pranishëm 20 punonjës të këtyre strukturave.

Përfaqësuesit e DPPI shpjeguan me detaje objektet e pronësisë industriale, konceptet e përgjithshme mbi patentat për shpikje, market tregtare, disenjot industriale dhe treguesit gjeografikë. U analizua rëndësia që ka mbrojtja në treg e pronësisë industriale, si dhe u bë një prezantim i ligjit të ri të pronësisë industriale dhe vlera juridike e objekteve të pronësisë industriale. Gjithashtu u shpjeguan specifikat e korrespondencës, dhe mënyra e hartimit të Kërkesave për Hetim në regjistrin e DPPI, që Drejtoria e Policisë së Shtetit përcjell pranë DPPI në rastet e shkeljes së të drejtave.

BASHKËPUNIME

Çështjet e pronësisë industriale nuk mund të konceptohen të shtrira vetëm brenda një territori të caktuar. Pronësia industriale është një nga faktorët kryesorë që duhen patur parasysh për bashkëpunimet tregtare brenda dhe jashtë vendit, për këtë arsye sistemi i pronësisë industriale gjen shtrirje dhe bashkëpunim të gjerë ndërkombëtar.

Më qëllimin për harmonizimin e koncepteve dhe praktikave për zbatimin dhe mbrojtjen e të drejtave të PI janë krijuar mekanizma ndërkombëtare që vazhdimisht synojnë të sigurimin e garancisë dhe promovimin mbi këto të drejta.

Organizatat ndërkombëtare më të rëndësishme mbi mbrojtjen e të drejtave të PI janë: Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale: Misioni i saj është të inkurajojë aktivitetin krijues, të promovojë mbrojtjen e pronës intelektuale në të gjithë botë.

Zyra Evropiane e Patentave: Kjo zyrë jep patentat Evropiane për shtetet kontraktuese në Konventën Evropiane të Patentave.

Zyra Evropiane e Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale: Kryen procedurat e regjistrimit për titujt në PI të vendeve të BE dhe mban regjistrat publik të këtyre titujve. Ajo ndan me gjykatat në vendet anëtare të BE detyrën e shpalljes së gjykimeve me kërkesë për zhvleftësimin e titujve të regjistruar.

Aktualisht Shqipëria është vend anëtar i OBPI dhe anëtare e ZEP, si dhe ka statusin e vendit vëzhgues me ZBEPI deri në momentin e anëtarimit të Republikës së Shqipërisë në BE.

DPPI ka të nënshkruara Memorandume Mirëkuptimi dhe marrëveshje bashkëpunimi teknik me këto organizata.

BASHKËPUNIMET DHE MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE

- **Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit të DPPI me USPTO**



Në kuadrin e bashkëpunimit ndërkombëtar, në vëmendjen tonë vazhdimisht ka qenë edhe bashkëpunimi me zyrat homologe të PI të vendeve të tjera. Gjatë vitit 2017 është nënshkruar memorandum i bashkëpunimit me Zyrën e Patentave dhe Markave Tregtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USPTO). Ky memorandum, ka për synim nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të forcuar dhe zhvilluar sistemet e pronësisë industriale ekzistuese, duke krijuar një mekanizëm për të patur shkëmbim të rregullt të informacionit dhe të praktikave më të mira.

USPTO është pjesë e (IP5) i cili është një forum i pesë zyrave më të mëdha të pronësisë intelektuale në botë, i krijuar për të përmirësuar efikasitetin e procesit të ekzaminimit për patentat në mbarë botën. Anëtarët e IP5 janë: Zyra Evropiane e Patentave (EPO); Zyra Japoneze e Patentave (JPO); Zyra Koreane për Pronësi Intelektuale (KIPO); Zyra Shtetërore e Pronësisë Intelektuale e Republikës Popullore të Kinës (SIPO) dhe Zyra Amerikane e Patentave dhe Markave (USPTO).

Zyrat e IP5 përbëjnë 90% të të gjitha kërkesave për patentë të paraqitura në mbarë botën dhe për 93% të të gjitha punëve të kryera në kuadrin e Traktatit të Bashkëpunimit të Patentave (PCT). Vizioni i zyrave të IP5 është bashkëpunimi global, i cili është definuar si "eliminimi i duplikimit të panevojshëm të punës në Zyrat e IP5, rritja e efikasitetit dhe cilësisë së ekzaminimit të patentave dhe garantimi i stabilitetit të mbrojtjes së tyre". Ndërsa bota i sheh barrierat ekonomike mes vendeve të zbehen, inovatorët duan që krijimet e tyre intelektuale të mbrohen njëkohësisht në tregje të ndryshme. Prandaj, aplikimet për patentimin e të njëjtës teknologji kryhen në më shumë se në një zyrë patentash. IP5 mundëson zvogëlimin, deri në maksimumin e mundshëm, të dyfishimit të punës që kryhet në çdo zyrë për një familje të aplikimeve për patentë.

Ky memorandum bashkëpunimi ndërmjet DPPI dhe USPTO i shtohet listës së memorandumeve të nënshkruara në tre vitet e fundit me zyrat homologe të PI si ajo e Kinës, Turqisë, Polonisë, Serbisë. Këto memorandume janë nënshkruar me qëllimin për të krijuar efektshmëri të sistemit të regjistrimit dhe mbrojtjes së PI, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

DPPI është në proces të lidhjes së marrëveshjeve edhe me zyra të tjera homologe të vendeve të rajonit dhe më gjerë.

- **Takim ndërmjet drejtorit të përgjishshëm të DPPI Z. Elvin Lako me z. Enzo Damiani - Atashe/Menaxher i Sektorit për Tregun e Brendshëm, Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin, Seksioni Operacional.**

Në kuadër të bashkëpunimit me përfaqësues të institucioneve ndërkombëtare janë organizuar takime siç është takimi me z. Enzo Damiani - Atashe/Menaxher i Sektorit për Tregun e Brendshëm, Konkurrueshmërinë dhe Inovacionin, Seksioni Operacional II - Reforma Ekonomike dhe Infrastruktura dhe përfaqësues të DPPI, z. Elvin Lako, Drejtori Përgjithshëm. Në këtë takim u diskutua kryesisht mbi bashkëpunime të ndryshme ndërmjet institucioneve tona, bazuar dhe në objektivat që rrjedhin nga "Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2016-2020". Gjithashtu, një falënderim i veçantë shkoi për të gjithë përfaqësuesit e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri, për punën e vazhdueshme dhe ndihmën e dhënë institucionit tonë.

- **Takim ndërmjet drejtorit të përgjishshëm të DPPI, përfaqësues të Drejtorisë të së Drejtës së Autorit dhe përfaqësuesve të Delegacionit Danez.**



Takimi u krye pranë ambienteve të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm të DPPI z. Elvin Lako dhe Delegacionit Danez që u përfaqësua nga z.Michael Poulsen, Shef Departamenti për Projektet Ndërkombëtare pranë Ministrisë së Biznesit dhe Zhvillimit të Danimarkës dhe z.Keld Nymann Zv/Drejtor i Përgjithshëm pranë Zyrës së Patentave dhe Markave Tregtare të Danimarkës. Të pranishëm në këtë takim ishin dhe përfaqësues të Drejtorisë së Drejtës së Autorit. Gjatë këtij takimi u diskutuan çështje të ndryshme, mbi zbatimin e objektivave të “Strategjisë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020”, mbi Projektligjin mbi pronësinë industriale dhe për vitin 2017, si dhe arritjet kryesore të DPPI gjatë viteve të fundit. Gjithashtu, u diskutuan dhe u panë me interes mundësitë e frytshme të bashkëpunimit në vijim, për të lidhur marrëveshje mirëkuptimi, inicimi i marrëdhënieve ndërmjet institucioneve tona, në shkëmbime eksperiencash në fushën e pronësisë industriale dhe projekte të ndryshme në fushat përkatëse.

- **Takim ndërmjet i Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe institucioneve shqiptare për vlerësimin e konkurrueshmërisë dhe investimeve përfshirë edhe DPPI.**



Mbledhja koordinuese u organizua nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, OECD, në lidhje me politikat që nxisin konkurueshmërinë në Europën Juglindore, e përqëndruar specifikisht në ekonominë shqiptare. Të pranishmit në këtë takim diskutuan në lidhje me progresin e bërë dhe reformat në fushën e Pronësisë industriale. Arritjet e DPPI u cilësuan paraprakisht si shumë inkurajuese për zhvillimet në këtë fushë. Të pranishëm ishin ekspertë të kësaj organizate, përfaqësues nga DPPI, si edhe përfaqësues nga organet e tjera shtetërore dhe ekspertë nga organizatat jo-qeveritare. Fokusi kryesor i takimit, përveç diskutimeve që u zhvilluan, ishte dhe mbledhja e të dhënave për raportin e përvitshëm të OECD-së.

- **Takim ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Agjencisë për Pronësi Industriale të Republikës së Kosovës (API).**



Të pranishëm në këtë takim ishin drejtuesit e të dy institucioneve homologe, z. Elvin Lako Drejtor i Përgjithshëm i DPPI dhe z. Isa Dukaj, Drejtor i Përgjithshëm i API. Ky takim u organizua në kuadër të bashkëpunimeve që DPPI ka ndërmarrë së bashku me zyrën homologe të Kosovës. Në këtë takim u diskutuan çështje me interes në favor të dy zyrave, në lidhje me nënshkrimin e draft-marrëveshjes së mirëkuptimit, e cila synon të arrijë shkëmbimin e informacionit mbi legjislacionin në fushën e pronësisë industriale dhe orientimeve për përmirësimin e tij; bashkëpunimin në programet e trajnimit lidhur me pronësinë industriale; bashkëpunimin në fushën e automatizimit, përpunimit të informacionit të patentës dhe shërbimeve ndaj publikut; organizimin e seminareve dhe projekteve në fushën e përgjegjësisë; bashkëpunimin në fushën e shkëmbimit të informacionit dhe dokumentacionit të patentës; orientime të tjera të ardhshme të bashkëpunimit të pranuar bashkarisht nga zyrat; bashkëpunimin e ngushtë për ndërtimin e kapaciteteve të ekzaminimit dhe grantimit të pronësisë industriale nga zyrat; shkëmbimin e eksperiencave dhe materialeve promovuese për sa më sipër, si dhe impementimi i projekteve të përbashkëta në fushën e PI.

Gjithashtu, u diskutuan edhe çështje të tjera me rëndësi, mbi mënyrën e ekzaminimit të patentave kombëtare dhe markave tregtare, kryesisht ato kolektive, në disa raste specifike, duke shkëmbyer eksperiencat më të mira përkatëse, si në harmonizimin e legjislacionit dhe në mënyrën e krijimit të lehtësirave me dokumentacionin dhe tarifatat për aplikime nga shtetasit kosovarë në Shqipëri dhe anasjelltas. Zyrtat homologe të të dyja vendeve, synojnë forcimin e mëtejshëm të të dy institucioneve në mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale në rajon, sipas standardeve ndërkombëtare, si dhe në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe sigurisht në organizimin e aktiviteteve trajnuese e promovuese dypalëshe, në përmirësimin e fushës së pronësisë industriale.

KONTRIBUTI I DPPI NË PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

DPPI në vitin 2014 u caktua si institucioni lider për Kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale”, për të gjithë fushën e pronësisë intelektuale dhe ka kryer rolin e koordinatorit për të gjitha institucionet që veprojnë në këtë fushë.

Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë nga njëra anë dhe Komunitetit Evropian dhe Shteteve Anëtare të tij nga ana tjetër, u nënshkrua në qershor të vitit 2006 dhe hyri në fuqi në prill të vitit 2009. Prioritetet afat shkurtër dhe afat mesme të përcaktuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE) në fushën e “Pronësisë Intelektuale” janë realizuar.

DPPI në rolin e koordinatorit të kapitullit 7 ka realizuar sa më poshtë:

- Janë hartuar progres raportet e Shqipërisë për fushën e pronësisë industriale dhe janë përpiluar raportet përfundimtare për të gjithë fushën e pronësisë intelektuale (që përfshihen në kapitullin 7).
- Është përgatitur materiali për takimin e 9-të të Nënkomitetit tregu i brendshëm dhe konkurrenca përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe të shëndetit (për të gjithë kapitullin 7) dhe kemi përfaqësuar DPPI në këto takime në cilësinë e kordinatorit të kapitullit 7.
- Është përgatitur materiali për Komitetin e Stabilizim Asociimit për pronësinë industriale dhe është përmbledhur dhe përpunuar materiali për gjithë kapitullin 7.
- Është përgatitur materiali për takimin e Nënkomitetit të Bujqësisë dhe Peshkimit (përfaqësim i DPPI në lidhje me treguesit gjeografikë).
- Janë organizuar çdo muaj takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) për kapitullin 7 dhe është përgatitur materiali përkatës mbështetur në të PKIE.
- Kemi përgatitur dhe dërguar përgjigjet e pyetjeve të ‘FOLLOW-UP ACTIONS EU-Albania 9th SAA Subcommittee In the field of Internal Market and Competition’.

Në progres raportin e vitit 2016, Shqipëria vlerësohet se ka arritur një nivel përgatitje në fushën e të drejtave të Pronësisë Intelektuale. Janë bërë përparime duke përmbushur detyrimet sipas nenit 73 të MSA për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale, duke harmonizuar legjislacionin në fushën e pronësisë industriale me atë të vendeve të BE, duke miratuar ligjin “Për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e lidhura me të” dhe duke krijuar Inspektoratin Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut.

Falë punës intensive të kryer nga DPPI dhe në sajë të një bashkëpunimi të ngushtë të saj me MZHETTS dhe MFE dhe me institucionet e tjera shtetërore që operojnë në këtë fushë, kemi progres në realizimin e objektivave të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2016-2020” dhe në PKIE.

Përveç vlerësimit pozitiv në progres raportet e BE, po të njëjtin vlerësim për kapitullin 7 është dhënë dhe në takimet e nënkomitetit.

Takimi i fundit i nënkomitetit i organizuar në Bruksel në 17 Tetor 2017, u bazua në punën e mbledhjeve të mëparshme të tij. Ky ishte një forum për të diskutuar zbatimin e detyrimeve të parashikuara në MSA-së, si dhe përafrimin e legjislacionit të vendit me legjislacionin e BE-së (*acquis communautaire*) në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale të cilat për kapitullin 7 ishin realizuar.

Pra për kapitullin 7 “Pronësia Intelektuale” janë realizuar të gjitha detyrimet në lidhje me harmonizimin e legjislacionin, me reflektimin e ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, zbatimin e nenit 73 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, hartimin dhe zbatimin e “Strategjisë Kombëtare të PI” (2010-2015 dhe 2016-2020), forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të përfshira në fushën e PI, rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në përgjithësi, krijimin e Inspektoratit Shtetëror të Mbikqyrjes së Tregut, etj.

Ndryshe nga takimet e viteve të mëparshme ku lireshin një sërë rekomandimesh për t’u zbatuar në lidhje me fushën e pronësisë intelektuale, në takimin e fundit të nënkomitetit të 9^{të} zhvilluar në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, Shqipëria ftohet të ndjekë përpjekjet e saj për:

- Të zbatuar në mënyrë efektive të drejtat e pronësisë intelektuale, veçanërisht në luftën kundër mallrave të falsifikuara;
- Të trajnuar më tej gjyqtarët në këtë fushë.

Pra, ka një progres të dukshëm në fushën e pronësisë intelektuale dhe veçanërisht në fushën e pronësisë industriale ku janë realizuar të gjitha detyrimet e parashikuara në PKIE dhe “Strategjinë Kombëtare të PI (2016-2020)”.

BASHKËPUNIMET DHE MARRËDHËNIET ME INSTITUCIONET VENDASE

Bashkëpunimi ndërinstitutional konsiderohet të jetë çelësi i suksesit dhe garantimit të mbrojtjes së të drejtave të PI. Ky bashkëpunim është objektiv, i parashikuar në planin e veprimit të parashikuar në Strategjinë Kombëtare të PI 2016-2020. DPPI ka qenë mjaft aktive duke organizuar takime ndërinstitutionale me qëllim krijimin e urave të bashkëpunimit për evidentimin e subjekteve me potencial për inovacion dhe orientimin e tyre për regjistrimin dhe mbrojtjen e objekteve të pronësisë industriale.

- Takime me përfaqësuesit e autorizuar të markave tregtare dhe të patentave për shpikje



Janë zhvilluar tre takime gjatë vitit 2017 me përfaqësuesit e autorizuar të markave dhe të patentave. Këto takime kishin si qëllim përmirësimin e bashkëpunimit mes DPPI dhe përfaqësuesve të autorizuar, si dhe përshtatjen e aktivitetit dypalësh me ndryshimet e reja të ligjit nr. 17/2017, Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në Ligjin nr. 9947, datë 7.7.2008, "Për Pronësinë Industriale", të ndryshuar.

Një bashkëpunim i frytshëm mes DPPI dhe përfaqësuesve të autorizuar mundëson rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj publikut dhe mbajtësve të të drejtave të pronësisë industriale.

Gjatë këtij takimi u diskutuan ndryshimet dhe përmirësimet e këtij ligji, lehtësimi i procedurave të ekzaminimit dhe krijimin e aplikimit online. Gjithashtu, u panë me mjaft interes çështje të tilla si: krijimi i bazës ligjore për sigurimin e objekteve të PI-së, si dhe për përdorimin e tyre si kolateral, me qëllim që objektet e PI-së të marrin në treg vlerën që u takon, përcaktimi ligjor i kriterëve për markat e mirënjohura, krijimi i bazës ligjore për licencimin e ekspertëve të PI nga DPPI për nevojat e proceseve gjyqësore dhe të hetimit, rishikimi i kriterëve për licencimin e përfaqësuesve të autorizuar, si dhe saktësimi i procedurave për regjistrimin e treguesve gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës me qëllim eliminimin e problemeve të hasura në praktikë, krijimi i bazës ligjore për krijimin e Dhomës së Shqyrtimit të Kërkesave për

Shfuqizim/Zhvlerësim, si dhe Dhomës për Shqyrtimin e Kundërshtimeve, si struktura brenda DPPI.

Përfaqësuesit e autorizuar përgëzuan iniciativën e DPPI, duke e konsideruar mjaft të rëndësishëm këtë ligj, u treguan mjaft entuziastë për përmirësimet e këtij ligji, pasi kjo do të ndikojë në përmirësimin e shërbimit dhe promovimit të PI-së tek biznesi. Impakti që do të sjellë ky ligj në rritjen e ndërgjegjësimit nga ana e biznesit do të thotë më shumë biznese të regjistruara dhe për rrjedhojë konkurrencë më e ndershme në tregun vendas.

- **Takim ndërmjet DPPI dhe Drejtorisë së të Drejtës së Autorit**



Edhe ky takim u realizua në kuadër të përmbushjes së aktiviteve të parashikuara në "Strategjinë Kombëtare mbi Pronësinë Intelektuale 2016-2020", pranë ambienteve të Ministrisë së Kulturës.

U diskutua në lidhje me realizimin e njërit prej objektivave, siç është zhvillimi një konkursi me shkollat e mesme të përgjithshme të kryeqytetit, i cili përveç natyrës së tij informuese dhe ndërgjegjëse, ka si qëllim edhe edukimin e brezit të ri duke i kultivuar rëndësinë që mbart respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të PI, në zhvillimin ekonomik dhe socio-kulturor të vendit.

- **Takim ndërmjet DPPI dhe Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë**



Më datë 02.11.2017, u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesve të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale dhe Unionit të Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë. Ky takim u zhvillua për të diskutuar mbi mënyrat e bashkëpunimit mes institucioneve për ardhjen në ndihmë të biznesit për kuptuar më mirë rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale. Nëpërmjet bashkëpunimit me Unionin e Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë, do të mundësohet shtrirja e aktiviteteve promovuese në të gjitha rrethet dhe qytetet e Shqipërisë. Gjithashtu, ky bashkëpunim do të konsistojë në evidentimin e subjekteve tregtare inovative me qëllim orientimin e tyre për mbrojtjen e objekteve të pronësisë industriale.

- **Takim në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dega Vlorë**



Gjatë aktiviteteve në rrethet e vendit, përfaqësuesit e DPPI kryen takime me drejtuesit e QKB-së në qytetin e Vlorës për të diskutuar për bashkëpunimin me bizneset, si dhe për të krijuar pika kontakti duke i orientuar ata drejt mbrojtjes së pronësisë industriale nëpërmjet regjistrimit pranë DPPI. Ky takim ndërinstitutional u krye në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që DPPI ka me QKB që në vitin 2014, për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale në vendin tonë.

TEKNOLOGJIA INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Në vijim të nismës së qeverisë për lehtësimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale e ka patur prioritet edhe në vitin 2017, përmirësimin e shërbimeve elektronike që ajo ofron. Si e tillë DPPI ka vijuar me përmirësimin e këtyre shërbimeve. Një nga arritjet kryesore është ndryshimi i ligjit për pranimin e aplikimeve në formë elektronike. Dhe pritet që në vitin 2018 të ofrohen shërbimet e aplikimit on-line të kërkesave për objektet e Pronësisë industriale. Sistemet e TIK në DPPI janë mirëmbajtur dhe përmirësuar vazhdimisht.

Më poshtë janë masat e marra gjatë vitit 2017

Në janar të vitit 2017 u konfigurua sistemi SAPI për procedimin e aplikimeve dhe dokumentave nga stafi i DPPI-së, për të gjithë vitit 2017, për arsye se sistemi funksionon me bazë konfigurimi vjetor, ku çdo ditë punë e vitit ka veprimet e bëra në këtë ditë. Janë administruar të drejtat e përdoruesëve në përputhje me profilin e punës si dhe janë zgjidhur problemet e hasura nga këta të fundit gjatë përdorimit të sistemit.

Është administruar dhe mirëmbajtur rrjeti kompjuterik (LAN) dhe është siguruar funksionimi i tij dhe i pajisjeve të instaluar në të. Gjatë gjithë vitit, stafi teknik i DPPI i ka ardhur në ndihmë të gjithë stafit, në përdorimin e bazës së të dhënave, dhe programeve të ndryshme në funksion të punës.


Sigurimi i back-up të përditshëm dhe testimi i funksionimit të tij, ka qënë një nga prioritetet kryesore të DPPI me qëllim sigurimin e ruajtjes së informacionit të plotë dhe të saktë për të bërë të mundur rikthimin e këtyre të dhënave në çdo rast dëmtimi. Janë mirëmbajtur dhe përditësuar rregullisht regjistrat on-line të DPPI-së. Faqja zyrtare e DPPI në internet është përditësuar me informacione për të gjitha aktivitetet dhe njoftime të kryera gjatë vitin 2017.

Në bashkëpunim me Zyrën Evropiane të Patentave është krijuar një web service për lidhjen e regjistrat on-line të patentave dhe Federated Register të Zyrës Evropiane të Patentave. Ky web servis shërben për të dërguar informacionin në kohë realë për statusin e patentave evropiane që kanë kërkuar vlefshmëri në Shqipëri.

Për vitin 2017 ka vijuar importimi në sistem nëpërmjet Modullit të Madridit i 10500 kërkesa për depozitim marke dhe dokumenta të tjerë, nga Sistemi i Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave.

Nga zyra e protokollit të DPPI-së janë pranuar në sistem 10475 kërkesa për depozitim të aplikimeve dhe dokumenta të tjerë për objektet e pronësisë industriale, të cilat janë pranuar nëpërmjet sistemit SAPI. Të gjitha këto kërkesa janë skanuar dhe indeksuar në këtë sistem, janë protokolluar dhe shpërndarë stafit të DPPI për ekzaminim.

Si pasojë e shkurtimit të afatit të ekzaminimit në vitin 2017 janë publikuar në total 12 buletinë për Patentat mbi shpikjet dhe Modelet e Përdorimit, dhe 21 buletinë për Markat Tregtare dhe Disenjove Industriale si më poshtë: pra në total janë kryer 33 publikime të Buletinëve të pronësisë industriale. Publikimi më i shpeshtë i buletinit të markave ndikoi ndjeshëm në shkurtimin e afatit të regjistrimit të tyre.



Gjithashtu DPPI në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare të PI ofron dhe shërbimet e mëposhtme:

- Integrimi në modulet TMclass, TMview dhe DesignView

TMclass, TMview dhe DesignView janë sisteme kërkimi të menaxhuara nga Zyra Bashkimit Evropian për Pronësinë Intelektuale për mallrat dhe shërbimet sipas klasifikimit të Nicës, markat tregtare dhe disenjot industriale.

Aktualisht Shqipëria është pjesë e moduleve:

1. TMClass, për Klasifikimin Ndërkombëtar të Mallrave dhe Shërbimeve (Klasifikimi i Nicës).
2. TMview i cili shërben për kërkimin e markave të aplikuara apo regjistruara në të gjitha vendet që kanë integruar këtë sistem. 40 milion marka tregtare në total, në këtë mënyrë kompanitë e huaja mund të marrin informacion për markat dhe disenjot industriale të mbrojtura në Shqipëri. Ky regjistër përditësohet çdo ditë me markat e publikuara.
3. DSview baza e të dhënave on-line për disenjot industriale.

Këto sisteme janë të aksesueshme edhe në gjuhën shqipe dhe përditësohen çdo ditë me të dhënat nga zyrat pjesëmarrëse.

Shërbimet e lartpërmendura i bëjnë të njohura në gjithë Evropën objektet e pronësisë industriale të mbrojtura në Republikën e Shqipërisë, duke zgjeruar territorin ku shpërndahet informacioni mbi markat tregtare dhe disenjot industriale arrihet edhe forcimi i mbrojtjes dhe shtimi i reputacionit të tyre. Përdorimi i këtyre të dhënave lehtëson kompanitë e huaja që kërkojnë të mbrohen në Shqipëri të marrin informacion në kohë reale mbi statusin e aplikimeve të tyre. Kjo gjë rrjedhimisht ndikon në shtimin e aplikimeve nga subjektet e huaja në Republikën e Shqipërisë.

- Espacenet në gjuhën Shqipe

Aksesimi në gjuhën shqipe në Espacenet, i cili është një sistem kërkimi i ZEP, që ofron pa pagesë informacionin rreth shpikjeve dhe zhvillimeve teknologjike që nga shekulli i 19-të e deri sot. Nëpërmjet përdorimit të këtij sistemi kërkimi shpikësit shqiptar, bizneset apo qendrat e kërkimit, por edhe fillestarët mund të marrin informacion nëse një patentë është lëshuar dhe nëse është ende në fuqi. Espacenet shërben për të kërkuar dhe gjetur publikimet e patentave, përkthyer dokumentat nga makina e përkthimit, për të ndjekur përparimin e teknologjive të reja, për të gjetur zgjidhje të problemeve teknike, apo për të parë se çfarë janë duke zhvilluar konkurrentët. Espacenet u krijua në vitin 1998 nga ZEP. Me krijimin e këtij sistemi kërkimi është revolucionarizuar aksesimi i publikut në informacionin mbi patentat ndërkombëtare, duke i liruar të dhënat e patentave nga burgjet prej letre dhe duke ndryshuar përgjithmonë mënyrën se si merret informacioni mbi patentat, si shpërndahet, organizohet dhe kontrollohet. Ai përmban të dhëna për më shumë se 80 milion dokumente të patentave në mbarë botën.

TRAJTIMI I KONFLIKTEVE MBI OBJEKTET E PRONËSISË INDUSTRIALE

Në kohët e fundit ka pasur zhvillime të tilla që kanë çuar në një vetëdije më të madhe nga të gjithë aktorët e sistemit ekonomik për rëndësinë strategjike të mbrojtjes së pronësisë industriale, e njohur si një faktor që nxit konkurrencën dhe sjell rritjen ekonomike të një vendi. Pronësia, ose edhe disponueshmëria nëpërmjet licencës, së një patente, një disenjoje apo marke tregtare, lejon subjektet tregtare sot të konkurrojnë në treg me kushte më të favorshme.

Në momentet e rëndësishme të jetës së një biznesi, përdorimi i mekanizmave ligjore për të ndaluar cënimin e të drejtave të tyre mbi objektet e pronësisë industriale bëhet thelbësor për mbrojtjen e investimit dhe reputacionit të ndërmarrjes.

Ky proces ndërgjegjësimi është i lidhur ngushtë dhe sjell në mënyrë të pashmangshme nevojën për të mbrojtur këto të drejta të fituara, nga kopjimi, shkelja në përgjithësi e tyre në treg, apo nga tentativat e shkelësve për t'u mbrojtur në mënyrë mashtruese.

Rritja e kërkesave për regjistrimin dhe mbrojtjen e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale, si dhe numri i rasteve të konflikteve mbi këto të drejta, është tregues i qartë i interesit dhe vlerësimit serioz që ndërmarrjet kanë filluar t'i japin kësaj prone.

NDRYSHIMET LIGJORE NË LIDHJE ME KONFLIKTET MBI PRONËSINË INDUSTRIALE

Mbrojtja e të drejtave mbi objektet e pronësisë industriale është një nga aspektet më të rëndësishme të rregulluara nga Ligji Nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, i ndryshuar. Përmirësimi i vazhdueshëm i bazës ligjore me qëllim përafrimin me legjislacionin dhe standardet e vendeve të BE ka qenë vazhdimisht në fokusin e veprimtarisë së DPPI. Ndryshimet e fundit në këtë ligj sollën disa risi që do të ndyshojnë rrënjësisht mënyrën e mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale duke krijuar më shumë mundësi për t'i mbrojtur ato dhe për tu dhënë vlerën maksimale.

Në mënyrë të përmbledhur po përmendim disa nga këto ndryshime ligjore:

- E drejta e pengut të objekteve të PI-së. Krijimi i bazës ligjore për këtë të drejtë është në njëhësi me praktikën e organizatave ndërkombëtare si dhe të vendeve të tjera të zhvilluara. Kështu objektet e PI-së do të mund të përdoren si kolateral, si çdo send tjetër që mund të përdoret për këtë qëllim në bazë të dispozitave të Kodit Civil. Lënia peng e një objekti të PI do të konsiderohet e vlefshme nëse bëhet me një kontratë të noterizuar, e cila duhet gjithashtu të regjistrohet në regjistrin e DPPI-së. Një kontratë e tillë do të publikohet në buletinin e PI, për t'i dhënë mundësi publikut dhe çdo personi të interesuar të njihen me statusin e këtij objekti të vënë si kolateral. Kjo, nga ana tjetër, do të inkurajojë dhe nxisë bizneset të investojnë në fushën e PI-së, si i vetmi mjet i sigurt për zhvillimin e tyre në treg, si dhe për mbrojtjen nga konkurrenca e padrejtë.
- Refuzimi nga DPPI për shkaqe relative të regjistrimit në keqbesim të objekteve të pronësisë industriale. Kjo risi vjen si domosdoshmëri për mbrojtjen e të drejtave të atyre aplikantëve/pronarëve të markave të njohura dhe të përdorura në treg, të cilat imitohen dhe aplikohen për regjistrim në keqbesim nga subjekte të paautorizuara. Nisur nga praktika e DPPI-së, ka mbi të paktën 15 raste aplikime markash në keqbesim, të cilat janë bërë nga distributorët ose furnitorët e mallrave ose shërbimeve që mbrojnë këto marka.
- Specifikimi në ligj i termit “person” në “individ” është bërë me qëllim që të forcohet e drejta e individëve që kanë emra, mbiemra apo pamje të jashtme të njëjtë ose të ngjashme me markat që kërkojnë të regjistrohen. Ky specifikim u bë për shkak se e drejta e emrit dhe mbiemrit lidhet drejtpërdrejtë me individin si dhe për të mos u ngatërruar me emrin e subjektit si person fizik apo juridik.
- “Refuzimi për shkaqe absolute i markave të paregjistruara apo shenjave, të cilat kanë fituar dallueshmëri në treg për shkak të përdorimit të tyre për një kohë të gjatë nga aktiviteti

tregtar në një shtrirje të gjerë territoriale” është bërë për të mbrojtur të drejtat e kësaj kategorie markash nga imitimet e mundshme.

- “Hartimi i kriterëve për markat e mirënjohura” është një detyrim që buron nga Konventa e Parisit, e cila orienton vendet anëtare që të hartojnë kriterë për markat e mirënjohura, si dhe përbën gjithashtu edhe një detyrë të lënë nga Komisioni Evropian në raportin e vlerësimit të nëntorit 2013. Këto kriterë do të përdoren për vlerësimin e markave të mirënjohura në Shqipëri. Mungesa e tyre është hasur si problem në procesin e ekzaminimit, si dhe në zgjidhjen e konflikteve në rast shkeljesh të të drejtave.
- “Ndalimi i ndryshimeve në aplikimet për regjistrim të markave” pas depozitimit të tyre në DPPI në lidhje me shtimin e listës së mallrave ose shërbimeve dhe ndryshimin e pamjes së markës, pasi këto ndryshime mund të çojnë në konflikte midis subjekteve. Ky ndryshim është në funksion të përmirësimit dhe saktësisht të procedurave të aplikimit dhe ekzaminimit të markave.
- “Observime nga palët e treta”, ky parashikim ligjor është bërë për të mundësuar palët e treta të paraqesin observime ose vërejte ndaj markave të publikuara për të cilat zyra ka bërë ekzaminimin për baza absolute dhe i ka publikuar. Këto observime do të shqyrtohen nga dhoma e kundërshtimeve së bashku me kundërshtimet në lidhje me markën, pasi të jetë njoftuar më parë aplikanti për të depozituar argumentet e tij. Kjo është një mundësi e mirë për të korrigjuar gabimet e mundshme të bëra nga zyra në ekzaminimin për bazat absolute. Aktualisht ky veprim nuk kryhet dhe zyra nuk ka mundësi për të korrigjuar gabimet e saj pas publikimit të aplikimit për markë.
- "Shfuqizimi ose ndryshimi i akteve administrative me gabime" është bërë për të mundësuar që DPPI të shfuqizojë ato vendime të cilat përmbajnë gabime të dukshme të bëra nga DPPI-ja ose në bazë të të dhënave të gabuara. Kjo procedurë është marrë nga praktika e ZBEPI, si dhe ky nen është hartuar në përputhje me Rregulloren e Markave të ZBEPI.
- “Ndryshime në procedurat e kundërshtimit dhe të apelit të refuzimit të regjistrimit të markave” Këto ndryshime janë bërë për të plotësuar procedurat e kundërshtimit të regjistrimit të një marke si dhe për t’ia kaluar kompetencën e shqyrtimit të këtyre proceduarve dhomës për shqyrtimin e kundërshtimeve. Dhoma e kundërshtimeve do të jetë një strukturë e re, pjesë e seksionit të ekzaminimit brenda në DPPI e cila do të merret edhe me shqyrtimin e kundërshtimeve. Bazuar në praktikën e zyrave homologe të vendeve të zhvilluara kërkesat për kundërshtim shqyrtohen nga ekzaminuesit më me përvojë të zyrës. Vendimi i marrë nga Dhoma mund të apelohe si çdo vendim i DPPI-së në Bordin e Apelit brenda një (1) muaji.

- Shfuqizimi ose zhvlerësimi i një marke të regjistruar përveç gjykatës të bëhet edhe në dhomën për shfuqizim/zhvlerësim në DPPI. Më parë kjo kërkesë i drejtohej vetëm gjykatës por, me krijimin e Dhomës për shfuqizim/zhvlerësim, DPPI ka menduar të lehtësojë procedurat dhe të shkurtojë afatet kohore për shqyrtimin e kërkesave për shfuqizim. Në rastet kur ka përplasje midis procedurave administrative dhe gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës për shfuqizim. Në çdo rast procedura gjyqësore prevalon. Vendimi për shfuqizimin e një marke i marrë nga dhoma për shfuqizim/zhvlerësim mund të ankimohet në Bordin e Apelit dhe më pas në gjykatë. Ndonëse në pamje të parë, duket se u shtua një hallkë për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të ndryshme, sikurse u theksua më lart, me krijimin dhe funksionimin e kësaj Dhome këto mosmarrëveshjeje do të gjejnë zgjidhje më efikase dhe më të shpejtë, pasi qoftë Dhoma ashtu dhe Bordi i Apelit janë njësi të specializuara në fushën e PI-së. Punonjësit e DPPI-së, të cilët do të punojnë në këto njësi janë trajnuar, specializuar dhe kanë fituar përvojë jo vetëm me çështjet që janë trajtuar e zgjidhur brenda vendit, por edhe me mjaft çështje të tjera jashtë vendit për shkak të lidhjes dhe marrëdhënieve që kanë dhe krijojnë objektet e Pronësisë industriale, si patentat dhe markat, me çështje të ndryshme jashtë vendit. (Kjo praktikë gjendet e parashikuar në nenin 45 të Direktivës së BE-së për markat. (DIRECTIVE (EU) 2015/2436 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 16 December 2015 to approximate the laws of the Member States relating to trademarks.)
- Ndryshim i rëndësishëm në strukturën e Bordit të Apelimit në DPPI. Ky bord nga struktura me 3 anëtarë që ishte më përpara, tani do të përbëhet nga pesë anëtarë, nga të cilët, tre janë punonjës të DPPI-së dhe dy janë anëtarë të jashtëm të specializuar të fushës së PI-së. Bordi shqyrton vendimet e Dhomës së Kundërshtimeve dhe Dhomës për shfuqizim/zhvlerësim. Ky organ i shqyrtimit të konflikteve mbi objektet e pronësisë industriale do të jetë më eficientë në marrjen e vendimeve kolegjiale, pasi anëtarët e saj nga DPPI dhe të jashtëm do të jenë të specializuar, të trajnuar dhe me përvojë të konsiderueshme në fushën e pronësisë industriale. Këto aftësi dhe vlera të Bordit të Apelit e bëjnë atë shumë të aftë dhe kompetent për të shqyrtuar dhe zgjidhur konfliktet e ndryshme në lidhje me objektet e pronësisë industriale. Kundër Vendimit të Bordit të Apelit mund të bëhet ankim në gjykatën kompetente brenda 45 ditëve nga dita kur është marrë njoftim për vendimin e Bordit.
- Është krijuar baza ligjore për hartimin e kriterëve për ekspertët e pronësisë industriale në gjykata dhe për procedurat e testimit, licencimit dhe ripërtëritjes së licencës për përfaqësuesit e autorizuar dhe ekspertët e PI. Ekspertët e Pronësisë do të plotësojnë nevojat e gjykatës për vlerësimin me ekspert të rasteve në shqyrtim mbi konfliktet e objekteve të pronësisë industriale.

Me këto parashikime ligjore gjejnë zbatim rekomandimet e raportit të vlerësimit të Komisionit Evropian të Nëntorit 2013, i cili ngrinte një sërë çështjesh të rëndësishme për t'u zgjidhur si hartimi i kriterëve për markat e mirënjohura, hartimi i kriterëve për ekspertët e PI-së në gjykata,

përmirësimi i cilësisë së ekzaminimit, aplikimet on-line si dhe forcimi i kapaciteteve administrative të drejtorisë.

VENDIME TË MARRA NGA BORDI APELIMIT NË DPPI

Gjatë vitit 2017 nuk kanë munguar rastet e konflikteve mbi objektet e pronësisë industriale, për të cilat janë paraqitur kundërshtime në DPPI. Bordi i Apelimit të DPPI ka marrë vendim për 89 çështje duke vendosur:

- pranimin e kërkesës për kundërshtim dhe refuzimin e aplikimit për regjistrim marke në 72 raste;
- rrëzimin e kërkesës për kundërshtim dhe vazhdimin e procedurave të regjistrimit të markës në 8 raste;
- 6 kërkesa për kundërshtimin e markave të aplikuara për regjistrim janë pezulluar në bazë të pikës 1, të nenit 66, të Kodit të Procedurave Administrative, deri në përfundim të procesit gjyqësor, që ka si objekt markat e kundërshtuara.

Gjatë vitit 2017 janë apeluar pranë Bordit të Apelimit, 3 marka të refuzuara nga Drejtoria e Ekzaminimit dhe është marrë vendim nga Bordi:

- në 1 rast është pranuar kërkesa e apelimit dhe është vazhduar procedura për regjistrimin e markës;
- në 2 raste nuk është pranuar kërkesa e apelimit;
- 18 prej vendimeve të Bordit janë ankimuar pranë Gjykatës Administrative se Rrethit Tiranë, gjatë vitit 2017;

Duke parë statistikën sa më lart të Bordit të Apelimit, themi që është përmirësuar ndjeshëm vendimarrja e Bordit, duke qënë se vetëm një pakicë e këtyre vendimeve është ankimuar në gjykatë. Vendimet e Bordit të Apelit gjatë vitit 2017 janë përgatitur nga Sektori Juridik i DPPI. Bordi i Apelit në krahasim me vitet e kaluara ka patur një rritje të nivelit të përgatitjes së vendimeve, duke qënë se dhe 2 anëtarë të Bordit janë pjesë e sektorit juridik. Edhe në rastet e ankimit në gjykatë të vendimeve të Bordit të Apelit, në shumicën e rasteve janë lënë në fuqi vendimet e Bordit.

ÇËSHTJE NË GJYKATË

Përfaqësimi i DPPI në çështjet gjyqësore me objekt të drejtat e pronësisë industriale.

Gjatë vitit 2017, me autorizimin e Drejtorit të Përgjithshëm janë ndjekur 45 çështje në gjykatë. Përfaqësimi i DPPI-së në gjykatë ndodh në rastet kur nga subjekte të ndryshme ankimohen vendimet e Bordit të Apelimit, në të cilat DPPI merr pjesë në gjykim si palë e paditur dhe bën mbrotjen e saj me anë të pretendimeve, shpjegimeve dhe provave që paraqet në gjykatë.

Gjithashtu DPPI merr pjesë si person i tretë edhe në çështje me objekt, “zhvlerësim dhe shfuqizim marke, konkurrencë e pandershme,”etj.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë janë ndjekur 17 çështje, ndër të cilat:

- 1 çështje ka pasur si objekt shfuqizim i vendimit të Bordit të Apelit, ku DPPI është thirrur si palë e paditur dhe gjykata ka vendosur për 1 nga këto çështje me pranimin e padisë dhe rrëzimin e vendimit të Bordit të Apelit;
- 1 çështje me objekt pezullimi i të gjitha veprimeve të mëtejshme për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e markës “Piuta”, ku DPPI është thirrur si palë e paditur, për të çilën gjykata ka vendosur pushimin e gjykimit;
- 2 çështje me objekt zhvlerësim marke, ku DPPI është thirrur si palë e paditur;
- 1 çështje me objekt kthim shume, ku DPPI është thirrur si person i tretë;
- 7 çështje me objekt konstatim konkurrence e pandershme, ku DPPI është thirrur si person i tretë;
- 1 çështje me objekt sqarim dhe interpretim vendim gjykate ku DPPI është kërkues.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë janë ndjekur 20 çështje, ndër të cilat:

- 18 çështje me objekt shfuqizim vendim i Bordit të Apelit, ku DPPI është thirrur si palë e paditur;
- 2 çështje me objekt përjashtim gjyqtari.

Në Gjykatën e Administrative të Apelit Tiranë janë ndjekur 4 çështje, me objekt:

“Për Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Apelit”, 3 vendime;

“Për Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhërit” 1 vendim;

Në Gjykatën e Apelit Tiranë janë ndjekur 2 çështje, me objekt:

“Konstatim konkurrence të pandershme”, ku DPPI është person i tretë, 1 çështje.

“Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes, ku DPPI është person i tretë”, 1 çështje.

Në Gjykatën e Lartë janë ndjekur 2 çështje, me objekt:

“Shfuqizimin dhe c’regjistrimin e mbrojtjes së markës, ku DPPI ishte palë e tretë”, 1 çështje;

“Anullim vendimi i Bordit të Apelit”, 1 çështje.

Nga vendimet e Bordit të Apelit, gjykatat kanë vendosur:

- Për 3 çështje rrëzimin e vendimit të Bordit të Apelit të DPPI
- Për 12 çështje pranimin e vendimit të Bordit të Apelit të DPPI.

Për pjesën tjetër të çështjeve të ngelura, gjykata nuk ka marrë akoma vendim, pasi janë në proces.

Spektori Juridik ka ndjekur të gjitha çështjet në të gjitha shkallët e gjyqësorit. Vihet re se në çështjet në të cilat është ankimuar vendimi i Bordit të Apelit apo çdo akt tjetër administrativ i DPPI, Gjykata në 75 % të rasteve ka konsideruar aktet e DPPI të bazuara në ligj. Puna e Spektorit Juridik në lidhje me çështjet gjyqësore çdo vit jep rezultate, duke qenë se edhe niveli i mbrojtjes në fushën e pronësisë industriale është më profesional.

RAPORTI FINANCIAR

Financat, janë çështje delikate dhe mjaft e rëndësishme me të cilën ballafaqohet DPPI. Zbatimi i aktiviteteve të parashikuara në “Strategjinë Kombëtare për Pronësinë Intelektuale 2016-2020” parashikon kosto financiare të përcaktuara, të cilat duhet të sigurohen nga buxheti i shtetit ose donatorët e ndryshëm. Kjo e vë DPPI para përgjegjësi të përcaktuara shprehimisht për t’u realizuar dhe sfidës për sigurimin e resurseve të nevojshme për të përmbushur këto detyrime. Transformimi i strukturës të DPPI dhe kryerja e shërbimeve të reja, në mbështetje të parashikimeve në ligjin e amenduar, kanë impaktin e tyre financiar, i cili sigurisht që bazohet në nevojat konkrete institucionale.

DPPI është institucion që gjeneron të ardhura financiare dhe kjo është tregues i rëndësishëm i performancës së këtij institucioni, prandaj nevojat për krijimin e standardeve bashkëkohore të shërbimit dhe përmirësimi i cilësisë së ekzaminimit, modernizimi i teknologjisë së informacionit, aktivitetet promovuese, trajnimet, marrëdhëniet me organizatat ndërkombëtare të PI, të gjitha këto kanë kosto të cilat duhet të jenë të mirë alokuara, në mënyrë që investimi të kthehet në përfitim për publikun, pasi është fakt i pamohueshëm që njohja dhe respektimi i të drejtave të pronësisë industriale nxit inovacionin dhe krijimtarinë.

Tashmë DPPI ka hyrë në fazën e reformimit të saj dhe falë nismave të ndërmarra si në përmirësimin e shërbimeve ashtu edhe promovimin e rolit të pronësisë industriale, është rritur, numri total i aplikimeve që depozitohen në këtë institucion. Është shtuar ndjeshëm puna që përballohet nga stafi i saj. Janë zhvilluar një sërë aktivitete me qëllim ndërgjegjësimin e publikut dhe biznesit për të drejtat mbi PI. Volumi i punës dhe shkresave është shtuar ndjeshëm, vetëm gjatë vitit 2017 janë protokolluar dhe dërguar aplikantëve **10675** dokumente të lëshuara nga DPPI për objekte të pronësisë industriale, Gjithashtu janë hedhur në IPAS dhe janë

protokolluar **10279** dokumente hyrese (aplikime të reja dhe dokumente plotësuese). Rrjedhimisht, kjo punë voluminoze ka sjellë dhe shtimin e shpenzimeve dhe të ardhurave e arkëtuara nga DPPI.

Procesi i transformimit të DPPI ka katër vite që ka filluar, gjë që u konkretizua në vitin 2017 me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të fundit të ligjit. Kjo reformë është një hap i rëndësishëm për pronësinë industriale në Republikën e Shqipërisë.

Sa i takon forcimit të kapaciteteve administrative, DPPI nëpërmjet këtij ligji u shndërrua në agjenci autonome me vetëfinancim. Kjo formë organizimi është praktikë e të gjitha vendeve të zhvilluara.


Referuar të dhënave statistikore, të ardhurat vjetore që DPPI gjeneron, kanë pësuar rritje në vitet e fundit.

Nga aktiviteti kryesor që prej vitit 2013, të ardhurat kanë pësuar një rritje të vazhdueshme. Në vitin 2017 këto të ardhura janë rritur me rreth **48 % krahasuar me të ardhurat vjetore në vitin 2013.**

Rritje kanë pësuar edhe të ardhurat nga sistemi i Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave, me rreth **33% krahasuar me vitin 2013.**

Zëri i të ardhurave nga marrëveshja e shtrirjes së patentave Evropiane është në rënie pasi, që prej 01.05.2010, Shqipëria u bë anëtare me të drejta të plota në Organizatën Evropiane të Patentave dhe kjo marrëveshje nuk është më në fuqi. Të ardhurat që vijnë, ende janë për aplikimet për patenta të cilat janë depozituar në Zyrën Evropiane të Patentave para datën 01.05.2010, dhe trajtohen nëpërmjet kësaj marrëveshje kur kërkojnë shtrirjen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Vit buxhetor	Të ardhura nga Sistemi i Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave (swiss francs)	Të ardhura nga Marrëveshja e Shtrirjes së Patentave Evropiane (euro)	Të ardhura nga Aktiviteti kryesor (lek)
Viti 2013	473,361.05 CHF	22,623.55 €	63,644,291.00 ALL
Viti 2014	493,515.15 CHF	19,555.95 €	73,924,623.50 ALL
Viti 2015	529,538.03 CHF	8,052 €	81,108,236.49 ALL
Viti 2016	557,633.72 CHF	6,190 €	87,845,808.29 ALL
Viti 2017	627,326 CHF	7,958.54 €	94,244,771 ALL



Sqarojmë se të ardhurat nga Sistemi i Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave tregtare, grumbullohen nga Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale e cila e administron këtë marrëveshje, dhe disbusohen për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale, në tremujorin e parë të vitit pasardhës.





Tabela më poshtë tregon të ardhurat në total të arkëtuara nga DPPI në vitin 2017.

VITI	Totali i të ardhurave të arkëtuara nga DPPI
2017	158,951,319

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm tregon raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve të DPPI.

VITI	Të ardhura në ALL	Shpenzime në ALL	Diferenca
2013	126,178,304.09	19,423,715	106,754,589.09
2014	138,566,479.00	19,539,268	119,027,211.00
2015	148,689,162.52	24,532,466	124,156,696.52
2016	158,708,517.95	34,584,194	124,124,323.95
2017	158,951,319	38,473,465	120,477,854



		Janar-Tetor 2017 Plan (Në mijë lekë)	Janar-Tetor 2017 Fakt (Në mijë lekë)	% realizimi
1	Shpenzime Korente	29,761	27,779	93.3
1.1	Personeli	20,800	19,793	95
1.2	Operative	8,961	7,986	89
2	Shpenzime Kapitale	1,000	573	57.3
2.1	Financim i brendshëm	1,000	573	57.3
2.2	Financim i huaj	0	0	0
3	SHUMA	30,761	28,352	92
4	TOTALI	30,761	28,352	92

		Nëntor – Dhjetor 2017 Plan (Në mijë lekë)	Nëntor – Dhjetor 2017 Fakt (Në mijë lekë)	% realizimi
1	Shpenzime Korente	22,731	10,122	44.5
1.1	Personeli	9,921	5,240	52.8
1.2	Operative	12,810	4,882	38
2	Shpenzime Kapitale	71,107	0	0
2.1	Financim i brendshëm	71,107	0	0
2.2	Financim i huaj	0	0	0
3	SHUMA	93,838	10,122	10.8
4	TOTALI	93,838	10,122	10.8

Bazuar në ndryshimin e formës së organizimit, Sektori i Financës, Shërbimeve dhe Publikimeve, hartoi projektbuxhetin dhe programin financiar të DPPI-së, për vitin 2017, i cili u miratua nga Këshilli Mbikqyrës i DPPI dhe më pas u miratua me Vendimin Nr. 536, datë 4.10.2017 "Për miratimin e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale për vitin 2017", të Këshillit të Ministrave.

Në muajin dhjetor, hartoi projektbuxhetin dhe programin financiar të DPPI-së, për vitin 2018, si dhe u ndoq dhe u zbatua procesi i shndërrimit të DPPI në institucion jo - buxhetor.

Për këto ndryshime u morën masa që të njoftoheshin të gjithë grupet e interesit dhe publiku, nëpërmjet njoftimeve me e-mail, publikimin në faqen zyrtare të DPPI dhe takimeve pranë ambienteve të saj.

Janë përgatitur dhe ekzekutuar të gjithë urdhërpagesat e vitit 2017 duke realizuar në kohë zbatimin e të gjitha kontratave dhe detyrimeve financiare të institucionit.

Në bashkëpunim me njësitë e tjera të DPPI, Sektori i Financës, Shërbimeve dhe Publikimeve, hartoi "Planin e Zhvillimit të DPPI 2016-2020", i cili u miratua nga Këshilli Mbikqyrës së saj.

BURIMET NJERËZORE

Burimet njerëzore luajnë rol kyç për zhvillimin e qendrueshëm institucional. Personeli i kualifikuar dhe i përkushtuar konsiderohet si një nga asetet më të çmuara në DPPI. Politikat e drejtimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore në DPPI janë orientuar në zhvillimin e aftësive profesionale të punonjësve, mbështetjen e tyre në punë dhe aplikimin e stileve demokratike të trajtimit.

Është synuar përfshirja e personelit në politikat dhe problematikat e institucionit me qëllim rritjen e angazhimit të tyre për interesin e përbashkët të performancës së suksesshme të DPPI. Është aplikuar shpërndarja e informacionit dhe njohurive mbi punën ndërmjet gjithë punonjësve, me qëllim krijimin e frymës së bashkëpunimit dhe rritjen e efikasitetit.

DPPI ka vlerësuar kontributin e çmueshëm të personelit të saj dhe ka mbështetur përpjekjet e vazhdueshme dhe përkushtimin e gjithësecilit për rritjen individuale në aspektin profesional dhe për progresin e treguar në punën e ngarkuar nga institucioni.

Në mënyrë sistematike DPPI ka synuar:

- Rekrutimin, zhvillimin dhe mbajtjen e personelit të përshtatshëm që t'i shërbejë më mirë objektivave të saj organizative dhe funksionale
- Sigurimin e mundësive të barabarta për trajnimin e personelit dhe zhvillimin e karrierës
- Motivimin, shpërblimin dhe krijimin e harmonisë mes punonjësve në punë.

Në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare punonjësit e DPPI janë trajnuar për sistemin e mbrojtjes së pronësisë industriale duke siguruar formimin e tyre profesional.

Rëndësi i është dhënë edhe trajnimit të stafit në lidhje me procedurat e administratës publike, për të garantuar një shërbim sa më të shpejtë dhe korrekt ndaj publikut.

Gjatë vitit 2017 u administruan dosjet e stafit të DPPI, u dixhitalizuan dhe u hodhën në sistemin e Departamentit të Administratës Publike të dhënat nga këto dosje. Pas përfundimit të praktikës në DPPI, të 6 studentëve sipas “Për miratimin e programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike”, një prej tyre u punësua me kontratë një-vjeçare pranë DPPI.

MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

DPPI ka patur gjithmonë një mision të qartë në aspektin e marrëdhënieve me publikun. Synimi ynë kryesor është të qenurit pranë njerëzve, përballja e tyre me më shumë informacion përsa i përket sistemit të mbrojtjes së objekteve të pronësisë industriale, procedurave të regjistrimit dhe ofrimit të asistencës mbi mënyrën e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për aplikimet për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale.

Në vëmendjen tonë ka qenë edhe përmirësimi i imazhit të DPPI dhe krijimi i besueshmërisë, së sistemit të mbrojtjes së objekteve të PI është efikas dhe transparent.

Kemi kryer publikimin e çdo zhvillimi, aktiviteti apo materiali informues në lidhje me shërbimet, detyrimet dhe ndryshimet që rrjedhin nga ndryshimet e ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë industriale” i ndryshuar. Gjithashtu kemi shpjeguar vazhdimisht procedurat e regjistrimit dhe shërbimet që ofron DPPI, si dhe po vazhdon puna për zbatimin e shërbimeve të reja që do të dalin nga rregulloret.

Përdorimi me efikasitet i hapësirave mediatike si publikimeve të çështjeve të ndryshme mbi pronësinë industriale, kanë tërhequr vëmendjen e publikut mbi çështjet e PI.

Gjatë vitit 2017 me anë të mjeteve të komunikimit on-line, që gjenden në websitin zyrtar www.dppm.gov.al dhe në rrjetet sociale të DPPI, i është ofruar mundësia gjithkujt për të kërkuar informacion mbi shërbimet tona. Të gjithave pyetjeve u është dhënë përgjigje brenda një afati dy ditor, në varësi kjo të llojit të pyetjes.

Gjithashtu DPPI ka njoftuar me anë të e-maileve zyrtare dhe telefonatave bizneset shqiptare dhe të huaja në lidhje me ripërtëritjen në kohë të markave pas mbarimit të afatit 10-vjeçar të mbrojtjes. Po në këtë mënyrë janë kontaktuar qindra biznese shqiptare, departamentet e universiteteve të ndryshme, me qëllim ndërgjegjësimin për mbrojtjen e markave tregtare apo patentim të shpikjeve, nëpërmejt regjistrimit në DPPI.

Meqenëse në ditët e sotme rrjetet sociale janë bërë një mjet mjaft efikas komunikimi dhe promovimi, ne jemi përpjekur t’i shrytëzojmë ato me qëllim ndërgjegjësimin e publikut mbi rolin e DPPI-së dhe të rëndësisë që ka mbrojtja e PI në Republikën e Shqipërisë. Rrjetet tona sociale kanë qenë mjaft atraktive për ndjekësit duke publikuar informacione, lajme, artikuj, kuriozitete dhe çdo risi tjetër në lidhje me pronësinë industriale dhe aktivitetet tona. Në këtë mënyrë i kemi komunikuar një publiku edhe më të gjërë, se çfarë është pronësia industriale dhe si mbrohet ajo.

MASAT E MARRA NGA DPPI NË KUADËR TË REFORMËS SË DEREGULIMIT

Reforma e deregulimit është një nismë e qeverisë shqiptare e cila konsiston në reduktimin e lejeve, licencave, autorizimeve dhe procedurave me qëllim uljen e burokracisë dhe rritjen e efikasitetit të institucioneve shtetërore. Kjo është një nga nismat më të rëndësishme politike dhe në qeverisje, një reformë që ka më në qendër qytetarin si përfitues të drejtëpërdrejtë të shërbimeve publike. Rregullimi dhe deregulimi janë të dy fenomene të rëndësishëm në një ekonomi tregu, që në varësi të masës së aplikimit, mund të kthehet në pengesë apo nxitje për investimet e huaja dhe ato të vendit. Kjo reformë është jetësimi i një përpjekjeje serioze dhe këmbëngulëse për ta kthyer shtetin shërbëtor në shërbim të qytetarit dhe sipërmarrjes, duke ulur në maksimum peshën burokratike mbi ta.

Bazuar në Urdhërin e Ministrit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, z. Arben Ahmetaj me nr. 101/1 dt.02.10.2017, si dhe urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPPI, u shkurtua me 2 (dy) numri i dokumentave të kërkuara për efekt të procedurës së ekzaminimit të objekteve të PI. Këto dokumenta aktualisht i gjenerojnë nga sistemet on line të institucioneve, punonjësit e DPPI-së duke thjeshtuar dhe kursyer kohën e aplikantëve.

Në kuadër të transparencës, **DPPI publikon në faqen e saj zyrtare si dhe në portalin e-albania regjistrin e objekteve të PI-së** në të cilin janë të publikuara të dhënat në lidhje me këto objekte nga momenti i aplikimit deri në fund të jetëgjatësisë së tij.

Është shkurtuar periudha e ekzaminimit. Buletini zyrtar i markave, publikohet në dy herë në muaj nga një herë në dy muaj që ishte më parë. Nga 18 buletine që publikoheshin më parë, tani publikohen 36 në vit.

Është dixhitalizuar arkiva e objekteve të PI-së duke shkurtuar kohën e marrjes së dokumentave të ndryshme të kërkuar nga aplikantët.

Është përgatitur një plan masash për aplikimin on-line.

Ndryshime ligjore.

1. Ligji 17/2017 dt.16/02/2017 **përcaktoi dispozitat për aplikimet on-line në DPPI ku është parashikuar edhe pranimi i dokumenteve të nënshkruara elektronikisht.**
2. **U hartua paketa e projekt akteve ligjore dhe nënligjore**

Në projek-taktet ligjore dhe nënligjore të hartuara nga DPPI, nisur edhe nga eksperiencat e zyrave homologe, është parashikuar:

- a) **eliminimi i katër dokumenteve.** (Dokument identifikimi, Ekstrakt regjistri nga QKB, kopje të pamjeve të markës, depozitimi i autorizimit të përfaqësimit për një pjesë të shërbimeve). Impakti nga eliminimi i këtyre dokumentave **përkthehet në rreth 6700 dokumenta më pak**

të kërkuara në vit. Për pjesën më të madhe të shërbimeve DPPI kërkon vetëm plotësimin e një formulari të shoqëruar më mandat pagesën e tarifës për shërbimin e kërkuar.

- b) ***lëshimi i certifikatave elektronike*** dhe me tarifë të reduktuar.
- c) ***njoftimi nga DPPI i mbajtësve të së drejtës ose përfaqësuesve të tyre në lidhje me aplikimin për regjistrimin e markave të ngjashme.***
- d) ***reduktimi në maksimum i të dhënave që kërkojnë në formularët e aplikimit*** të cilët janë pjesë e këtyre projekt-akteve.
- e) ***Njoftimi nga DPPI i mbajtësve të së drejtës ose përfaqësuesve të tyre*** në kohë reale në lidhje me detyrimet e tyre për mirëmbajtjen e objekteve të PI.

PËRFAQËSUESIT E AUTORIZUAR TË PATENTAVE DHE MARKAVE

Përfaqësimi në DPPI

Përfaqësuesit e Autorizuar të objekteve të pronësisë industriale (agjentët e licencuar) janë profesionistët e vetëm të lejuar sipas nenit 195 të ligjit nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, për të përfaqësuar dhe vepruar në emër të pronarëve të objekteve të pronësisë industriale për të kryer regjistrimet pranë DPPI.

Personat që kanë vendqëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, ose që kryejnë veprimtari brenda territorit të saj, mund të përfaqësohen në DPPI vetë ose nëpërmjet përfaqësuesve të tjerë, që nuk janë të regjistruar në këtë drejtori, por drejtojnë ose janë të punësuar te ky person dhe janë të pajisur me autorizim përfaqësimi.

Nga praktika rezulton që shumica e pronarëve zgjedhin përfaqësimin nga një agjent i regjistruar i markës tregtare për të paraqitur dhe ndjekur procedurat e regjistrimit në DPPI, për të qenë më të garantuar për një aplikim të suksesshëm dhe profesional.

Roli i një agjenti përfshin përgatitjen, paraqitjen dhe ndjekjen e procedurave të kundërshtimit dhe paditë penale për aplikimet për regjistrimin e objekteve të pronësisë industriale duke dhënë mendime për regjistrimin e tyre në përputhje me kriteret e vendosura nga ligji dhe kryerjen e kërkimeve për të parë nëse mund të ekzistojë mundësia e konfuzionit dhe konflikteve, si psh në rastin e markave tregtare ose emrave tregtarë të të tjerëve.

DPPI shqyrton aplikimin e paraqitur nga agjenti dhe njofton atë për kryerjen e plotësimeve apo sqarimeve të nevojshme. Nëse gjatë publikimit paraqitet një kundërshtim ndaj një aplikimi të tillë agjenti harton një përgjigje të përshtatshme ose ndjek procedimet e kundërshtimit për të mbrojtur interesat e klientit dhe paraqet dëshmi dhe argumente të përshtatshme për të bindur

Dhomën e Shqyrtimit të Kundërshtimeve dhe Bordin e Apelimit për të mbrojtur aplikimin e tij. Gjithashtu një agjent mund të fillojë procedurat e kundërshtimit ndaj aplikimeve të tjera në emër të klientit të tij.

Një agjent duhet të ketë njohuri të plota të ligjit për pronësinë industriale, si dhe rregulloret në zbatim të tij. Një agjent duhet të ketë aftësi të mira komunikimi, si me shkrim dhe personalisht, me klientët, profesionistët e tjerë ligjorë, agjentët reklamues, nëpunësit e DPPI dhe me bashkëpunëtorët e huaj, si dhe për të përgatitur mendimet mbi rezultatin e kërimit, përgjigjet ndaj njoftimeve të ekzaminuesit dhe argumenteve me shkrim për përdorim në një procedurë kundërshtimi.

Një agjent këshillon dhe u shërben pronarëve të objekteve të pronësisë industriale në mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e tyre në mënyrë që ato të mbeten të vlefshme dhe të përdoren siç duhet. Një agjent gjithashtu ndihmon pronarët për kontratat e licencimit dhe të franchizing në mënyrë që të përfitohet sa më shumë prej tyre si dhe të krijohet ruajtja nga cënushmëria në tregjet vendase dhe të huaja.

Një agjent gjithashtu ndihmon pronarët duke regjistruar çdo ndryshim të pronësisë mbi objektet e regjistruara, duke paraqitur kërkesat për në ripërtëritjet e regjistrimeve në DPPI, si dhe për përgatitjen e aplikimeve për mbrojtjen ndërkombëtare të objekteve të pronësisë industriale.

Në regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar që DPPI mban, janë të regjistruar **187** përfaqësues të autorizuar të licencuar nga drejtoria e përgjithshme e pronësisë industriale, ndër këto **53** janë të licencuar për patentat për shpikje dhe modelet e përdorimit dhe **134** janë të licencuar për ushtrimin e aktivitetit të tyre si përfaqësues i autorizuar për disenjot industriale, markat tregtare dhe treguesit gjeografikë.

DPPI ka kompetencë të saj organizimin e testimit me shkrim të aplikantëve për përfaqësues të autorizuar. Për këtë qëllim ngrihet komisioni përkatës dhe janë mbajtur, pranuar dosjet e aplikantëve dhe janë përgatitur dokumentacionet e nevojshme për kryerjen e testimit dhe deri në marrjen e licencës.

Gjatë vitit 2017, në mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale pas shqyrtimit të kërkesave për pjesëmarrje në testimin që DPPI zhvillon për licencimin si përfaqësues të autorizuar, janë zhvilluar 2 testime me shkrim. Nga këto dy testime janë licencuar **15** prej personave të cilët janë pajisur me licencën si përfaqësues i autorizuar nga DPPI.

Në websitin e DPPI: www.dppm.gov.al, gjeni listën e Përfaqësuesve të Autorizuar të markave tregtare, disenjove industriale, treguesve gjeografikë dhe të patentave:

Përfaqësuesit e autorizuar për markat tregtare, disenjot industrial dhe treguesit gjeografik më aktiv për vitin 2017

NR	Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar	Numri i Markave
1.	Krenar LOLOÇI	110
2.	Vladimir NIKA	74
3.	Majlinda MANUSHI	60
4.	Vilson DUKA	56
5.	Vjollca SHOMO	49
6.	Ardit LOLOCI	46
7.	Kostina PRIFTI	37
8.	Fatos DEGA	36
9.	Melina NIKA	35
10.	Gazmir ISAKAJ	31

Përfaqësuesit e autorizuar për patentat dhe modelet e përdorimit më aktiv për vitin 2017

NR	Emri i Përfaqësuesit të Autorizuar	Numri i Patentave
1.	Krenar LOLOÇI	395
2.	Ela SHOMO	103
3.	Ardit LOLOÇI	71
4.	Fatos DEGA	69
5.	Vladimir NIKA	38
6.	Rajmonda KARAPICI	28
7.	Ditika HOXHA	21
8.	Eno DODBIBA	20
9.	Aleksandra ARSENI	18
10.	Vjollca KRYEZIU	9

PJESA III

TË DHËNA STATISTIKORE NGA REGJISTRAT E DPPI.

Të dhënat statistikore për të gjithë objektet e pronësisë industriale aktive në DPPI

REGJISTRIMET AKTIVE NË DPPI	
Numri i total i patentave për shpikje	4,501
Numri i patentave shqiptare në fuqi	43
Numri i markave kombëtare të regjistruara	10,000
Numri i markave nga sistemi i Madridit të regjistruara	46,462
Numri i disenjove industriale kombëtare të regjistruara	62
Numri i disenjove industriale të regjistruara nga Sistemi i Hagës	1794
Numri i treguesve gjeografikë të regjistruar	14
Nr. total i objekteve të pronësisë industriale të regjistruara në DPPI	62,876

Disa patenta për shpikje të lëshuara nga DPPI në vite, për subjekte me aktivitet në Shqipëri

1	5/4/2000	Pije alkoolike dhe procesi i prodhimit të saj	Adol shpk [AL]
2	16/02/2004	Skema e kthimit të vajit mbetës të reaktoreve në solarë të pastër	Xhevahir Zifile
3	30/10/2006	Metodë për prodhimin e një këpuce	Chen Ming-Te
4	18/10/2003	Bivaksine heterologe antikancer për njerëzit	Shuajp Kraja
5	21/01/2004	Ilaçe mjekimi, në veçanti për kurimin e infeksioneve ose të sëmundjeve kancerogjene	Shuajp Kraja
6	25/08/2011	SG maitrefork	Dashamir Elezi
7	4/10/2011	Aksesorë për mbrojtjen e fëmijëve, etj	Shemsedin Shkodra
8	7/12/2011	Procesi HERTEL-GORNICKI (HEGOR)	Transoilgroup AG
9	1/3/2012	Teknologji e re për absorbimin e pluhurave dhe gazrave industriale që shkarkohen në atmosferë;	Thanas Karajani
10	17/05/2012	Lëngu katalitik HKF1 HERTEL (Aktivator Dispersion) për transportin (nxjerrjen) e përmirësuar të energjisë hibride nga njësitë litostratigrafike	Transoilgroup AG
11	18/05/2012	Lëngu katalitik HKF2 HERTEL (Dispersion Bllokues) për transportin (nxjerrjen) e përmirësuar të energjisë hibride nga	Transoilgroup AG

		njësitë litostratigrafike.	
12	21/05/2012	Lëngu katalitik HKF3 HERTEL (Dispersion me nanopartikel) për transportin (nxjerrjen) e përmirësuar të energjisë hibride nga njësitë litostratigrafike	Transoilgroup AG
13	9/1/2013	Arkitektura celulare	Astrit Nixha
14	23/03/2012	Abonim i përkohshëm GSM me operatorë jo-resident	Armend Salihu
15	25/04/2013	Sistemi i lëvizshëm i kurorës së pistonit	Arben Mani
16	29/04/2013	Pomp Hidrokinamike Rrotullues	Iljana Pepa
17	7/1/2014	Motori me djegie të brendshme me cilindra të kundërt dhe piston të përbashkët- motori mani	Arben Mani
18	18/03/2014	Mozaikë të periudhave të ndryshme në miniaturë me pika në gur, dru, dhe qeramikë për kategorinë " Vepra të artëve të bukura "	Pjeter Perkeqi
19	30/04/2014	Kaldajë me ajër multifunksionale për lëndë djegëse	Krenar Merko
20	20/05/2014	Pompë për thithjen-shtyrjen (ngritjen) e ujit (lëngjeve), pompimin e tyre në lartësi të ndryshme në varësi të përmasave të pompës pa përdorur e as konsumuar energji për funksionimin e pompës dhe përfitimin e energjisë pa kosto nga vetë funksionimi i tij	Eduart Leco
21	7/8/2014	Përdorimi i ezhektorëve si teknologji në shfrytëzimin e venburimeve të naftës, gazit dhe gazokondensatit në Shqipëri.	Maksim Shuli
22	13/08/2014	Krijimi i mjeteve lëvizëse makina, anije, avionet, anije kozmike në formën 6-këndore konverse konike me qëllim mposhtjen e forcave të brendshme e të jashtme	Axhem Cora
23	7/8/2014	Përdorimi i lëndëve shkumëformuese, si metoda të reja me frytshmëri të lartë për rritjen e gaznxjerrjes në vendburimet e gazit në vendin tonë	Maksim Shuli
24	7/8/2014	Përdorimi i termoizolimeve të pajisjeve sipërfaqësore dhe metodave të tjera, të sipërfaqes, në trungun e pusit dhe në shtresë, kundër hidratimit të puseve të gazit dhe gazokondensatit në Shqipëri, si metoda bashkëkohore dhe mjaft efektive	Maksim Shuli
25	13/11/2014	Pajisje për vetprodhimin e energjisë	Dajlan Vukçaj
26	16/07/2014	Projekti për motorin me magnet të përhershëm -sistemi minervini	Michele Minervini
27	15/04/2014	Makinë vetëmbajtëse	Belul Kokollari
28	5/2/2015	Teknologji për Inventarizimin dhe Menaxhimin e Aseteve të Shpërndara Gjeografikisht	Geo-Consulting shpk dhe "Invent" shpk
29	4/5/2015	Prodhimi i humatave të përshtatshme për t'u përdorur në agrikulturë, ndërtim, industrinë e naftës, etj.	Fatmir Rustem Shehu
30	25/05/2015	Krevati lëkundës automatik	Antion Malasi
31	30/06/2015	Produkt ushqimor i koncentruar për kafshë dhe peshq nga mbetje organike të të gjitha llojeve	Mirel Mërtiri
32	30/06/2015	Teknologjia e prodhimit të produkteve ushqimor të koncentruar për kafshë dhe peshq, nga mbetje organike të të gjithëve llojeve	Mirel Mërtiri


33	20/07/2015	Pajisje Gjenerator Graviteti Centripetrik për Fluidet. P. G. G. C. F.	Vullnet Miraka
34	21/10/2015	Urat dhe pasarelat hidroenergjitike	Flamur Shena
35	30/10/2015	Gjenerator për prodhimin e energjisë elektrike me zhvendosje dhe vibrim	Luan Fahri Hoxha
36	4/12/2015	Përfitimi i elementëve kimike në mënyrë artificiale në enë magnetike përmes bombardimeve me proton, neutron, deuteron dhe nukleon kur elementi kimik para dhe pas bombardimit gjendet nën ndikimin e fushave të fuqishme elektromagnetike	Luan Fahri Hoxha
37	18/02/2016	Pajisje për karikimin e produkteve dhe aksesoreve elektronik me bateri	Alfred Kadriu
38	9/3/2016	Koshi Inteligjent Vetëriciklues	Martin Myteberi
39	17/03/2016	Biçikletë 2x2 për dy persona me dy akse pedalimi dhe katër pedale;	Gentjan Hasani
40	20/04/2016	Apump, proces i ri për pompimin e lëngjeve dhe mënyra e re për prodhimin e energjisë elektrike	Armand Hajdar Hasani
41	4/5/2016	Bateri e pafundme	Redion Elezi
42	17/05/2016	Teknikë e re në ftohjen e diodave LED të fuqisë, nëpërmjet përdorimit të materialeve ftohëse specifike por me qëllim të ndryshuar me termokonduksion dhe kapacitet energjie termike të lartë me rezultat rritjen e jetëgjatësisë së diodës LED	Klodian Agron Demiri

Fusha e zbatimit të shpikjeve nga subjektet shqiptare është si më poshtë:

Fushat e zbatimit të shpikjeve nga shpikësit shqiptarë	Nr.
Kimi/Teknologji ushqimore	3
Kimi/Teknologji e hidrokarbureve	5
Kimi/Farmaceutike	3
Energjitike	7
Inxhinieri mekanike	15
Fizikë	1
Konstruksione fikse	5
Nevojat njerëzore	3
Teknologji re elektronike	6
Transport	1


Nga cilat shtete ka më shumë aplikime për marka në Shqipëri

	Shteti	Nr. i aplikimeve për marka nga shtetet e tjera ndër vite
1.	SHBA	3597
2.	Britani e Madhe	831
3.	Zvicër	703
4.	Japoni	667
5.	Turqi	446
6.	Gjermani	442
7.	Itali	395
8.	Greqi	373
9.	Holandë	342
10.	Francë	322



Nga cilat shtete ka më shumë aplikime për marka në Shqipëri në vitin 2017

	Shteti	Nr aplikimeve për marka nga shtete të tjera në vitin 2017
1.	SHBA	127
2.	Kosovë	42
3.	Britani e Madhe	41
4.	Turqi	30
5.	Zvicër	15
6.	Gjermani	13
7.	Kore e Jugut	13
8.	Itali	12
9.	Kroaci	10
10.	Kinë	10




Aplikimet për marka në DPPI sipas klasave të mallrave dhe shërbimeve ndër vite

Klasa e mallrave/shërbimeve	Nr. i aplikimeve për markat që e përmbajnë klasën
1	500
2	211
3	1667
4	484
5	2756
6	218
7	448
8	249
9	1607
10	302
11	529
12	688
13	60
14	258
15	33
16	1122
17	131
18	371
19	245
20	232
21	356
22	89
23	56
24	207
25	972
26	97
27	76
28	340
29	1038
30	1884
31	301
32	1040
33	625
34	1163
35	1508
36	654
37	531
38	791

39	492
40	131
41	1245
42	818
43	611
44	291
45	187

Nr. i aplikimeve për marka sipas klasave

■ Shpeshtesia




Siç shihet nga tabela e mësipërme numrin më të madh të aplikimeve për marka e zënë klasat:

5. Për produktet farmaceutike dhe preparate të tjera për qëllime mjekësore ose veterinare;
 3. Përgatitjet jo mjekësore të higjienës, si dhe përgatitjet e pastrimit për përdorim në shtëpi dhe ambiente të tjera;
 35. shërbimet e kryera nga personat ose organizatat kryesisht me objektin e ndihmë në punën ose menaxhimin e një ndërmarrje tregtare, ose ndihmojnë në menaxhimin e punëve të biznesit ose funksioneve komerciale të një ndërmarrjeje industriale ose komerciale.

Marka shqiptare të regjistruara në vende të tjera nëpërmjet sistemit të Madridit për regjistrimin ndërkombëtar të markave:

Nr.	Emërtimi i markës	Pamja e markës	Pronari i markës	Nr. ndërkombëtar Regj.	Data e Regj.	Nice Cl.
1	DINOIL		Kappa Oil sh.a	1377174	5/14/2017	4
2	Vadia COSMETICS		Vadia Cosmetics Sh.p.k	1380055	5/10/2017	3
3	GTG LIVING WATER		STS DEVELOPMENT SH.P.K.	1366337	5/2/2017	32, 35
4	BLACK MOUNT Full Flavour FINEST VIRGINIA FILTER CIGARETTES		ALBANIA TABAK FABRIKA E RE CIGAREV	1333460	11/2/2016	34
5	B-2 ENERGY DRINK		ARSENI shpk	1316690	6/8/2016	32
6	BELINO		ELKA Company S.A.	1319911	1/20/2016	29, 30
7	Croissant Replay ELKA		ELKA S.A.	1321051	1/20/2016	30, 32

8	GJERGJ KASTRIOTI Skenderbeu brandy		KANTINA E PIJEVE "GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU" sh.a.	1283196	8/26/20 15	33
9	SHELDIA		SHELDIA GROUP	1287690	6/2/201 5	34
10	ELKA Daily COCOA SPREAD WITH HAZELNUTS		ELKA S.A.	1276680	6/2/201 5	30
11	ENERGY KING, LUXURY ENERGY DRINK, 18+, ENERGY DRINK, HIGH CAFFEINE CONTENT		BIBITA GROUP SHPK	1263148	5/19/20 15	32
12	Mr. Café		TIGANI GROUP SHPK	1269758	4/28/20 15	30
13	ama		New Century sh.p.k	1238167	9/16/20 14	30, 43
14	B-2 INDIAN TONIC WATER THE DRY ONE		ARSENI shpk	1221149	7/7/201 4	32
15	H10		RM sh.p.k.	1230539	6/18/20 14	5, 8
16	DUMDUM ENERGY DRINK		BIBITA GROUP	1217691	3/23/20 14	32
17	ama CAPSULE		New Century sh.p.k.	1211161	3/12/20 14	30

18	il cammino		IL CAMMINO Sh.p.k.	1205962	1/21/20 14	18, 25, 26
19	kraco		Capital Resource SH.P.K. Limited Liability Company, registered under the no. of registration K48130540L	1193299	11/26/2 013	29, 30, 32
20	ama il mio amato caffè		New Century sh.p.k	1187990	10/22/2 013	30
21	Ercole Marelli Poëer Sh.A.		Ercole Marelli Power Sh.A.	1186614	9/17/20 13	7, 9
22	Butterfly		"ADA" Sh.p.k.	1136778	8/8/201 2	5
23	Tropikal Mela verde		ARSENI shpk	1135756	7/15/20 12	32
24	natyral		"Agrotal 1"	988515	4/28/20 08	5, 29, 31
25	PENELOPE		Aleksandër Bregu	939074	6/6/200 7	14, 18, 25
26	GJERGJ KASTRIOTI SKENDERBEU		ADOL sh.pk (registered according to the Laws of Republic of Albania)	848976	4/27/20 05	33

